

E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2003

Në këtë numër:

**Nga debati parlamentar mbi
Raportin e Komisionit të BE-së
për Stabilizim-Asociim 2002**

**Reforma institucionale
dhe Integrimi Europian**

- Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin komunitar
- Baza juridike e asociimit të vendeve të treta në BE.
- Globalizimi dhe jeta politike

E Drejta Kushtetuese

- Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në raport me institucionet politike

13

**Botim i Qendrës së Studimeve
Parlamentare**

PERMBAJTJA E REVISTES:

Numri XIII, viti 2003

Faqe

<hr/>		
Debati parlamentar dhe Integrimi European		
Nga debati parlamentar mbi Raportin e Komisionit të BE-së për Stabilizim - Asociimin e Republikës së Shqipërisë në BE, për vitin 2002		
	Marko BELLO	4
	Fatos BEJA	9
	Fatmir MEDIU	14
	Arian STAROVA	21
<hr/>		
Reforma institucionale dhe Integrimi European		
Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin komunitar –proces vendimtar për Integrimin European	Ledi BIANKU	25
Baza juridike e asociimit të vendeve të treta në Bashkimin European. Zhvillimet e reja të zgjerimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor	Anastas SHUKE	39
Në rrugën drejt stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal – afrimi i Europës Juglindore me strukturat europiane	Iva ZAJMI	61
Globalizimi dhe jeta politike	Guy CARRON DE LA CARRIÈRE	71
<hr/>		
E Drejta Kushtetuese		
Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në raport me institucionet politike	Niazi JAHO	90
<hr/>		
Nga punimet e Kuvendit		
Nga punimet e Kuvendit për periudhën janar – mars 2003	Alma KONDAKÇI	96
Informacion mbi legjislacionin e miratuar	Filip LAKO	110
<hr/>		
Përmbledhje në anglisht:		
Informacion mbi legjislacionin e miratuar		118
<hr/>		

TABLE OF CONTENTS:

13th issue, year 2003

	Page
<hr/>	
Parliamentary debate and European Integration	
From the proceedings of the parliamentary debate on the Report of the EU Commission on the Stabilization and Association process for Albania during 2002	
Marko BELLO	4
Fatos BEJA	9
Fatmir MEDIU	14
Arian STAROVA	21
<hr/>	
Institutional Reform and European Integration	
Approximation of Albanian legislation with EU legislation – e decisive process for the European integration	
Ledi BIANKU	25
The juridical base of the association of the third countries in the European Union. The new developments of expansion in the Western Balkan region.	
Anastas SHUKE	39
On the path towards stability and regional cooperation – rapprochement of South East Europe with the European structures	
Iva ZAJMI	61
Globalization and political life	
Guy CARRON DE LA CARRIÈRE	71
<hr/>	
Constitutional Law	
The implications of the rulings of the Constitutional Court in relation to the political institutions	
Niazi JAHO	90
<hr/>	
Parliamentary proceedings	
Report on parliamentary proceedings during the period January-March 2003	
Alma KONDAKÇI	96
Information on laws passed by the Assembly	
Filip LAKO	110
<hr/>	
Summary in English:	
Information on laws passed by the Assembly	118

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Nga debati parlamentar mbi Raportin për Stabilizim - Asociimin e Republikës së Shqipërisë në BE ¹, për vitin 2002

*Marko Bello
Deputet i PS*

*I nderuar zoti Kryetar
Të nderuar kolegë,*

Do të ishte e padrejtë të mos përgëzonim sot opozitën për provokimin e këtij debati, i cili, pavarësisht toneve dhe gjuhës së papranueshme në disa raste, do të kontribuojë pa dyshim në sensibilizimin e mbarë shoqërisë shqiptare dhe motivimin e të gjitha strukturave përgjegjëse për integrimin e vendit në Bashkimin European.

Është hera e dytë që Komisioni European boton një raport për Shqipërinë dhe 4 vendet e tjera të atij që njihet si Ballkani Perëndimor, të cilat janë përfshirë në procesin e Stabilizim-Asociimit, si hap i parë drejt integritit të plotë të tyre në Bashkimin European. Në këtë Raport trajtohet me hollësi dhe realizëm situata në të cilën ndodhet sot vendi, si në planin politik, ashtu edhe në atë ekonomik. Aty përcaktohen fushat parësore dhe jepen sugjerime se ku do të duhet të përqendrohet vëmendja gjatë 12 muajve të ardhshëm.

¹Mbajtur në seancën plenare të datës 17 prill 2003

Situata për Shqipërinë në këtë Raport, në pjesën më të madhe, paraqitet kritike dhe me shumë probleme. Për këtë qëllim ky Raport do të duhet t'u vihet sa më parë në dispozicion dikastereve kryesore që kanë si detyrë të implementojnë reformat e nevojshme për zhvillimin e vendit dhe rritjen e standardeve të jetesës, në luftë pa kompromis me dukuritë negative si korrupsioni, trafiqet e paligjshme, krimi i organizuar etj., të cilat kërcënojnë stabilitetin dhe sigurinë e vendit.

Gjithsesi, duhet pranuar se Raporti, më shumë se Qeverisë, i referohet Shqipërisë dhe, si i tillë, ai nuk mund të përdoret thjesht si kobure në duart e opozitës për të hapur zjarr kundër maxhorancës. Pa dashur të marr në mbrojtje dukuritë negative me të cilat përballlet shoqëria shqiptare sot, gjej rastin t'u kujtoj disa përfaqësuesve të opozitës se çdo ekzagjerim për të etiketuar vendin tonë si delen e zezë të rajonit ose si burimin e të gjitha të këqijave, nuk i shërben imazhit të Shqipërisë, aq më pak luftës reale për zhdukjen e trafiqeve të paligjshme, korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Nëse sot Shqipëria ndodhet ende larg asaj ku do të donim ne të ishte, për këtë një përgjegjësi ka e gjithë klasa politike, e cila me gabimet e saj në vitet 1996, 1997 dhe 1998 e largoi vendin nga Europa. Edhe sot, për fat të keq, maxhoranca nuk po arrin të kapë ritmin e duhur të reformave, ashtu sikurse opozita vazhdon të harxhojë energji dhe të konsumohet për gjithfarë lloje komisionesh hetimore, në vend të përgatitjes së alternativave reale të përshpejtimt të proceseve integruese. Unë nuk dëgjova sot ndonjë koleg të krahut të majtë ose të djathtë t'i referohej asaj pjese të Raportit, ku me shqetësim theksohet fakti se Parlamenti refuzoi të respektonte një vendim të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me procedurat e shkarkimit të ish-Prokurorit të Përgjithshëm, Arben Rakipi. Për Komisionin Europian ka pak rëndësi nëse duhej shkarkuar ose jo Rakipi, por përse nuk u zbatua vendimi i detyruar i Gjykatës Kushtetuese.

Megjithatë, duke iu referuar një thënieje të njohur të Presidentit Amerikan, Abraham Linkoln "se sherri pambarim midis të shkuarës dhe të

sotmes rrezikon së tepërmi të ardhmen”, do të dëshiroja të përqendrohesh në disa nga përparësitë që dalin përpara Qeverisë, forcave politike dhe institucioneve demokratike të shtetit shqiptar:

Së pari, klasa politike e vendit ka detyrim kombëtar t’i sigurojë vendit stabilitet politik afatgjatë, zgjedhje të lira e të ndershme, rezultatet e të cilave të pranohen nga të gjithë. Më duhet të kujtoj se ne jemi i vetmi vend i bllokut ish-komunist, ku sa herë bëhen zgjedhje, forca që humbet nuk e pranon rezultatit, duke bojkotuar herë pas here institucionet. Në vitin 1996, z.Berisha shprehte me të drejtë pezmin e tij që opozita e atëhershme refuzonte vendet e saj në Kuvend. Por, shefi i demokratëve do të bënte më vonë të njëjtat gabime, duke bojkotuar në disa raste institucionet dhe duke tensionuar klimën politike në vend.

Së dyti, ka ardhur koha që stabiliteti makroekonomik, me të cilin janë mburrur të gjitha qeveritë paskomuniste, të shoqërohet me stabilitet dhe zhvillim afatgjatë të ekonomisë reale kapitaliste, me një klimë të qetë dhe legjislacion të favorshëm për zhvillimin e biznesit vendas dhe nxitjen e investimeve të huaja. Nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit - një hap i domosdoshëm ky për krijimin e një tregu të hapur rajonal - duhet të shoqërohet meoemos me programe konkrete nga ana e Qeverisë, përmes kreditimit të agro-biznesit vendas dhe uljes së taksave të karburantit dhe plehërave kimike, me qëllim për ta ndihmuar atë të përballojë konkurrencën dhe të shmangë falimentimin.

Së treti, krahas sukseseve të pamohueshme në lëmin e politikës së jashtme, ku do të veçoja ndihmesën e vendit tonë në drejtim të bashkëpunimit dy dhe shumëpalësh, stabilitetit dhe sigurisë në rajon e më gjerë, duhet që politika e jashtme dhe diplomacia shqiptare të orientohen më mirë dhe të angazhohen më shpejt për të mundësuar shkëputjen graduale të vendit nga grupi i 5 vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe për t’iu bashkuar grupit të Rumanisë, Bullgarisë dhe Kroacisë që synojnë integrimin në 2007-2009. Nëse ne do të vazhdojmë të kënaqemi me pak, duke pritur të anëtarësohemi diku nga 2020,

do të bëjmë një gabim të madh. Që tani, ekspertë të Bashkimit European sugjerojnë që Brukseli duhet të ndryshojë perceptimin dhe strategjinë për vendet e rajonit, duke guxuar të adoptojë drejtpërdrejt një politikë integruese, në vend të stërzgjatjeve të tipit stabilizim-asociim, me gjithë koston që mund të këtë ky proces. Veçse kjo nuk do të thotë se vendet candidate nuk duhet të bëjnë përpjekje reale nga ana e tyre. Në fund të fundit, shpejtësia e integritit për një vend do të varet nga vetë ai, pra, se sa është ai i përgatitur të absorbojë ngarkesën e reformave që do ta afronin atë me standardet e BE-së në të gjitha planet.

Së katërti, në dialogun e vazhdueshëm me Brukselin, nga ana jonë duhet guxuar më tepër në lidhje me asistencën e Komisionit European. Programi CARDS u pranua pa asnjë lloj rezistence, ndërsa nuk u bënë përpjekje për ta bindur BE-në se krahas CARDS, vendi ynë ka nevojë për programe të tipit PHARE, i cili do të ndihmonte Shqipërinë dhe rajonin në drejtim të rehabilitimit të infrastrukturës rrugore, rrjetit energjetik, zhvillimit të komunikacionit, informacionit, turizmit e biznesit, lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave, ideve dhe kapitaleve.

Për realizimin e këtyre objektivave, edhe Europa e Bashkuar i është nënshtruar një filozofie që përshkon vetë ndërtimin e saj. Që në 9 maj 1950, kur prezantoi projektin european, Robert Schuman u shpreh: “Europa nuk mund të bëhet me një të goditur, as edhe në një ngrehinë të vetme: ajo do të bëhet me anë realizimesh konkrete, duke krijuar më së pari një solidaritet real.”

Së pesti, ne duhet t’i kushtojmë rëndësi të veçantë asaj që njihet si përmasa e diplomacisë parlamentare. Kontaktet e shumta që parlamentarët realizojnë me homologët e tyre europeanë, konferencat, seminarët ose takimet ndërkombëtare të delegacioneve të përherëshme të Kuvendit mund të japin së tepërmi ndihmesë në drejtim të njohjes më të mirë të problemeve, me të cilat ndeshet vendi dhe t’i sigurojë atij përkrahje më të gjerë në realizimin e strategjisë kombëtare.

Nga ana tjetër, të krijosh siguri dhe stabilitet do të thotë të ndërmarrësh hapa legjislativë, buxhetorë dhe veprime të tjera të ngjashme, të cilat në një sistem demokratik janë në përgjegjësinë dhe autoritetin e parlamentit. Parlamentarët mund të monitorojnë implementimin e programeve dhe të mbështesin politikisht qeveritë e tyre për promovimin e programeve dhe të projekteve rajonale, ashtu sikurse mund të ndihmojnë në sensibilizimin e donatorëve dhe bashkësisë së biznesit, për të investuar në sektorë strategjikë.

Në këtë kuadër, unë do të përmendja përpjekjet e vazhdueshme të Komisionit të Përhershëm të Politikës së Jashtme dhe Komisionit *ad-hoc* të Integrimit European dhe Paktit të Stabilitetit të Kuvendit, në drejtim të forcimit të marrëdhënieve me vendet fqinje, të krijimit të masave të besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, me synimin e vetëm për të dhënë ndihmesë në krijimin e një klime paqeje, sigurie dhe stabiliteti ndërrajonal.

Duke përfunduar, më lejoni të theksoj se ka ardhur koha që ne të ndërgjegjësohemi se procesi i integrimit kërkon angazhimin e të gjithë shoqërisë shqiptare dhe veçanërisht të trinomit shtet - bashkësi biznesi - shoqëri civile. Pa një bashkim të forcave, ideve dhe energjive të të gjithë shqiptarëve, pa një bashkëpunim në të gjitha fushat, ku do të na duhet të përballojmë sfida të rëndësishme në të ardhmen, ne nuk mund të arrijmë qëllimin final – integrimin e plotë të Shqipërisë në Europën e Bashkuar, në Europën e lirive dhe të vlerave demokratike.

Fatos Beja
Deputet i PD

Raporti për vitin 2002 i Komisionit të Bashkimit Europian për Shqipërinë më futi në mendime për dy arsye:

Së pari, për përmbajtjen e tij, për ato që thuhet në të, të cilat janë të dhimbshme për ne shqiptarët. Megjithëse Raporti nuk merret me gjendjen e mjeruar të jetës së njerëzve të ne, por vetëm me gjendjen e qeverisjes së Shqipërisë, ai bën një skaner të qeverisjes socialiste të Shqipërisë gjatë vitit të kaluar dhe vë detyra për t'u kryer në të ardhmen.

Së dyti, për reagimin e Qeverisë ndaj dukurive dhe problemeve që ngre Raporti dhe të cilat shqiptarët duhet t'i analizojnë e t'i zgjidhin me gjakftohtësi, me seriozitet e sinqeritet, po që se duan që një ditë dyert e integritit në Bashkimin Europian të hapen dhe për ta. E them këtë sepse, për mendimin tim, reagimi i Qeverisë Shqiptare ndaj Raportit nuk ishte ai që duhej, por përkundrazi ishte shqetësues: Ajo heshti në fillim, e zemëruar me BE-në për ato që thuhet në Raport. Pastaj foli shtypi, që dha disa informacione të përcjella nga Komisioni Europian. Pastaj foli opozita, që kërkoi një mocion për debat me Kryeministrin. Ky i fundit mblodhi shpejt e shpejt grupin parlamentar, i vuri deputetët në rresht, u lëshoi dhe ca kërcënime nga Fieri, që kundërshtarët e tij të mos lëviznin nga rreshti, duke u kujtuar dosjet e përzjerjes në krime dhe rezultati: kemi dy ditë që deputetët socialistë, të

kurdisur nga ustai, e kanë kthyer mocionin e opozitës për raportin në një sulm të ideologjizuar kundër opozitës. Keni dy ditë që flisni këtu për '97 duke akuzuar opozitën. Duhet ta dini mirë se është pikërisht viti '97 që e mban Shqipërinë jashtë Europës, sepse ne jemi vendi i vetëm në Europën Lindore ku, gjatë viteve '90, pushteti u mor me pushkë. Dhe ju i përdorët armët për të marrë pushtetin, nuk e mori opozita pushtetin. Dhe janë pasojat e vitit 1997 që i vuajmë të gjithë sot dhe do t'i vuajmë edhe për shumë kohë në të ardhmen.

Cili është reagimi i administratës shqiptare ndaj Raportit vjetor të Komisionit Europian? Ai i Ministrit të Rendit Luan Rama, që në një kohë që ky Raport dhe të gjithë raportet e tjera për Shqipërinë nxijnë nga akuzat për krimin e organizuar e trafiqet që mbulohen nga Ministria e tij, vjen këtu e na bën përgjegjëse opozitën për krimet!? Ai i Ministrit Blushi, i cili, kur përmend se vajza e “Natës me Hënë” e Kadaresë u sulmua se i “rrinte mirë pardesyja”, na nënkupton se opozita ka inat se PS-së i “rri mirë fustani” prandaj na sulmon? Apo ai i ish-Ministrit Anastas Angjeli që deklaroi se “opozita u gëzua” për Raportin e Komisionit Europian!?

Absolutisht një reagim ideologjik e aspak profesional. Unë befasohem me kurajën tuaj për t'u mburrur këtu. Në vend që të jepni mesazhin se i prisni seriozisht vërejtjet e BE-së dhe se do të merrni masa për të shmangur defektet, ju politizoni gjithçka dhe bëni fajtores opozitën për qeverisjen tuaj. Jeni ju që qeverisni, jo opozita. Jeni ju që jeni përgjegjës për defektet e kësaj qeverisjeje, jo opozita. Ju nuk jeni të aftë të kuptoni përgjegjësitë tuaja dhe e kërkonin fajin te të tjerët.

Reagimi i administratës qeverisëse socialiste është, pra, një reagim tërësisht i politizuar, ashtu siç është vetë administrata që ju keni ndryshuar këto gjashtë vjet. Ne si opozitë kemi gjashtë vjet që ju tërheqim vëmendjen për politizimin e tepruar të administratës publike, duke zëvendësuar profesionistët me mbështetësit tuaj politikë, çka ka nxjerrë ikjen e parreshtur të intelektualëve nga vendi dhe veçanërisht të atyre që u morën me vite me

administrimin e sektorit publik. Raporti flet shprehimisht “për raste të emërtimeve politike dhe nepotizmit në një numër fushash shumë të rëndësishme...” (f.2), për “...ndërhyrjen politike në administratë dhe vështirësitë e institucioneve qendrore të administratës publike për të mbrojtur qëndrimet e tyre ndaj qeverisë...”(f.3), për “...emërimet politike që vijnë të jenë tepër të shpeshta, veçanërisht me ndryshimet e qeverive në 2002”(f.3).

Unë do të kujtoj dy raste të njohura publikisht:

- emërimi i një të ndëshkuari për evazion fiskal në krye të doganave shqiptare (rasti Papadhima); dhe
- çemërimi i një drejtori me kualifikim të lartë në fushën e tij, vetëm se është i opozitës (“rasti Malltezi”).

Të dyja rastet janë të njohura nga publiku dhe janë bërë gjerësisht objekt i mediave kohët e fundit. Madje, së fundi, pashë në shtyp një letër që Dr. Luan Malltezi i dërgonte Presidentit të Republikës dhe trupit diplomatik, në të cilën njoftonte se e ka hedhur në gjyq Kryeministrin për lirim të kundërligjshëm nga detyra e Drejtorit Qendror të Arkivave dhe se e ka fituar gjyqin. Me gjithë shkallën e lartë të kualifikimit të tij profesional dhe megjithëse e ka fituar gjyqin kundër Kryeministrit, dyert e administratës nuk hapen për të.

Pse, opozita e ka fajin që Kryeministri i jep mesazhe kaq domethënëse komunitetit ndërkombëtar si dy rastet e mësipërme të emërimit dhe çemërimit në administratë?

Ju kujtoni se ligji për Shërbimin Civil do të mbrojë një administratë të mbështetësve tuaj politikë! Lexoni me kujdes raportin: “*Të përdoren procedura seleksionimi të ndershme dhe profesionale*”(f.12), “*Administratat e doganave, të tatimeve dhe prokurimeve publike të mbulohen nga Ligji i Shërbimit Civil*” (f.12), “*Komisioni i Shërbimit Civil duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për t’iu përgjigjur detyrimeve të tij ligjore*” (f.3), “*Administrata nuk orientohet nga ligji, por nga*

pushteti”. Më qartë nuk ka: Administrata juaj nuk i bindet ligjit, por urdhrin, madje edhe kur ai është i paligjshëm, se ashtu për zgjidhet, se për këtë për zgjidhet.

Rezultati: Ne kemi sot në Shqipëri një administratë që është pre e korrupsionit, pares nën dorë, krimin të organizuar, pa aftësi. Dhe ju mburreni për “performancën” e administratës suaj, që ju e reformoni dhe e reformoni demagogjikisht pa pushim! Për fatin tuaj të keq, administrata shqiptare shpreh defektet e qeverisjes suaj, jo përgjegjësinë e opozitës. Ç’faj ka opozita që për një vit Qeveria s’është në gjendje të transferojë, të rrisht ose pjesërisht, Drejtorinë e Kodifikimit të Legjislacionit nga Ministria e Drejtësisë pranë Ministrin të Integritit, në mënyrë që projektligjet që Qeveria na bie në Kuvend të mos jenë modele të marra në vendet e Europës Lindore ose në kontinentet e tjera, por ligje të bëra në përputhje me direktivat e BE-së për çdo fushë?

Jo më kot, Raporti thotë se “*Administrata publike shqiptare ngelet e dobët dhe në një shumicë rastesh nuk është ende në gjendje të sigurojë zbatimin e duhur të instrumenteve qendrore të procesit të stabilizim-asociimit*” (f.18). Dhe më tej: “*Shqipëria ka nevojë të përmirësojë më tej kulturën e saj të përgjithshme administrative*” (f.19); “*Për më tepër, ngelet një prioritet rritja e kapacitetit administrativ të Shqipërisë për të siguruar realizimin e duhur të ndihmës financiare të BE-së... Po të arrihet kjo do të jetë më e lehtë për Shqipërinë të marrë mbështetje financiare shtesë*”(f.19).

Më qartë s’ka ku të vejë. Edhe paratë që na japin, Qeveria s’është në gjendje t’i thithë për pa aftësinë e vet.

Në Raport ka vetëm dy arritje dhe pastaj dhjetëra faqe detyrash të porealizuara dhe defektesh të qeverisjes e të institucioneve shqiptare. Të vetmet arritje janë zgjedhja e Presidentit konsensual dhe politika rajonale dhe ndërkombëtare e Shqipërisë. Të dyja rezultat i veprimit të përbashkët me opozitën.

Konkluzioni: Unë jam dakord me ju që Raporti është realist. Por, Raporti konfirmon se ju nuk jeni në gjendje të përmbushni përgjegjësitë tuaja qeverisëse, për ta integruar Shqipërinë në Europë, se ju nuk jeni të aftë të analizoni e të korrigjoni defektet e qeverisjes suaj e të ndërtoni institucione të Shqipërisë, por e kërkoni fajin te të tjerët, duke na lënë të gjithëve jashtë Europës. Pa institucione të besueshme dhe të të gjithë shqiptarëve, ne nuk mund të bëjmë përpara.

*Fatmir Mediu
Deputet i PR*

Të nderuar kolegë deputetë,

“Kur njerëzit rrezikohen të sigurojnë jetën dhe bukën e përditshme, ndodh që ata jo rrallë e vendosin lirinë dhe të drejtat e tyre nën këmbët e diktatorëve dhe të të korruptuarve”, - ka thënë Tokvili dhe për pasojë qeveritarët e papërgjegjshëm mendojnë se pushteti i tyre nuk njih as detyrim dhe as kontroll.

Qeveria Shqiptare mendon se mund të kontrollojë jetën e çdo qytetari, ndoshta të përsërisë paradoksin e diktaturës, për të sunduar nëpërmjet varfërisë. Ideja diabolike se sa më i varfër të jetë populli, aq më shumë mund ta kontrollosh atë dhe, shumë më lehtë mund të ndërtosh parajsën nga korrupsioni dhe krimi, duket që është bërë mbizotëruese për Qeverinë e sotme.

Kjo duhet ta bëjë opozitën të mendojë thellë dhe të shtrojë pyetjen: A mjafton vetëm të tregosh të keqen, se kjo qeveri është e korruptuar dhe shqiptarët janë të varfër?

Shqiptarët nuk dyshojnë për këtë, sepse ata e ndjejnë dhe e përjetojnë çdo ditë korrupsionin dhe varfërinë, por shumica kërkon që opozita të bashkohet me ta për të ndryshuar këtë realitet.

Në fund të janarit të këtij viti, Shqipëria hapi rrugën drejt një të ardhmjeje në familjen europiane, hapi negociatat zyrtare për procesin e stabilizim-asociimit.

Ky është një proces i të gjithë shqiptarëve, i të gjithë institucioneve, i politikës. Por Qeveria nxitoi ta konsideronte këtë si fitore të veten politike, fryt i punës së saj. Menjëherë pas hapjes së negociatave, Qeveria ndërpreu çdo lloj angazhimi me insituione të rëndësishme si Kuvendi dhe, për pasojë, ndërpreu bashkëpunimin mazhorancë-opozitë, në një kohë që elementi kryesor i këtij procesi është bashkëpunimi dhe konsensusi politik, për të realizuar detyrimet e BE-së.

Qeveria, varfërimin e shqiptarëve dhe vështirësitë e tyre, paftësinë dhe problemet e mëdha të saj që cilësohen në Raportin e BE-së, u përpoq t'i zëvendësonte me deklarata suksesesh dhe marrëdhëniesh të shkëlqyera me Europën. Por kohët kanë ndryshuar dhe marrëdhëniet me BE-në nuk janë më thjesht marrëdhënie deklarata dhe shprehje vullneti, por angazhimi konkret për të plotësuar detyrimet.

Pa dashur të bëjmë histori, ose për të ndarë merita, vlen të kujtohet si dhe pse u hapën këto negociata me Bashkimin Europian. Këtu nuk do të jap gjykimin tim vetjak, sepse ai përputhet me të vërtetën e përmendur në raportin e BE-së.

«Konsensusi politik për zgjedhjen e Presidentit të Republikës krijoi kushte për stabilitet politik dhe, pavarësisht nga problemet e mëdha, u vendos hapja e negociatave me kusht që çdo marrëdhënie me BE-në do të kushtëzohet me zbatimin e detyrimeve konkrete të vëna nga Komisioni European dhe zbatimi i reformave.»

Konsensusi për zgjedhjen e Presidentit ishte tregues i qartë i maturisë politike të opozitës, e cila jo vetëm nuk e çoi vendin në një rreth vicioz krizash, por i dha rrugë bashkëpunimit politik për integrimin europian, sepse ky ka qenë qëllimi dhe vizioni ynë që në hapat e parë politikë.

Po të njëjtin vullnet politik ne shprehëm si përfaqësues të opozitës në

Bruksel, në Parlamentin European, po të njëjtin qëndrim kam shprehur edhe në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Parlamentar të Integritimit, disa javë më parë përsëri në Parlamentin European dhe po të njëjtin qëndrim kemi edhe sot. Çdo ligj ose qëndrim që ka pasur të bëjë me procesin e integritimit ka gjetur mbështetjen e plotë të opozitës. Pra, Partia Republikane dhe gjithë opozita ka qenë plotësisht e gatshme për të bashkëpunuar për integritimin european.

Përballë kësaj situate normalisht shtrohen disa pyetje:

Kush e mban larg Shqipërinë nga Europa? Kush janë të interesuar për ngadalësimin e reformave? Pse krimi i organizuar po zotëron strukturat qendrore të shtetit dhe po ndikon çdo ditë në politikën dhe ekonominë shqiptare? Kush qëndron prapa varfërimit të vazhdueshëm të shqiptarëve? Kush pretendon të kontrollojë Shqipërinë dhe shqiptarët nëpërmjet varfërisë? Pse lulëzojnë vetëm bizneset monopol të mbështetura e të lidhura me qeveritarët dhe biznesmenët e ndershëm zhduken fizikisht, siç ndodhi disa ditë më parë?

Mendoj se sot këto pyetje duhet të na bëjnë të reflektojmë të gjithë ne, por përgjigjet sot duhet t'i japë Qeveria.

Në dëshirojmë ta quajmë veten përfaqësues të popullit dhe të interesave të tyre, por kemi dhe përgjegjësinë për t'i dhënë përgjigje po këtyre pyetjeve të shtruara prej tyre, pavarësisht nga përkatësia jonë politike.

Ne duhet të flasim konkretisht, sepse të përgjithësosh përgjegjësinë, siç bëjnë disa deputetë të Partisë Socialiste, do të thotë të mos nxjerrësh asnjë përgjegjësi e për pasojë të vazhdosësh në po këtë rrugë të «suksesëve», siç thonë disa të tjerë kolegë të PS-së, të cilët në 40 faqe raport përpiqen të gjejnë ndonjë fjalë progres, për të kënaqur veten dhe Qeverinë të cilës i shërbejnë verbërisht.

Për ata që nuk e kanë ose nuk duan ta lexojnë këtë Raport për situatën në Shqipëri, po përsëris disa përfundime të Bashkimit European:

1. Me këtë ritëm hapash për zbatimin e reformave në Shqipëri, negociatat rrezikojnë të jenë të gjata dhe të zvarritura.

2. Në Shqipëri nuk zbatohet ligji dhe Kushtetuta.

3. Nuk respektohen të drejtat e qytetarëve, siç është ajo e votës së lirë dhe e pronës private.

4. Krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë të jenë tepër kërcënues për stabilitetin dhe progresin e vendit.

5. Administrata publike është e kontrolluar nga nepotizmi dhe paftësia.

6. Gjendja ekonomike në Shqipëri është e rëndë, ka papunësi, varfëri dhe ritmet e rritjes ekonomike janë në rënie.

Komisioneri Patten thekson se krimi në Shqipëri është mbizotërues dhe për këtë mjafton të marrësh informacionet e FBI-së.

Raporti i Grupit Ndërkombëtar të krizave thekson se gjendja e rëndë ekonomike dhe fuqia e korrupsionit dhe e krimit të organizuar mund të çojnë në konflikte të pakontrollueshme në Shqipëri.

Çfarë mund të thuhet më shumë se kaq? Çfarë duhet më shumë që shqiptarët të ndjejnë se ëndrra e tyre europiane është shumë larg, se Qeveria po punon kundër interesave dhe vullnetit të tyre?

Po të analizojmë me radhë të gjitha këto probleme, ka vetëm një përgjegjësi, përgjegjësi e Qeverisë, por edhe një përgjegjësi tjetër atë të Parlamentit me një mazhorancë, e cila jo vetëm nuk kontrollon dot Qeverinë e vet, por kërkon të frenojë dhe opozitën të kryej rolin e saj.

Megjithatë, nuk është vetëm kjo, sepse ironia më e madhe dhe poshtërimi më i madh që mund t' u bëhet shqiptarëve është se edhe tani, që të gjitha këto janë deklaruar publikisht nga BE-ja, Kryeministri dhe Qeveria deklarojnë se jemi në rrugën e mbarë drejt integritimit europian, dhe këtij refreni të dhimbshëm dhe qesharak i bashkohen dhe zëra brenda Kuvendit, me shpresën se largimi i ndonjë ministri mund t' i jepte një shans për të marë një post qeveritar.

Ka dhe deputetë të cilët nxitojnë të thonë se të njëjtat probleme kanë edhe vendet e tjera të rajonit. Për t' u dhënë përgjigje le të shohim se çfarë thotë raporti për Kroacinë: «*Situata politike është e qëndrueshme dhe e*

kënaqshme, zhvillimet demokratike po konsolidohen. Qeveria vazhdon të tregojë qëndrueshmëri, për të vendosur demokraci të plotë përsa i përket veprimit të ligjit. Situata ekonomike vazhdon të përmirësohet.»

Përballë medias, para disa ditësh, zoti Nano u vendosi detyra, me afate kohore, nxënësve të tij ministra, por asnjë përgjegjësi për gjendjen në të cilën ndodhemi. A njiheshin këto detyrime më parë dhe përse nuk u respektuan afatet? Sepse të paktën në fushën e legjislacionit nuk ka asnjë vështirësi për të ecur në luftën kundër krimit të organizuar, reformave të sistemit gjyqësor ose Policisë së Shtetit.

Më e pakta është të thuash se kjo Qeveri është e paaftë për ta çuar vendin drejt prosperitetit dhe drejt Europës. Interesa të kundërt me prosperitetin dhe Europën, qëllime të lidhura me krimin dhe korrupsionin e mbajnë peng Shqipërinë.

Përfaqësuesit e krimit dhe të korrupsionit nuk mund ta pranojnë afrimin me BE-në, sepse do të pranonin fundin e ndikimit të tyre.

Dera që Bashkimi Europian i hapi Shqipërisë nuk mund të kapërcehet as me demagogji, as dhe me deklarata të përgjithshme, por me përgjegjësi konkrete dhe përgjegjësia është e Qeverisë Nano.

Nuk mund të jenë përgjigje për shqiptarët dhe Perëndimin demagogjia se opozita nuk është konstruktive, sepse për këtë proces ajo ka dhënë mbështetjen e saj të plotë dhe ndoshta ndonjëherë dhe me të tepërt, duke vënë në dyshim rolin dhe detyrimet e saj karshi shqiptarëve.

Nuk e meriton Shqipëria, që ka qënë pjesë e historisë dhe kulturës europiane, të rri larg saj. Nuk e meriton çdo shqiptar, që ndeshet sot me varfërinë dhe ka shpresën se në Europë do të gjej dhe prosperitetin ekonomik, të vazhdojë të vuaj, sepse ekonomia shqiptare kontrollon nga monopolet, korrupsioni dhe krimi.

Nuk meritojnë të rinjtë që kanë ëndrrën e tyre në universitetet europiane, nuk meritojnë ata që e duan lirinë dhe lëvizjen e lirë të jenë të izoluar. Të gjithë ne meritojmë më shumë, por kjo nuk mjafton përsa kohë që Qeveria

nuk pranon të qeverisë me rregullat dhe normat e Bashkimit European, por qeveris me interesat klanore dhe korruptive.

Partia Republikane prej vitesh ka ngritur dhe ngre çështjen e pronës private; ajo ka dënuar sjelljen e mazhorancës si pronare me atë që nuk është e saj. Prej vitesh kemi çuar një ligj në Kuvend për të zgjidhur këtë çështje sipas Kushtetutës dhe kërkesave të BE-së, por ju në vend që të miratoni këtë ligj sillni një ligj tjetër, me pretendimin se nuk doni të krijoni probleme sociale, ndërsa në të vërtetë doni vetëm të vazhdojë korrupsioni dhe vjedhja që po bëhet mbi pronat e pronarëve legjitim.

Sa herë që ne kërkojmë që institucionet që merren me luftën kundër korrupsionit të jenë të pavarura, ju më tepër i mbysni me njerëz të korruptuar dhe të paaftë.

Partia Republikane prej vitesh ka hedhur idenë e gjykatës dhe të prokurorisë për krimet e rënda dhe ende nuk është diskutuar, njohur dhe pranuar nga të gjithë kjo ide.

Opozita kërkon që të drejtojë Institucionin e Kontrollit të Shpenzimeve Publike Qeverisëse dhe ju, edhe pse ka një marrëveshje, nuk pranoi.

Procesi i bashkimit me familjen europiane është një proces pa kthim mbrapa.

Ky proces nuk është e drejtë ekskluzive e kërkujt; ai është proces i shqiptarëve, i të gjithë institucioneve dhe partive politike.

1. Duhet që në mënyrë sa më të shpejtë të ndërtohet një strategji e përbashkët kombëtare për integrimin europian.

2. Të ngrihen grupe të veçanta në ekzekutiv dhe Kuvend për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të shtruara në këtë Raport.

3. Strategjia e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit nuk mund të jetë kontribut i një ministrie, e cila është pjesë e problemit; ajo kërkon ekspertizë të Perëndimit dhe mbështetje të gjerë politike.

4. Ministria e Integritit European duhet të fitojë një autoritet dhe strukturë të plotë në përmbushjen e detyrimeve të BE-së në kontrollin dhe bashkërendimin e politikave të integritit.

5. *Presidenti i Republikës duhet të ndërhyje në këtë proces, duke garantuar bashkëpunimin politik, si dhe azhornimin e institucioneve me këtë proces.*

Lirinë e fituar nëpërmjet demokracisë, shqiptarët nuk mund ta shesin për të siguruar bukën e gojës; opozita së bashku me ta duhet t'i heqë pushtetin absolut kësaj qeverie që pjell korrupsion absolut dhe varfëri absolute dhe t'ua kthejë atë njerëzve, prosperitetit dhe të ardhmes europiane.

«Despotët, vetë asnjëherë nuk deklarohen kundër lirisë, përkundrazi e vlerësojnë atë, por ata e duan vetëm për veten e tyre dhe pohojnë se të tjerët nuk e meritojnë tërësisht atë.»

Arian Starova
Deputet i Grupit Parlamentar
Liberal - Demokrat

Zoti Kryetar,
zonja e zotërinj deputetë,

Në këtë fjalë të shkurtër timen nuk dua të përsëris të njëjtin arsyezim që është përdorur në Raportin e Komisionit European në lidhje me procesin e Stabilizim-Asociimit të Shqipërisë në BE gjatë vitit 2002. Këtë e kemi të gjithë parasysh thjesht nga leximi i tij.

Jam munduar të arsyetoj rreth shkaqeve të thella të mospërsëris në zbatimin e këshillave të BE-së e të mekanizmave të saj monitorues nga Qeveria Shqiptare, si dhe rreth mënyrave e mjeteve që duhen përdorur për të bërë të mundur zbatimin me sukses të këshillave të këtij Raporti nga Shqipëria.

Mua më duket se mesazhi që vjen prej Raportit, për të cilin po diskutojmë sot, është qartësisht i dukshëm e në të lexohet se shkakun themelor i mospërsëris qeveritar në lidhje me zbatimin e këshillave të Bashkimit European është mungesa e vullnetit politik të saj për të vepruar në drejtimin e duhur. Mangësitë ose shkaqet e tjera të nivelit teknik janë dytësore në krahasim me shkakun themelor, i cili është politik. Qysh në hyrjen e raportit thuhet qartë se “*Shqipëria do të jetë e aftë të merret me këto çështje të vështira*

(d.m.th. me migrimin e paligjshëm e trafiqet e paligjshme të qenieve njerëzore, me drogën e forma të tjera të krimit të organizuar, me korrupsionin në dogana, polici e sistemin gjyqësor) *vetëm në qoftë se ekziston një përkushtim i vërtetë i Qeverisë, i forcave politike shqiptare dhe i institucioneve të zbatimit të ligjit (përfshirë prokurorinë e sistemin gjyqësor) dhe një vendosmëri e palëkundur, për ta kthyer këtë përkushtim në veprim”* (f.1). Diku tjetër në raport thuhet: *“Lufta kundër korrupsionit kërkon përkushtim të palëkundshëm e vullnet politik, si dhe zbatim të vendosur të planeve vepruese”* (f.6). Më tej, gjithashtu, thuhet për krimin e organizuar se ai *“në Shqipëri vazhdon të mbetet një problem shumë serioz. Mendohet se krimi i organizuar është i aftë të depërtojë në qendrat shqiptare të pushtetit, qoftë të atij politik, qoftë të atij ekonomik. Kjo gjendje minon të ardhmen e sundimit të vërtetë të zbatimit të ligjit dhe, në fund të fundit, edhe mundësitë e Shqipërisë për zhvillim të sigurt e të qëndrueshëm”* (f. 30).

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se këto vërejtje e këshilla nuk i janë dhënë Shqipërisë vetëm nga Bashkimi Europian, por edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare e në veçanti nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk jam në gjendje të përcaktoj nëse kjo mungesë vullneti shkaktohet nga frika për të vepruar kundër dukurive të krimit të organizuar, nga paaftësia ose mosdashja. Zhvillimet politike në vend të bëjnë të mendosh se mosdashja është shkaku mbizotërues.

Të gjithëve, por më shumë shumicës së sotme parlamentare, na kujtohet se si, rreth dy vjet më parë, kryeministri i sotëm nisi një luftë, që sot duhet ta futim në thonjëza, kundër korrupsionit të disa qeveritarëve të asaj kohe brenda forumeve të Partisë Socialiste. Për të thënë të vërtetën, në atë kohë kjo gjë krijoi simpati edhe në radhët e opozitës. Megjithatë, pa kaluar shumë kohë, kjo e ashtuquajtur “luftë” kundër korrupsionit e dukurive të tjera negative, për të cilat flet edhe raporti i vitit 2002 i Komisionit Europian, u la në mes të rrugës. As të ashtuquajturit “katarsistë” nuk qenë në gjendje ta venë më në

lëvizje atë makineri për të cilën nisi të fliste zoti Nano. Përkundrazi, u shtrënguan radhët në parti vetëm me një synim: ruajtjen me çdo çmim të qeverisjes në dëm të së ardhmes së vendit. Kjo natyrisht duhet rikujtuar si argument që vërteton mungesën e vullnetit qeveritar për të zbatuar këshillat e bashkësisë ndërkombëtare. Kryeministri Nano duket se i njeh mënyrat për të luftuar, por nuk don ta bëjë këtë, sepse do t'i duhet të braktisë qeverisjen, prandaj ai le të nënkuptohet se për të është më mirë të qeverisë qoftë edhe në dëm të së ardhmes së vendit, sesa të qeverisë në emër të së ardhmes së Shqipërisë e në dëm të jetëgjatësisë së qeverisjes së tij.

Më lejoni të them, jo pa shqetësim e aspak me kënaqësi politike prej opozitari të verbër, se kjo gjendje e Shqipërisë e pasqyruar në raportin e Komisionit Europian rrezikon të çojë jo vetëm në “ngadalësimin e negociatave”, por edhe në bllokimin e tyre.

Një pjesë e problemeve që Raporti këshillon për zgjidhje janë shumë delikate, si lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit e trafiqeve të paligjshme, pavarësia e sistemit gjyqësor, ligji i ri për pronat, përmirësimi i ligjit zgjedhor, mjedisi, ekonomia etj.

Përvoja e vitit 2002 tregoi se, përveç mungesës së vullnetit politik, ka edhe konflikte interesash të klasës politike qeverisëse me veprimet që kërkon BE-ja. Për mua personalisht këtë e vërtetoi më së miri, disa muaj më parë, dështimi i Komisionit Parlamentar për Çështjen e Pronave. Në qoftë se është ndryshe, atëherë më lejoni t'i kërkoj publikisht Kryeministrit Nano të bëjë publike emrat e të korruptuarve qeveritarë e të mbrojtësve politikë të veprimtarive të paligjshme të të gjitha llojeve, për të cilat ai vetë, por edhe të tjerë zyrtarë të lartë të partisë socialiste kanë lenë të kuptohet se i dinë.

I ndodhur përballë pafuqisë së dukshme e mungesës së vullnetit të Kryeministrit Nano për të nisur seriozisht përpjekjen e vërtetë për zbatimin e këshillave të bashkësisë ndërkombëtare dhe i nxitur nga dëshira për të pasur sukses në rrugën e zhvillimit të vendit, Kuvendi duhet të merret para së gjithash me gjykimin e qeverisjes së sotme. Kjo qeverisje është e dështuar

dhe ajo duhet rivotëbesuar. Ndoshta, gjendjes së sotme do t'i përshtatej më mirë një "Qeveri Mirëkuptimi Kombëtar" e re, e cila të mund ta udhëhiqte Shqipërinë me sukses në negociatat për arritjen e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në BE, në zgjidhjen përfundimtare të problemit të pronave e në zgjedhje të vërteta, të lira e të ndershme.

Faleminderit!

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin komunitar – proces vendimtar për integrimin europian

*Ledi Bianku
Qendra Europiane*

ROLI I SEKTORIT NË SHQIPËRI

Nga pikëpamja historike sistemi ligjor shqiptar, ashtu si edhe i pjesës më të madhe të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, i përkiste fillimisht familjes së *civil law*. Gjatë periudhës së regjimit komunist ky regjim pësoi një metamorfozë të thellë në mënyrë që ta mundësonte regjimin në fjalë për realizimin e objektivave dhe përparësive të veta në një ekonomi të përqendruar dhe të komanduar nga shteti. Përplasja e situatës paraprake me prirjen vijuese çoi në bashkëveprimin e dispozitave normative në konflikt konceptual me njëra-tjetrën dhe rezultoi për pasojë në shkatërrimin e, pothuajse, të çdo strukture ekzistuese të tregut. Kështu për shembull, institutet e pronësisë dhe të kontratave u bënë forma ligjore me zbrazëti të theksuara konceptuale.

Në një strukturë të tillë ligjore është e qartë që mundësia e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore në përgjithësi, dhe e Shqipërisë në rastin konkret, për të ndërtuar një ekonomi të tregut të lirë dhe një bashkëpunim real ishte tepër e kufizuar. Për këtë arsye themelore, ndryshimi bazë nga ekonomitë e përqendruara në ekonomi të tregut, ndryshimet themelore nga ekonomi të kontrolluara nga shteti në ekonomi të tregut që janë synuar që prej 12-13 vjetësh në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, si dhe interesi i tyre për marrëdhënie më të ngushta me Komunitetin Europian, nuk prekin

vetëm kuadrin bazë ekonomik dhe administrativ, por gjithashtu dhe para së gjithash, kuadrin bazë ligjor në këto vende. Pra, tranzicioni i synuar nuk kërkon vetëm vendime politike për një ekonomi të tregut, por edhe vlerësimin dhe kuptimin siç duhet të kushteve ligjore të zhvillimit të një ekonomie tregu dhe në veçanti të atij të Komunitetit European. Ky orientim bazë mund të lehtësojë përshtatjen me rregullimin ekonomik të këtij të fundit.

Duhet vënë në dukje në përgjithësi që zhvillimet në Europën Qendrore dhe Lindore, që prej rënies së Murit të Berlinit, vështirë se mund të quhen përshtatje ose tranzicion juridik, duke pasur parasysh se ato vlerësohen të kenë qenë dhe deri në njëfarë mase edhe të vazhdojnë të jenë përpjekjet bazë për të ngritur një kuadër të ri ligjor dhe një strukturë të rinovuar gjyqësore që nga themelet e tyre. Me fjalë të tjera, këto vende nuk e kishin pikën e startit të tyre nga shoqëri të rregulluara ose të strukturuar, por ato më tepër synojnë të arrijnë në shoqëri me tipare të tilla¹. Kjo është e vërtetë jo vetëm përse i përket kuadrin ligjor të një ekonomie tregu, por edhe përse i përket një rendi ligjor të mirëstrukturuar dhe efektiv në përgjithësi. Për më tepër, instrumentet normative jo vetëm që janë padyshim nga më të rëndësishmit, por edhe më të qëndrueshmit për perceptimin dhe orientimin politik, social dhe ekonomik të një vendi. Një ndjesi e tillë ka ndikuar, proceset demokratike në Shqipëri, që në fillimet e saj, ku përshtatjet ligjore me standardet perëndimore u vlerësuan si kyç i ravijëzimit të reformave dhe të suksesit të tyre. Duket se kjo ndjesi është konfirmuar edhe nga vlerësimet komunitare të procesit të përafrimit të legjislacionit me atë komunitar si një instrument për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar².

¹ Natyrisht që ky pohim mund të qëndrojë vetëm po të pranojmë aksiomën, që shoqëri të strukturuar ligjërisht do të quajmë vetëm ato shoqëri që respektojnë, në rregullimin e tyre normativ, parimin e ligjshmërisë dhe parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare me një karakter përgjithësisht të pranuar.

² Shih nenin 1 të Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me Kroacinë.

IMPAKTI I INTEGRIMIT EUROPIAN NË KËTË SEKTOR – KRITERET KRYESORE TË ZBATUARA NGA BE.

Brenda BE-së për vendet anëtare

Përveçse nga pikëpamja e lartpërmendur – si mënyrë për të mundësuar krijimin e një klime të përshtatshme të domosdoshme për ecjen përpara të zhvillimit të vendit në kushtet e një ekonomie tregu – përafrimi i legjislacionit mund dhe duhet patjetër të vlerësohet si parakusht për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Nga kjo pikëpamje mund të themi që kuptimi i ekzistencës së Komunitetit Europian konsiston, para së gjithash, pikërisht në zbatimin, pra, dhe interpretimin e njëjtë ose jo kontradiktor të rregullimeve të njëjta, apo të ngjashme ligjore dhe, çfarë është ndoshta më e rëndësishme, që të kenë pasoja të njëjta ose të ngjashme juridike, ekonomike, financiare dhe sociale për të gjitha subjektet komunitare. Për këtë mjafton të theksojmë se përafrimi ose harmonizimi i rregullave kombëtare, me qëllimin e nxitjes së realizimit të vazhdueshëm të tregut unik europian përbën edhe vetë thelbin dhe përse-në e veprimit normativ komunitar³.

Kjo bën të qartë se përafrimi i legjislacionit nuk është një kusht “tekanjuz” ose një “servitut” i vendosur nga Bashkimi Europian ndaj vendeve të treta që duan të aderojnë në të, por është kusht i ekzistencës së vetë tregut unik, vetë *raison d’être* i vetë Komunitetit dhe Bashkimit Europian. Ky pohim, përveçse mjaftueshmërisht i qartë nga ekzistenca e Kreut të 3 të Titullit VI të Traktatit të KE-së (*Nenet 94-97*), është ritheksuar dhe plotësuar edhe më tej nga jurisprudenca e GJED. Kështu, për shembull, në të famshmen *Rewe Zentrale AG kundër Bundesmonopolverëaltung für Brantwein*

³ Siç shprehet edhe vetë Komisioni në Librin e Bardhë për “Realizimin e Tregut Unik” të vitit 1985 – shih paragrafin 61 të tij.

(120/78) ose siç njihet më tepër *Cassis de Dijon*, Gjykata e theksonte qartë këtë ide⁴.

Pa synuar që të çfokusohet qëllimi kryesor i kësaj trajtese, vlera themelore merr zbardhja e përpjekjeve për të sqaruar thelbin e procesit, si dhe kuptimin e terminologjisë që shpreh procesin. Një teknikë e parapëlqyer nga doktrina tipike sistematike franceze është nisja e trajtesës nga qëndrime kryesisht teorike përgjithësuese, por që do të hidhte paksa dritë mbi disa koncepte bazë të këtij procesi.

Në kuadrin e procesit të përafrimit të sistemeve ligjore, pyetja e parë konsiston në lidhje me procedurën dhe nivelin e këtij përafrimi⁵. Të dyja këto probleme janë të lidhura ngushtë me nocionet e termave të ndryshëm të përdorur nga traktatet themeluese⁶ dhe nga doktrina. Në Traktatin e Romës sipas versionit fillestar, termi *përafrim* është përdorur në mjaft nene (nenet 3/h, 27⁷, 100, 100 a, 101, 102 dhe 117⁸). Traktati i Romës përdor, gjithashtu, edhe termat *bashkërendim* (nenet 56 dhe 57⁹) dhe *harmonizim* (nenet 99, 112, 117¹⁰). Përsa i përket termit *unifikim*, nuk mund ta gjejmë atë të përdorur

⁴ Shih në veçanti konkluzionet e Avokatit të Përgjithshëm Capotorti në lidhje me këtë çështje.

⁵ Pyetje që përbën edhe objektin e artikullit të Antoine Jeammaud “Unification, uniformisation, harmonisation: de quoi s’agit-il?” në *Vers un code européen de la consommation*, Bruylant, Bruxelles, 1998, fq. 35 e vijim.

⁶ Shih Bashkimi Europian – Përmbledhje Traktatesh, Qendra Europiane, Tiranë 2000.

⁷ Shfuqizuar nga Traktati i Amsterdimit.

⁸ Përkatesisht nenet 94, 95, 97 dhe 136 sipas versionit aktual të Traktatit të Romës, të ndryshuar nga Traktati i Amsterdimit.

⁹ Përkatesisht nenet 46 dhe 47 sipas versionit aktual të Traktatit të Romës, të ndryshuar nga Traktati i Amsterdimit.

¹⁰ Përkatesisht nenet 93, 132 dhe 136 sipas versionit aktual të Traktatit të Romës, të ndryshuar nga Traktati i Amsterdimit.

në asnjë prej neneve të traktateve. Në këtë shumëllojshmëri termash dhe pa ndonjë shpjegim ose rend të qartë nga ana e traktateve ose e Gjykatës së Luksemburgut, konfuzioni duket qart. Për këtë arsye merr vlera kjo përpjekje për sqarime teorike dhe logjike të këtyre termave edhe në lidhje me procesin e përafrimit me *acquis communautaire* të sistemeve ligjore të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore dhe kjo, para së gjithash, për shkak të nivelit dhe të llojit të masave që duhen ndërmarrë në kuadrin e këtij procesi.

Pra, në shumëllojshmërinë e termave të përdorur teknikisht do të dallonim:

- *Bashkërendim* si termin që nënkupton shmangien e kontrasteve ndërmjet dy dispozitave të ndryshme ligjore, pa ndryshuar thelbin e tyre.

- *Procesi i harmonizimit* kupton ndryshimin e përmbajtjes së akteve në nivelin e nevojshëm për të pasur një rezultat të zbatimit të normave të ndryshme

- *Unifikimi*, edhe pse nuk përmendet shprehimisht nga traktatet, gjen vend gjerësisht në kuptimin e tyre dhe në nene të ndryshme të tyre, si për shembull te neni 249 i Traktatit të Romës¹¹. Në këtë drejtim është shprehur, gjithashtu, edhe Gjykata e Drejtësisë në vendimet e famshme *Van Gend & Loos*¹² dhe *Costa kundër ENEL*¹³, në lidhje me të drejtën komunitare origjinale, dhe në vijim për të drejtën komunitare të derivuar në çështjen Politi kundër Ministero delle Finanze¹⁴ etj. Kështu këto norma, të zbatueshme drejtpërdrejt dhe, duke pasur një karakter parësor në zbatim, janë thjesht një e drejtë e unifikuar. Si proces pra, nënkupton zëvendësimin e akteve të brendshme normative me të njëjtën normë të përbashkët. Në këtë kuptim mund të trajtohen, gjithashtu, edhe marrëveshjet e stabilizim-asociimit, si një

¹¹ Ish-neni 189, sipas versionit aktual të Traktatit të Romës, të ndryshuar nga Traktati i Amsterdimit.

¹² Çështja 26/62, ECR – fq. 3.

¹³ Çështja 6/64, ECR – fq. 1141.

¹⁴ Çështja 43/71. ECR - fq.1039.

burim i përbashkët ose i unifikuar i së drejtës qoftë për Komunitetin Europian,¹⁵ qoftë për Shqipërinë në rastin tonë¹⁶.

□ Duhet theksuar që termi *përafrim* është konsideruar nga doktrina si më i përgjithshmi ndërmjet të gjithë të tjerëve të përdorur në këtë fushë¹⁷. Ai duket se përfshin të gjitha teknikat dhe termat e lartpërmendur duke nënkuptuar këtu edhe teknikat e “*new approach*” të lartpërmendur.

Sidoqoftë, vlen të theksohet se secili nga këto instrumente ka qenë varur nga një “rregull i njëjtë” i parashikuar me një tekst normativ të vetëm që ka pasur një formë konvencionale shumëpalëshe. Puna për përgatitjen e teksteve normative, qoftë të përafruara, të unifikuara ose të harmonizuara, si dhe për adoptimin e tyre e ka pasur të nevojshme vazhdimësinë kërkimore, ekspertizë në shkrimin e tyre, por edhe nivele të larta diplomacie.

Duhet vënë në dukje, gjithashtu, që përshtatja ligjore ndaj ekonomisë së tregut nuk kërkon vetëm vendosjen e një rendi ligjor të përshtatshëm në Shqipëri, siç edhe po arrihet pak nga pak nga mjete të ndryshme normative të përdorura. Por duhet theksuar që realizimi efektiv i një rendi ligjor, që e bën të mundur një ekonomi tregu, por edhe me tipare sociale, varet në vetvete edhe në një vullnet të qëndrueshëm politik. Probleme të veçanta, në veçanti në fushën e privatizimit dhe të ndërmarrjeve publike, ç’normativizimi, mbrojtja e interesit publikë, konkurrenca e lirë dhe ndihmat shtetërore, kërkojnë dhe

¹⁵ Në këtë drejtim shih jurisprudencën e GJ.E.D. në çështjet *International Fruit Company* (21-24/72, në ECR, fq. 1219), *Polydor* (270/80, në ECR fq.329), *Kupfenberg* (104/81), dhe sidomos përsa i përket Marrëveshjeve të Asocimit, *Demirel* (12/86 në ECR 3719).

¹⁶ Shih në kuadrin normativ shqiptar nenet 116 § 1, 122 dhe 123 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

¹⁷ Shih për shembull, Mireille Delmas-Marty në “Trois Défis pour un droit mondial”, Seuil, Paris, 1998, sidomos fq. 104-135, por gjithashtu Giannantonio Benacchio në “Diritto privato della Comunità Europea – Fonti, modelli, regole”, Cedam, Padova, 1998, fq. 14-31.

¹⁸ Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në rastin e Shqipërisë.

justifikojnë zgjidhje të ndryshme, të cilat duhet të mbajnë parasysh mbi të gjitha veçantitë e situatës shqiptare.

Pra, përafrimi nuk nënkupton domosdoshmërisht harmonizim, megjithëse, siç e përmendëm edhe më lart, në praktikë të dy këta terma shpesh ngatërrohen. Inotai vë në dukje mbi të gjitha karakterin funksional të përafrimit: ai duhet të krijojë “kushtet e funksionimit të tregut të përbashkët sipas Marrëveshjeve Europiane¹⁸”. Kjo nënkupton që përafrimi, *për se*, mund të arrihet si nëpërmjet mosrregullimit normativ, ashtu edhe nëpërmjet një legjislacioni të ri.

Është e rëndësishme, mendoj, në këtë pikë që të trajtohet shkurtimisht filozofia e Librit të Bardhë¹⁹ të Komisionit Delors, në lidhje me realizimin e tregut të përbashkët. Kjo, nga njëra anë, sepse strategjia e propozuar në këtë libër, e quajtur “*new approach*”²⁰ çoi faktikisht në realizimin e tregut të përbashkët dhe, nga ana tjetër, kjo strategji vlerësohet ende sot si më e përshtatshme për realizimin e një tregu “të pastër” të përbashkët. Duke u orientuar saktësisht në vlerësimin se tregu i përbashkët realizohet jo vetëm nëpërmjet heqjes së barrierave fizike në kufijtë e vendeve anëtare, por sidomos nëpërmjet zhdukjes të barrierave teknike dhe fiskale brenda territoreve të ndërsjellë të këtyre vendeve²¹, Libri i Bardhë propozon një strategji, e cila do të bëhet një motor me disa nivele normative shpejtësie, që rezultoi në përfundim i përshtatshëm për ritmet e integritit të tregut të përbashkët²². Me anë të kësaj strategjie, në fakt, ekzekutivi europian

¹⁹ COM (85) 310, 14 qershor 1985.

²⁰ Në mënyrë më të detajuar në lidhje me “*new approach*” shih ndër të tjera: Craig & De Burca – EU LAW, Text, Cases and Materials, 2nd ed. Oxford. Fq. 1104 – 1138 të shoqëruar nga një literaturë e plotë për këtë çështje.

²¹ Shih me kujdes strukturimin e Librit të Bardhë ku këto tri momente përbëjnë edhe tri pjesët e tij.

²² Në Librin e Bardhë Komisioni Delors shprehet se:

“60. ndërkohë që barrierat fizike... pengojnë shkëmbimet e lira dhe shtojnë kosto të papranueshme administrative (të paguara në fund të fundit nga konsumatori), barrierat e

konkretizonte në nivel strategjik jurisprudencën Dassoville²³ dhe më pas në Cassis de Dijon, të lartpërmendur, të G.J.E.D.

NË RAPORT ME SHQIPËRINË

Pra, anëtarësimi në Bashkimin European nënkupton para së gjithash zbatimin e së drejtës komunitare ose të masave specifike në interes të përbashkët. Por, nga ana tjetër, kjo nuk do të ishte e mundur pa një kuadër institucional të aftë që të mbështesë ritmin komunitar dhe një anëtarësim i mundshëm në Bashkimin European mund të kishte efektin e kundërt nga ai që mendohet për anëtarët e rinj, por edhe për ata të vjetër. E njëjta gjë mund të pohohet në parim edhe për marrëdhënie të tilla preferenciale si marrëveshjet e asociimit ose europiane, hapësira ekonomike europiane ose marrëveshjet e stabilizim-asociimit. Nga kjo pikëpamje pra, e një anëtarësimi ose asociimi vetëm formal, por edhe real e efektiv, përafrimi i legjislacionit bëhet një parakusht themelor për ndërmarrjen e këtyre hapave drejt Bashkimit European.

Pikërisht për këto arsye të përmendura deri këtu, takimi i nivelit të lartë të Kopenhagenit²⁴ parashtroi në konkluzionet e veta momentet vijuese si kritere për krijimin e marrëdhënieve preferenciale dhe më tej për aderimin e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore:

krijuara nga normativat dhe standardet e ndryshme shtetërore në lidhje me produktet kanë një efekt edhe më pengues: ato jo vetëm që shtojnë kosto të tjera, por shtrembërojnë karakteristikat e produkteve; shtojnë kostot e njësisve të prodhimit, kostot e mbajtjes së tyre; dekurajojnë bashkëpunimin në fushën e biznesit, duke penguar së tepërmi krijimin e një tregu të përbashkët për produktet industriale.”

²³ Çështja 8/74 e G.J.E.D.

²⁴ Takimi i nivelit të lartë të Kopenhagenit i 21 dhe 22 qershorit 1993. pavarësisht nga modifikimet dhe përshtatjet individuale të bëra në dhjetor 1999 dhe mars 2000 përkatësisht për vendet e Europës Qendrore Lindore dhe për Maltën dhe Qipron, kriteret e pranunara në Kopenhagen ngelen thelbësoret.

- Stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve.
- Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit dhe në veçanti “*acquis communautaire*”²⁵.
- Një ekonomi tregu funksionale²⁶.
- Aftësia për të përballuar trysinë konkurrenciale dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Europian.
- Bërja të vetat nga ana e çdo shteti kandidat të objektivave të bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.

Duke parë këto kritere²⁷ përshtypja është se përafrimi i legjislacionit nënkuptohet fare qartë në të paktën tri të parat prej tyre. Nga ana tjetër vlerësimi i rëndësisë së procesit pranohet edhe në mënyrë kontraktore në vetë marrëveshjet e stabilizim-asociimit²⁸ deri në arritjen e një përputhjeje të plotë me *acquis* normative komunitare²⁹.

Në trajtimin e kësaj çështjeje nuk mund të lihet pa përmendur përmbajtja themelore e *acquis communautaire* – parimet e përgjithshme të së drejtës

²⁵ Për një përkufizim të shkurtër të konceptit të *acquis communautaire* “L’Union Européenne et les défis de l’élargissement”, nën drejtimin e Mario Telò - Institut des Etudes Européennes, Bruxelles.

²⁶ Ky koncept është qartësuar nga ana e Komisionit Europian në komunikimin e tij “Agenda 2000” të 16 korrikut 1997.

²⁷ Të cilat, duke pasur parasysh preambulat e marrëveshjeve të stabilizim-asociimit me ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me Kroacinë, përbëjnë gjithmonë kriteret e zbatueshmë për anëtarësimin e vendeve të reja në BE.

²⁸ Shih nenin 68 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe nenin 69 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Kroacinë.

²⁹ Duke e vlerësuar gjithnjë si kriter themelor për pranimin e vendeve të reja në BE, takimi i nivelit të lartë të Luksemburgut parashikoi vënien në funksionim, që në fund të vitit 1998, të një Task-Force për zgjerimin e BE, e cila do të kryejë “analizën e progresit të arritur nga secili shtet kandidat i Europës Qendrore dhe Lindore në rrugën e aderimit, duke pasur parasysh kriteret e Kopenhagenit dhe, në veçanti, ritmet e adoptimit të *acquis* të Bashkimit”.

europiane, pa të cilat i gjithë sistemi institucional dhe material drejt të cilit duam të shkojmë nuk do të kishte qëndruar dot në këmbë deri tani. Duhet pasur parasysh në këtë kuadër që përafrimi me këto parime është konceptualisht më i rëndësishëm, por edhe më i vështirë se sa përafrimi me rregullime konkrete dispozitive komunitare. Roli kyç i Gjykatës Europiane të Drejtësisë, me jurisprudencën e saj, është ai që duhet pasur parasysh në mënyrë të veçantë si udhërrëfyese më i perceptueshëm për institucionet dhe juristët shqiptarë. Këto parime të referuara shprehimisht në nenin 6 të Traktatit të Bashkimit Europian (*ish neni F*) dhe në Pjesën e Parë të Traktatit të Komunitetit Europian, por edhe në dispozita të tjera të traktateve dhe në mënyrë të veçantë përpunuar nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë³⁰, megjithëse në një masë të madhe përbëjnë edhe parime të së drejtës shqiptare duhen vlerësuar edhe më me kujdes nën dritën e këtij procesi

³⁰ Sa për të përmendur disa nga vendimet më të rëndësishme që janë përpjekur të përcaktojnë këtë të drejtë të pashkruar europiane në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore – *Stauder* (29/69), *Internationale Handelsgesellschaft GmbH* (11/70), *Nold* (4/73), *Johnston* (222/84), *Rutili* (36/75), *ERT* (C-260/89), *Pecastaing* (98/79), *Watson and Belmann* (118/75) në lidhje me gjykimin e rregullt *Hoffman La-Roche* (85/76) por edhe *Partia e Gjelbër kundër Parlamentit Europian*, parimi i konfidencialitetit - *AM&S kundër Komisionit* (155/79), parimi i sigurisë juridike – *Defrene kundër Sabena Nr. 2* (43/75) parimi i mos prapaveprueshmërisë – *R kundër Kirk* (63/83) dhe përsëri *Defrene 2*, parimi i proporcionalitetit përveçse i parashikuar në nenin 5 § 3 të Traktatit KE është konsoliduar në një sërë çështjesh, duke filluar me *Internationale Handelsgesellschaft GmbH* (11/70) të lartpërmendur e deri me të famshmet *Rutili* (36/75) ose çështjen revolucionare *Cassis de Dijon* (120/78), parimi i barazisë i parashikuar në Nenin 12 të Traktatit KE është sqaruar dhe ritheksuar në *Sotgiu* (152/73) ose nga pikëpamja e përjashtimeve në *Jenkins* (96/80), parimi i subsidiaritetit në nenin 5 § 2 të Traktatit të KE, çështja e mjeteve ankimore për shkeljet e të drejtave të parashikuara nga traktatet, përveçse rrjedh nga neni 10 i Traktatit KE-së shprehen qartë edhe në jurisprudencën *Humblet* (6/60), *Salgoil* (13/68), *Rewe Zentralfinanz* (33/76) *Factortame 2* (C-213/89) etj., çështja e shpërbllimit të dëmeve të shkaktuara në *Marshall 2* (C-271/91), *Francovich & Bonifaci* (C-6 & 9/90), etj., ose çështja themelore e afateve të transpozimit të legjisllacionit në *Emmot* (C-208/90) apo *Cotter & McDermott* (C-377/89).

përafres legjislativ që është në të vërtetë më shumë një proces përafrimi i koncepteve dhe jo i dispozitave ligjore. Në analizë të fundit, në lidhje me këtë çast, nuk do të ishte e tepërt të theksonim se edhe hartimi i dispozitave të përafuara e madje edhe të unifikuara plotësisht, por që interpretohen duke mos patur parasysh parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare, nuk do të përbënte aspak realizim të procesit të përafrimit të legjislacionit, siç e kërkon realizimi i tregut të përbashkët europian³¹.

KUADRI LIGJOR

Sipas traktateve themeluese të KE-së

Siç e përmendëm edhe më lart, procesi i përafrimit të legjislacionit nuk është një proces që është vendosur vetëm ndaj vendeve joanëtarë që synojnë të forcojnë lidhjet e tyre me Komunitetin Europian, por shihet si një kusht dhe kriter themelor për funksionimin e tregut të përbashkët në të cilin operojnë tashmë shtetet anëtare dhe sistemet e tyre juridike. Për këtë arsye, Traktati i Romës, që në versionin e tij fillestar, e parashikonte shprehimisht këtë proces në dispozitat 100, 100 a, 101 dhe 102. Këto dispozita synonin të ndihmonin në krijimin e kushteve themelore për funksionimin e tregut të përbashkët. Për këtë arsye ato vazhdojnë të figurojnë edhe sot nën numërimin e ri pas Traktatit të Amsterdimit, përkatësisht si nenet 94, 95, 96 dhe 97 dhe ofrojnë bazën juridike për këtë mekanizëm. Sidoqoftë, këto dispozita duhet kujtuar se kanë detajime procedurale të neneve 10 dhe 14 të vetë Traktatit.

Përveç këtyre dispozitave, nuk mund të lihen pa u theksuar, megjithëse i përmendëm edhe më lart, efektet e jurispruencës së Gjykatës të

³¹ Mënyra të veçanta intrerpretimi duhen pasur parasysh, gjithashtu në këtë proces si për shembull përparësia e së drejtës komunitare në raport me të gjithë të drejtën e brendshme (*Costa kundër ENEL* e lartpërmendur), zbatueshmëria e drejtpërdrejtë (*Van Gend & Loos* e lartpërmendur), ose parimi thelbësor i interpretimit konform (jurisprudenca *Von Colson & Kamann*, C-14/83, *Marleasing*, C-106/89, apo *Wagner-Miret*, C-334/92).

Luksemburgut, sidomos në rastet Dassonville dhe Cassis de Dijon të lartpërmendura³², dhe roli i Librit të Bardhë të Komisionit Delors, gjithashtu i lartpërmendur, që e riorientoi dhe e kristalizoi këtë proces.

Nga ana tjetër, përshtatja e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore me ekonominë e tregut të Komunitetit European dhe me sistemin ligjor komunitar ka arritur një nivel të ri me intensifikimin e marrëdhënieve të ndërsjella. Si pasojë e ndryshimeve të thella politike, ekonomike, sociale dhe ligjore në Europën Qendrore dhe Lindore, komunitetet europiane vendosën në atë kohë të nisnin negociatat për mundësinë e përfundimit të marrëveshjeve të asociimit me shtetet e këtij rajoni, përfshirë këtu edhe Shqipërinë. Këtyre marrëveshjeve iu dha një emër i veçantë – marrëveshje europiane – duke pasur parasysh qëllimin përfundimtar, i cili ishte integrimi i këtyre vendeve në komunitetet europiane. Gjithsesi, baza ligjore për përfundimin e tyre nga këndvështrimi i së drejtës komunitare ngeli neni 310 (ish neni 238³³) i Traktatit Themelues të Komunitetit European. Duke qënë se Shqipëria, ashtu si edhe pjesa tjetër e Ballkanit Perëndimor, për shkak të vonesave në reforma dhe të krizave të brendshme ose rajonale ngeli jashtë këtij procesi, në takimin e nivelit të lartë të Zagrebit më 2000, Bashkimi European propozoi një strategji që u vlerësua si më e përshtatshme nga ana e tij për këto vende, pikërisht procesin e stabilizim-asociimit. Megjithëse ky proces ngjan së tepërmi me atë të asociimit të vendeve të tjera ish-komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore, ai është i distancuar në kohë nga i pari, të paktën 10 vjet dhe, duke pasur parasysh disa karakteristika më të theksuara të këtij rajoni, përmban angazhime më të veçanta në dy drejtime:

- konsolidimi i institucioneve demokratike dhe i shtetit të së drejtës;
- dhe bashkëpunimi rajonal.

³² Shih, për shembull, edhe vendimet e saj në *Francë kundër Komisionit* (C-41/93) në ECR I-1829, *Pubblico Ministero kundër Ratti* (148/78) në ECR 1629, *Ministère Public kundër Grunert* (88/79) ose edhe çështjet e përmendura në poshtëshënimin paraardhës.

MARRËVESHJET E STABILIZIM-ASOCIIMIT

Megjithëse të dyja këto ishin fusha të përfshira ndërkaq edhe në kuadrin e marrëveshjeve europiane dhe të të gjithë procesit të zgjerimit të BE-së, ato janë vlerësuar me një vëmendje të posaçme në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asociimit.

Përveç këtyre dy çasteve kryesore, Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit dhe procesi përkatës ngjajnë me marrëveshjet europiane dhe me procesin përkatës që tanimë duket se po çon në anëtarësimin e plotë të vendeve të asociuara në BE³⁴.

Në tërësi pra, thënë shkurtimisht, edhe këto marrëveshje të reja asociimi mund të thuhet se përfshijnë, gjithashtu, elementet e një klime politike të përgjithshme që duhet të gjejë gjithnjë e më tepër vend në Europë, kushtet për shkëmbime tregtare dhe investime, duke krijuar zona të tregtisë së lirë, kushtet për tranzicion të ekonomive të shteteve të Europës Qendrore në ekonomi të tregut, krijimin e stabilitetit financiar, si dhe përmasat njerëzore, sociale dhe kulturore. Është e qartë se me “kushte”, në përbërësit e mësipërm të marrëveshjeve të stabilizimit të llojit të ri, kuptohet më shumë se çdo gjë tjetër kushtet ligjore.

Për përmbushjen e këtyre kushteve, Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit kanë parashikuar nevojën për përafrimin e legjislacionit të vendeve të asociuara me të drejtën e Komunitetit European, si një kusht për krijimin e këtij niveli të ri marrëdhëniesh³⁵. Nga ana tjetër, dispozitat e marrëveshjeve në lidhje me përafrimin e legjislacionit duket se venë në dukje faktin se ka ende shumë punë për t’u bërë për t’i çuar sistemet ligjore të vendeve të asociuara në nivelin e standardeve që veprojnë në Komunitetin European.

³³ Deri përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit më 1 maj 1999.

³⁴ Duke filluar nga viti 2004, sipas kriterëve të parashikuara nga Traktati i Nisës dhe duke përfshirë 8 vende të Europës Qendrore dhe Lindore (mbeten jashtë Bullgaria dhe Rumania), si dhe duke përfshirë edhe Maltën dhe Qipron.

³⁵ Shih *considerandum* 11 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Në ndryshim nga Marrëveshja e HEE³⁶ (vendet KE + vendet EFTA³⁷) marrëveshjet e stabilizim-asociimit, po ashtu si edhe marrëveshjet europiane, nuk përmbajnë klauzola interpretuese, të cilat t'i detyrojnë palët që të interpretojnë dhe zbatojnë dispozitat e marrëveshjes në përputhje me vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë³⁸, çka është një çast shumë i rëndësishëm në kuadrin e zbatimit dhe të interpretimit të njëjtë të rregullave të marrëveshjes. Për këto arsye, ajo çka vendet EFTA arritën me anë të një marrëveshjeje të posaçme me Komunitetin – pikërisht marrëveshja e HEE – në kuadrin e Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit, ashtu si dhe në marrëveshjet europiane, filloi të rikonceptohet si një program legjislativ 'vullnetar' për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore për vitet në vijim, pa marrë, sidoqoftë, formën e një marrëveshjeje formale më vete ose pjesë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar, duke pasur parasysh edhe përvojat, mund të vazhdojë edhe pas periudhës 10-vjeçare të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sidomos në sektorët e bujqësisë, të shërbimeve ligjore dhe të drejtës së pronësisë.

³⁶ HEE – Hapësira Ekonomike Europiane, përfunduar në Porto më 2 maj 1992 dhe hyrë në fuqi më 1 janar 1994.

³⁷ EFTA – European Free Trade Association.

³⁸ Shih në lidhje me këtë mendimin këshillimor të Gjykatës Europiane të Drejtësisë 1/91 të 14 dhjetorit 1991.

Baza juridike e asociimit të vendeve të treta në Bashkimin Europian

Zhvillimet e reja të zgjerimit të tij në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Anastas Shuke

Jurist, specialist i së Drejtës

Ndërkombëtare në Ministrinë e Drejtësisë

HISTORIK I SHKURTËR NË VEND TË HYRJES

Mbarimi i luftës së ftohtë në Europë solli natyrshëm zhvillime të reja dhe ndryshime të thella në qëndrimin dhe strategjinë e Bashkimit Europian në drejtim të shteteve të Europës Qendrore dhe Lindore (VEQL). Këto vende, të dala nga sistemi i ekonomisë së centralizuar, tashmë përbënin një zonë shumë të rëndësishme, ku mund të shtrihej veprimtaria dhe ndikimi i Komunitetit Europian, duke qenë të mbështetura në një bazë juridike të qëndrueshme dhe të afirmuar dhe duke i zhvilluar ato më tej nëpërmjet ndryshimeve të nevojshme të traktateve të tij themelues dhe praktikës juridikionale të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

Në fakt, gjatë një periudhe kohore të shkurtër, këto traktate u pasuruan dhe u amenduan me koncepte dhe norma të reja, në përshtatje me përmasat që ky Komunitet tashmëprojektoonte të merrte në kontinentin europian.

Europa ka qenë tradicionalisht vatra qendrore e kontradiktave sa të vjetra, aq dhe të komplikuar midis shteteve të ndryshme, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore. KE dhe më vonë Bashkimi Europian ka përbërë gjithnjë organizmin më përmasor rajonal, përsa i takon karakterit dhe shumëllojshmërisë së veprimtarisë së tij,

i cili do ta shndërronte pjesën perëndimore të Europës në një fuqi të madhe ekonomike dhe burim mirëqenieje dhe sigurie sociale për popullsinë e vendeve anëtare të saj.

Në drejtim të vendeve të VEQL-së u përpunua një strategji e re, e cila u mbështet që në fillim në legjislacionin e këtij organizmi, i cili, me kushtet që përmbante për asociimin dhe anëtarësimin në BE, i nxiste këto vende për ndryshime të domosdoshme institucionale dhe ekonomike, duke zgjeruar njëkohësisht, drejt demokratizimit të tyre, kompetencat e strukturave drejtuese të vetë BE-së e, në veçanti, të Parlamentit të tij, lidhur me procedurat dhe zgjedhjen e vendeve për zgjerimin e tij në pjesën tjetër të Europës.

Me ndryshimet e reja që kanë ndodhur në legjislacionin e BE-së sigurohet një bashkësi politike dhe ekonomike e shteteve anëtare, duke ngushtuar kështu, me vullnet të lirë, në një masë të caktuar sovranitetin e tyre në shkëmbim të pjesëmarrjes në këtë bashkësi dhe të garantimit të të mirave të tjera në kushtet aktuale. Një vend -të veçantë vitet e fundit zë përpunimi prej BE-së i kërkesave dhe standardeve ligjore lidhur me vendet e Ballkanit dhe sidomos të atij Perëndimor. Ato janë konkretizuar tashmë si kondita dhe kërkesa të forta, të cilat i shtyjnë këto vende të çojnë përpara reformat e tyre të brendshme në fushën e institucioneve e në drejtime të tjera në kuadrin e një ekonomie tregu të vërtetë, por njëkohësisht dhe duke rritur ndihmën ekonomike për to, duke përdorur në veçanti si instrument ligjor Paktin e Stabilitetit.

Më poshtë do të përpiqemi të zbërthejmë dhe të komentojmë bazueshmërinë ligjore të marrëveshjeve që BE-ja ka përfunduar dhe do të nënshkruajë në të ardhmen me vendet e treta. Vëmendja kryesore është përqendruar në marrëveshjet me vendet e Ballkanit Perëndimor, midis të cilëve bën pjesë dhe Shqipëria. Në të janë parashtruar dhe argumentuar kërkesat dhe kushtet që duhet të plotësohen nga këto vende, procedurat që duhet të ndiqen, si dhe kompetencat që kanë organet e BE-së.

LEGJISLACIONI I BE-SË DHE KUSHTET PËR ASOCIIM DHE ANËTARËSIM NË BE PËR VENDET E TRETA

Bashkimi European, i krijuar si një vazhdim dhe forcim i mëtejshëm i bashkësive europiane, i mbështetur në Aktin Unik European të nënshkruar nga shumica e shteteve anëtare në Luksemburg më 17.2.1986 dhe në Hagë më 28.2.1986, ndërsa nga Italia pak më vonë dhe i hyrë në fuqi përfundimisht më 1.7.1987, ka personalitetin e tij juridik të afirmuar plotësisht. Kjo, veç të tjerave, duket qartë në gjithë veprimtarinë e tij në fushën e marrëdhënieve me jashtë dhe, në veçanti, në traktatet dhe marrëveshjet e ndryshme që ka përfunduar me shtete dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Kjo veprimtari e ka bazën e saj ligjore që në Traktatin e themelimit të Komunitetit Ekonomik European (KEE), përfunduar në Romë më 25.3.1957 dhe është pasuar më tej më intensivisht me ndryshimet e rëndësishme të mëvonshme që i janë bërë atij në vazhdimësi pas krijimit të Bashkimit European, i cili institucionalizoi bashkimin politik të shteteve anëtare të Komunitetit European, pa prekur bashkimin juridik komunitar, si dhe parashikoi harmonizimin e mëtejshëm të legjislacioneve kombëtare të shteteve anëtare

Midis traktateve dhe marrëveshjeve që ka përfunduar Komuniteti European, një vend të veçantë zënë ato të asociimit të vendeve të treta, për të cilat, ndryshe nga traktati i Komunitetit European të Qymyrit dhe Çelikut të vitit 1951 (KEQÇ), Traktati themelues përmban dispozita të qarta që rregullojnë këtë shoqërim. E evidentojmë këtë veçori jo vetëm se është parimore dhe thelbësore nga pikëpamja e së drejtës dhe e statusit të këtij organizmi të fuqishëm ndërkombëtar, por dhe për të hedhur dritë në strategjinë dhe synimet praktike të themeluesve të tij për të ardhmen. Është fakt që ky problem ligjor ka dalë qartë në rastin e përfundimit të marrëveshjes së shoqërimimit të Britanisë së Madhe me KEQÇ në kushtet e mungesës së një norme të tillë në traktatin e këtij Komuniteti.

Lidhur me KEE theksojmë se në nenin 310 (ish 238) të traktatit të tij përcaktohet: “Komuniteti mund të përfundojë me një shtet të tretë, me një

bashkim shtetesh ose organizata ndërkombëtare, marrëveshje që krijojnë një asociim që përmban të drejta dhe detyrime të ndërsjella, veprime të përbashkëta dhe procedura të posaçme”¹.

Janë pikërisht këto tipare kryesore në përmbajtje të këtyre marrëveshjeve që i bëjnë ato të ndryshojnë në themel nga marrëveshjet e ndryshme tregtare dhe të bashkëpunimit që janë përfunduar nga Komuniteti në të kaluarën. Koha solli një larmi në llojet e këtyre traktateve dhe, megjithëse është vështirë të përcaktohen saktësisht përmbajtjet e çdo marrëveshjeje shoqërizimi, janë disa tipare thelbësore të tyre që e bëjnë të mundur që, nga aspekti teorik dhe në një kuptim abstrakt, ato të dallohen nga këto marrëveshje që përmendëm ose nga ato të aderimit.

Kështu, p.sh., në marrëveshjet tregtare përmbahen vetëm të drejta dhe detyrime të palëve kontraktuese si partnere të barabarta që priren thjesht nga përfitimi i ndërsjellë nga shkëmbimi i mallrave dhe kushtet lehtësuese për njëra-tjetrën, por në to mungojnë veprime të përbashkëta dhe procedura të veçanta për përfundimin e tyre. Po kështu, gama e problemeve të marrëveshjeve të shoqërizimit është shumë më e gjerë (si në numër dhe në karakterin e tyre) sesa ato tregtare, të cilat zakonisht rregullojnë vetëm shkëmbimet tregtare dhe regjimet që mund t’i japin palët mallrave, mjeteve të transportit dhe të lundrimit për qëllime të tilla etj.

Procedura e përfundimit të marrëveshjeve të lartpërmendura, bazuar në dispozitat e traktatit dhe me saktësimet e mëtejshme që ka pësuar më vonë, është e posaçme. Kjo është arsyeja dhe sidomos për shkak të karakterit të stadi aktual kur shteti ynë ndodhet në prag të fillimit të negociatave me BE-në për përfundimin e marrëveshjes së asociimit, që organet kompetente të administratës publike dhe ato gjyqësore e të prokurorisë të njihen sa më

¹ Bashkimi Europian: Përmbledhje traktatesh; Botim i Qendrës Europiane, Tirane 2000, faqe 255.

mirë me të, për të mundur të lehtësohet përballimi i problemeve që do të dalin në këtë kuadër. Në fakt, mbështetur në nenin 228 të Traktatit, ashtu si dhe për marrëveshjet e tjera, bisedimet lidhur me marrëveshjen i zhvillon Komisioni, ndërsa nënshkrimin e saj e bën Këshilli, i cili, në bazë të paragrafit të dytë të nenit 238, për këtë duhet të marrë një vendim unanim pasi të jetë këshilluar me Parlamentin.

Procedura në fjalë ka ardhur duke u ndryshuar në drejtim të ritheksimit të funksionit të Parlamentit në të dhe të shteteve anëtare të Komunitetit. Problemi fillimisht ka lindur që në rastin e përfundimit të marrëveshjes së shoqërizimit me një vend mesdhetar, siç ishte Greqia në korrik të vitit 1961, pasi mendimi i Parlamentit u mor pas nënshkrimit të saj nga Këshilli. Kjo u konsiderua si një veprim pa vlerë, sepse teksti i marrëveshjes nuk mund të ndryshohej pas mbylljes së fazës së bisedimeve. Kjo ishte pasojë e një interpretimi të ngushtë nga ana e Këshillit të nenit 238 të Traktatit, i cili ngjalli kundërshtimin e fortë të Parlamentit të Komunitetit.

Rezultat i këtij reagimi ka qenë adoptimi nga KEE i një procedure të veçantë këshillimi me Parlamentin, në bazë të së cilës çdo hapje bisedimesh, duhej të paraprihej nga një debat parlamentar dhe që gjatë bisedimeve duhej të këshillohej në vazhdimësi me komisionet paralametare kompetente. Po kështu, pas bisedimeve Këshilli duhet t'i jepte Parlamentit një informacion përpara nënshkrimit të marrëveshjes. Kjo është quajtur dhe "procedura Luns" sipas emrit të propozuesit të saj.

Mangësitë që kishte kjo lloj procedure si në kuptimin e marrëdhënieve të institucioneve drejtuese me njëri-tjetrin, ashtu dhe nga pikëpamja formalo-juridike, diktuan si domosdoshmëri që ajo të kishte zhvillime të tjera të reja, tashmë të karakterit ligjor dhe praktik, duke sjellë ndryshimet përkatëse në Traktatin e themelimit. Konkretisht, një gjë e tillë u realizua me nënshkrimin e Aktit Unik Europian me 1986, i cili, veç të tjerave, nenin 238, paragrafin e dytë e ndryshoi duke përcaktuar lidhur me marrëveshjet se ato "përfundohen nga Këshilli, i cili vepron në unanimitet dhe pas mendimit të favorshëm

paraprak të Parlamentit European që shprehet me shumicë absolute të anëtarëve që e përbëjnë”²

Këtej del natyrshëm dhe rritja e rolit të Parlamentit, i cili me një shumicë absolute që kërkohet, mund të krijojë vështirësi dhe të zvarrisë për shkaqe të ndryshme, përfundimin e një marrëveshjeje shoqërizimi të ndonjë shteti. Duke zotëruar këtë procedurë juridike, lidhur me rolin e Parlamentit, është më se e kuptueshme që, krahas reformave të brendshme e zhvillimeve të rekomanduara nga Komisioni, ka rëndësinë e vet të dorës së parë edhe veprimtaria diplomatike e shtetit që kërkon të asociohet me shtetet anëtare të BE-së.

Problemet e tjera që kanë qenë lidhur me rastin, kur nga marrëveshjet e tjera të shoqërizimit dilte nevoja e miratimit paraprak të ndryshimeve në Traktat për shkak të vështirësive dhe kompleksitetit që do të kishte kjo mënyrë të vepruari, u zgjidhen duke u vendosur që në përfundimin e marrëveshjeve të shoqërizimit të mos merret pjesë vetëm Këshilli, por njëkohësisht dhe të gjitha shtetet anëtare të Komunitetit, duke vijuar më tej me ratifikimin nga këta të fundit. Në këtë mënyrë, këto marrëveshje konsiderohen si “marrëveshje të përziera” të Komunitetit, në të cilat përveç Komunitetit kanë kompetenca në marrëdhëniet e tyre me jashtë dhe shtetet anëtare. Kjo i bën ato më se të vlefshme dhe të frytshme, duke respektuar në mënyrë shumë të dukshme sovranitetin e çdo shteti anëtar, lidhur me zgjerimin e mëtejshëm të Komunitetit European.

Pavarësisht nga rritja e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shteteve anëtare në përfundimin e këtyre marrëveshjeve, kjo nuk e ndryshon faktin se ato janë akte dypalëshe midis Bashkimit European dhe shtetit që shoqërizohet, pasi në përmbajtje të drejtat e detyrimet, si dhe veprimet e përbashkëta, kryhen mbi bazën e këtyre marrëveshjeve pikërisht midis këtyre dy palëve. Po kështu, kjo duket qartë dhe në mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

² Shih: How does the European Union work. L-2985 Luxembourg, 1996, F. 7-9

dhe kjo përcaktohet në mënyrë të shprehur si probleme të të dy palëve³.

Për këtë karakter dypalësh dëshmojnë dhe organet që krijohen mbi bazën e këtyre marrëveshjeve, siç është Këshilli i Shoqërizimit. Ky organ përbëhet në numër të barabartë nga përfaqësues të të dyja këtyre palëve dhe vendimet i merr me unanimitet, lidhur me zbatimin e marrëveshjes për çështje që kanë të bëjnë me dy palët dhe janë të detyrueshme për to. Shembull i freskët mund të shërbejë Marrëveshja e Stabilizimit-Asociimit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, e nënshkruar në prill të viti 2001. Në nenin 112 është parashikuar krijimi i këtij institucioni bilateral me pushtetet përkatëse, duke përcaktuar se “është krijuar Këshilli i Stabilizimit-Asociimit, i cili do të mbikëqyrë zbatimin dhe implementimin e kësaj Marrëveshjeje. Ai do të mbliidhet në nivel ministerial në periudha kohë të rregullta dhe kur ta kërkojnë rrethanat. Ai do të shqyrtojë çështjet e rëndësishme që mund të lindin në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo çështje tjetër dypalëshe ose ndërkombëtare me interes të përbashkët.”

Këshilli krijon disa komitete të posaçme për të ndihmuar Komisionin në punën e tij, por rëndësi të veçantë ka Komiteti i Shoqërizimit, i cili ka për detyrë të sigurojë vazhdimësinë e bashkëpunimit të nevojshëm për zbatimin e mirë të Marrëveshjes dhe të përgatisë vendimet përkatëse të Këshillit.

Është me interes të vihet në dukje se marrëveshjet e shoqërizimit zgjidhjen e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve, që mund të lindin lidhur me zbatimin dhe interpretimin e saj, ia ka ngarkuar Këshillit të Shoqërizimit, pa parashikuar asnjë gjykatë drejtësie për çështje të tilla. Është në kompetencën e këtij Këshilli që në raste të caktuara mund t’ia parashtrijë konfliktin eventual Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Europiane, ose më pas, në bazë të disa marrëveshjeve të veçanta, një arbitrazhi.

³ Shih : Fausto Pocar: “E drejta e komuniteteve europiane”, Tirane 1995, “LOGORECT”, faqe 57.

Komuniteti European, me krijimin e lidhjeve të shoqërizimit nëpërmjet marrëveshjeve doganore dhe të bashkëpunimit me shtetet e treta, më të ngushta se ato tregtare normale, por pa synime anëtarësimi në Bashkimin European, ka mundur të fitojë tregje të reja dhe të zgjerojë mundësitë për lidhje tregtare në kushte të favorshme mbi baza të ndërsjella me mjaft shtete europiane. Fillimisht kjo ka qenë e drejtuar te shtetet mesdhetare në bazë të një strategjie të bashkërenduar të strukturave të tij me synime të qarta ekonomiko-tregtare. Traktati i themelimit në nenin 237 u lejon vetëm shteteve europiane të kërkojnë të bëhen anëtarë të komuniteteve europiane, por në periudhën e parë lidhjet e tyre me shtete të tilla kanë qenë kufizuar kryesisht në ato doganore dhe tregtare.

Në këtë kuadër, marrëveshja e parë është përfunduar me Greqinë që më 9 korrik 1961 dhe hyri në fuqi më 1 nëntor 1962 për një bashkim doganor, por zbatimi i saj u zvarrit për arsye të njohura të zhvillimeve të brendshme të këtij shteti në këtë periudhë dhe për mungesë të organeve të zgjedhura parlamentare. Me krijimin e kushteve të përshtatshme demokratike, Greqia më vonë u pranua si anëtare e këtij Komuniteti.

Marrëveshja e Shoqërizimit me Turqinë u përfundua më 12.9.1963 dhe hyri në fuqi më 1.12.1964. Ajo synonte krijimin e një bashkimi doganor nëpërmjet një faze përgatitore pesëvjeçare, mbi bazën e përfitimeve të ndërsjella, gjithnjë duke i dhënë një rëndësi të veçantë, veç të tjerave, plotësimi të kushteve dhe rekomandimeve të Komunitetit, lidhur me zhvillimet e brendshme të vendit. Anëtarësimi i Turqisë në BE, për disa arsye që lidhen me këto zhvillime, ende nuk është bërë dhe, në bazë të vendimit të kohëve të fundit të Këshillit të BE-së, bisedimet për këtë problem me këtë shtet parashikohet të fillojnë vetëm në vitin 2005.

Po kështu, duhet përmendur Marrëveshja e Shoqërizimit me Maltën, nënshkruar më 5.12.1970 dhe hyrë në fuqi më 1.4.1971, e cila, gjithashtu, parashikonte një bashkim doganor nëpërmjet dy etapave pesëvjeçare. Megjithatë, për arsye të ndryshme të zhvillimit të Maltës, ajo ende nuk është pranuar anëtare në BE.

Me Qipron, Marrëveshja e Shoqërizimit është nënshkruar me 19.12.1972 dhe ka hyrë në fuqi më 1.6.1973 dhe nga përmbajtja dhe synimet ka qenë e ngjajshme me atë të Maltës. Edhe në këtë rast, për shkaqe të njohura politike të lidhura me ngjarjet në këtë vend dhe marrëdhëniet midis dy komuniteteve, fillimi i bisedimeve për anëtarësimin e tij janë shtyrë vazhdimisht, duke mos u çuar ende deri në fund arritja e qëllimeve të vëna në fillim lidhur me këtë shtet mesdhetar.

Duke pasur parasysh klauzolën e nenit 237 të Traktatit, lidhur me shtetet që mund të kërkojnë anëtarësimin në Komunitetet, bazueshmëria juridike e shteteve që kanë marrëveshje shoqërizimi me BE-në është më e gjerë se ajo e shteteve të tjerë joeuropiane. Ajo nuk kufizohet vetëm me dispozitat e nenit 117 të Traktatit, por detyrimisht duhet të shtrihet dhe në nenin 238 të tij dhe në vendimet e mëvonshme që kanë marrë mbledhjet e nivelit të lartë të BE-së lidhur me asociimet e shteteve të rajoneve të ndryshme dhe në përgjithësi ato që janë marrë në kuadrin e procesit të zmadhimit të këtij Komuniteti, të cilat vitet e fundit kanë pasur ndikime të rëndësishme në dimensionimin dhe zhvillimin e brendshëm të këtij grupimi evropian, të së drejtës komunitare dhe të *acquis communautaire* në tërësi⁴.

Marrëveshjet e lartpërmendura të shoqërizimit me vendet evropiane të pellgut të Mesdheut, përveç çështjeve të mësipërme, lejojnë dhe mundësinë e arritjes së një pikësnyimi final, anëtarësimin e tyre në BE. Në fakt, marrëveshje shoqërizimi Komuniteti ka përfunduar dhe me shtete të tjera mesdhetare të Azisë dhe Afrikës, por nuk e kanë perspektivën e anëtarësimin në këtë organizëm evropian, përderisa vazhdon të veprojnë neni 237 i Traktatit, që përcakton kriteret e këtij anëtarësimi. Mbase është kjo arsyeja që këto

⁴ “*Acquis Communautaire*” është trupi legjislativ i BE-se, i cili përbëhet nga tërësia e parimeve dhe politikave të Traktateve, të legjislationit parësor dhe dytësor, të detyrimeve kontraktore ndërkombëtare, duke përfshirë, gjithashtu, dhe zbatimin e këtij rendi ligjor nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

marrëveshje nuk e përmbajnë fjalën “shoqërizim”, por janë emërtuar si marrëveshje të bashkëpunimit tregtar, industrial, teknik etj. Të këtij karakteri janë për shembull marrëveshjet e viteve 1976-1978 me vendet afrikane të Magrebit, marrëveshja e bashkëpunimit industrial, teknik dhe financiar me Izraelin dhe të tjera akte të tilla. Një vëmendje të veçantë si kategori e posaçme kanë marrëveshjet e Komunitetit me shtetet e Afrikës që kanë pasur marrëdhënie të veçanta në të kaluarën me shtetet anëtare të tij, për të cilat është treguar kujdes, për t’i ruajtur që në Traktatin themelues të Komunitetit, duke iu kushtuar një vend të veçantë dhe duke i quajtur ato “vende dhe territore të përtejdetit.”

Marrëveshjet e këtij grupi kanë qenë motivuar nga interesi i sigurimit të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të këtyre vendeve, duke e bazuar këtë shoqërizim në nenet 131-136 të Traktatit. Por me fitimin e pavarësisë nga këto vende është gjetur një rregullim i posaçëm i marrëdhënieve nëpërmjet një sërë aktesh ndërkombëtare shumëpalëshe. Ky problem mund të shërbejë si një temë e veçantë studimi, por është rasti të mos lihet pa e vënë në dukje Konventën e katërt të përfunduar në Lomes të Togos më 15.12.1989 midis 69 shteteve të Afrikës, Karaibeve dhe të Oqeanit Paqësor, në bazë të së cilës këto shtete i kanë dhënë Komunitetit European regjimin e kombit më të favorizuar, në shkëmbim të hyrjes të lirshme pa tatim doganor në territoret e tij të 45 për qind të vlerës të mallrave të këtyre shteteve. Po kështu, të dyja palët kanë institucionalizuar me akte të veçanta blerjen te këto vende nga Komunitetit, çdo vit, me një çmim më të lartë se çmimi botëror, të një sasive të caktuar sheqeri nga kallami, si dhe kanë përcaktuar sasive minimale vjetore të prodhimeve kryesore bujqësore dhe blegtorale të këtyre vendeve; për t’u eksportuar në shtetet e BE-së.

Nga sa u tha më lart, bëhet e qartë se marrëveshjet e shoqërimit me shtetet europiane konsiderohen si instrumente juridike të paraprimit të një shteti në Bashkimin European. Në nenet 6 dhe 49 të Traktatit themelues të Komunitetit European janë përcaktuar parimet dhe kushtet e përgjithshme të

pranimit në këtë organizëm, midis të cilave janë parimet e demokracisë, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të funksionimit të shtetit të së drejtës, duke iu referuar shprehimisht Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (Romë 4.11.1950). Po kështu, ato janë konsideruar si parime të përgjithshme të së drejtës komunitare. Gjithashtu, si kusht është përcaktuar dhe respektimi i identitetit kombëtar të shteteve anëtare të tij.

Në nenin 49 të Traktatit është ligjëruar fakti, që kushtet e tjera përveç këtyre parimeve të përgjithshme për pranimin në BE, do të jenë objekt i një marrëveshjeje ndërmjet shteteve anëtare dhe shtetit kërkues, e cila do t'i nënshtrohet ratifikimit nga ana e të gjithë shteteve palë, në përputhje me rregullat e tyre kushtetuese.

KUSHTET PËR ASOCIIM TË VENDEVE TË EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE PËRFSHIRË BALLKANIN PERËNDIMOR

Historia e zhvillimit të Bashkimit Europian përmban si element thelbësor zhvillimin dhe pasurimin me veçoritë përkatëse për çdo rast edhe të bazueshmërisë ligjore të procesit të shoqërizimit dhe anëtarësimit në BE. Për të qenë më afër problematikës që i intereson shtetit tonë, në vazhdim të procesit të integritit të tij europian, është e nevojshëm të përqendrohemi në kushtet dhe kërkesat ligjore që ai ka paraqitur për Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit.

Në lidhje të ngushtë me çështjet e mësipërme është fakti që, në dhjetor të vitit 2000 shtetet anëtare të BE-së hartuan “Traktatin e Nisës”, me anën e të cilit, për herë të parë pas krijimit të tij, parashikohet zgjerimi i BE-së me pranimin në gjirin e tij të shteteve të dala nga sistemi i ekonomisë së centralizuar dhe regjimi komunist. Kështu, dhjetë shtete të Europës Qendrore dhe Lindore, si dhe Malta e Qipro, në këtë Traktat parashikohej të pranoheshin në BE, duke filluar nga viti 2003. Traktati ka parasysh që ndryshimet e brendshme

institucionale dhe ekonomike do të jenë përcaktuese, për të ndikuar në pranimin e këtyre shteteve.

Problem të veçantë paraqesin vendet e Ballkanit Perëndimor, për shkak të gjendjes në këto vende dhe konkretisht lidhur me ngjarjet në Shqipëri në vitin 1997, me konfliktin e armatosur në Kosovë dhe me gjendjen ndëretnike në Maqedoni. Zgjerimi i BE-së në vendet e këtij rajoni filloi në prill 2001 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit dhe me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Qëndrimi i mësipërm kuptohet që ka më tepër, motive politike në origjinën e tij, por bazueshmëria e tij ligjore konsiston në vendimet e mëparshme të marra në mbledhje të ndryshme të organeve drejtuese të BE-së, lidhur me të ardhmen e vendeve të këtyre pjesëve dhe rajoneve të Europës. Kështu, në Deklaratën e Kopenhagenit të Këshillit të Europës në vitin 1993, përveç kushteve të përgjithshme të neneve 6 dhe 49 të Traktatit, u përcaktua qartë se çfarë shkalle zhvillimi duhet të kishin arritur këto vende për t'u përgatitur për pranim. Ato përbëheshin nga katër pika thelbësore: stabiliteti politik, ekzistenca e ekonomisë së tregut, aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit dhe përafrimi i legjislacionit të tyre kombëtar me atë të Komunitetit dhe zbatimi i tij me frytshmëri nëpërmjet strukturave të përshtatshme administrative dhe gjyqësore.

Në vazhdim të Deklaratës së Kopenhagenit, Këshilli i Europës në Essen në dhjetor 1994 përpunoi gjithë strategjinë e BE-së për parapranimin e shteteve të Europës Qendrore dhe Lindore, ndërsa në vitin 1995 Komisioni i BE-së botoi Librin e Bardhë, për të ndihmuar këto vende se si duhet të përgatiteshin për t'u përgjigjur kërkesave të tregut të brendshëm të këtij Bashkimi.

Në Librin e Bardhë janë parashtuar e gjithë filozofia, politika dhe konceptet juridiko-ndërkombëtare të organizimit dhe funksionimit të kësaj organizate rajonale ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kartës së OKB-së. Si boshjt kryesor i veprimtarisë së saj përcaktohet integrimi ekonomik i shteteve anëtare, nëpërmjet një tregu të brendshëm pa kufi, që duhet të

garantojë nivele më të larta punësimi dhe sociale, standarde më të larta jetese, një bashkëpunim dhe bashkërendim më të mirë ekonomik dhe social, mbrojtje të mjedisit etj. Në libër jepet dhe legjislacioni komunitar që do të përbëjë kuadrin ligjor për arritjen e këtyre rezultateve ekonomike dhe sociale dhe që do të jetë një fushë, së cilës shtetet e asociuara duhet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë.

Nga ana tjetër, në Librin e Bardhë është zbërthyer strategjia dhe programi i saj afatshkurtër dhe afatgjatë, sipas fushave të bashkëpunimit ndërkomunitar, duke e shoqëruar dhe mbështetur atë dhe në legjislacionin parësor dhe dytësor të BE-së, me qëllim që vendet kandidatë të ndihmohen në përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit të tyre me atë të BE-së.

Mbledhja e Ministrave të Jashtëm të BE-së, mbajtur në Luksemburg më 16 qershor të këtij viti vendosi që, 10 shtete të reja: Polonia, Hungaria, Sllovenia, Republika Çeke, Sllovakia, Qipro, Malta, Letonia, Lituania dhe Estonia do të hyjnë zyrtarisht si anëtare në BE me të drejta të plota në muajin maj 2004. Pas tyre pritet të pranohen në vitin 2007 dhe Rumania me Bullgarinë.

Nga sa parashtruam më lart, del i qartë i gjithë kompleksiteti i bazueshmërisë ligjore dhe i strukturave drejtuese të BE-së, që merren me përfundimin e marrëveshjeve të shoqërizimit të shteteve europiane, si dhe me monitorimin e zbatimit të tyre. Kështu, në vitet 1990 u arritën të nënshkruhen të tilla marrëveshje që njihen si “Marrëveshje të Europës” me dy grupet e para të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, duke u dhënë atyre një status asociimi, si mundësi që brenda një afati kohor afro dhjetëvjeçar me dy faza të anëtarësohen në BE. Përmbajtja e tyre synon arritjen e lirive ekonomike, në të cilat mbështetet BE-ja dhe tregu i brendshëm, si dhe në masa të veçanta lidhur me përafrimin e legjislacionit, siç e theksua dhe më lart. Më konkretisht, ato parashikojnë krijimin e bashkimit doganor, shkëmbimet e lira tregtare, si dhe ndihmë ekonomike. Këto elemente kryesore të tyre paraqesin interes dhe për vendin tonë në zbatimin e strategjisë së tij lidhur me integrimin europian dhe shoqërizimin (asociimin) në BE.

Lidhur me Shqipërinë dhe shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor tashmë janë vijëzuar linjat kryesore të aktit me të cilin do të sigurohet statusi i asociimit nëpërmjet një marrëveshjeje Stabilizimi-Asociimi (SAA). Mbarimi i luftës në Kosovë përbën një kufi kohor kur BE-ja nxori përfundime të reja lidhur me qëndrimin e tij për anëtarësimin e këtyre shteteve, i kushtëzuar drejtpërsëdrejti nga problemet e veçanta të këtij rajoni, duke dalë në plan të parë ato të stabilitetit politik në çdo vend dhe në rajon.

Kështu, në maj 1999, Komisioni Europian filloi procesin e stabilizim-asociimit, duke u dhënë mundësinë për herë të parë këtyre vendeve të integrohen në BE, në varësi të kushteve dhe zhvillimeve të brendshme të çdo shteti.

Me nismën e BE-së në Cologne, më 9 qershor 1999, u nënshkrua një Pakt Stabiliteti për Europën Juglindore nga 40 vende dhe organizata, të cilët morrën përsipër forcimin e gjendjes në vendet e këtij rajoni “në përpjekjet e tyre për të siguruar paqen, demokracinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe prosperitetin ekonomik, me qëllim që të arrihet stabiliteti në të gjithë rajonin.”

Ky Pakt ishte zbatimi i metodës së pranuar nga BE-ja për negociata të tryezave rajonale, që është një zbrërthim zonal i Paktit të Stabilitetit, të përfunduar në Paris, më 21 mars 1995, në vazhdim të Traktatit të Mastrihitit. Por ky akt kishte rëndësi të veçantë për rajonin e vendit tonë, pasi ishte e para përpjekje serioze e komunitetit ndërkombëtar për të zëvendësuar politikën e ndërhyrjes në krizat e mëparshme shpërthyes me një strategji afatgjatë për parandalimin e konflikteve midis shteteve të këtij rajoni ose brenda tyre, siç ndodhi në Kosovë dhe në Maqedoni.

Ideja e tij ka lindur që në vitin 1998 dhe para luftës në Kosovë, por roli i njohur i NATO-s në të shërbeu si katalizator i forcimit të vullnetit politik për veprime të bashkërenduara dhe parandaluese në rajon⁵.

⁵ Shih: Pascal Fontaine “A new idea for Europe. The Schuman declaration – 1950-2000”, bot. II-te, nga Komisioni Europian, viti 2000, f.29-31.

Partneriteti shumë i gjerë në këtë Pakt dëshmon qartë për rëndësinë e tij. Ai u nënshkrua nga BE-ja dhe shtetet e tij anëtare, nga Shqipëria dhe vende të tjerë të Ballkanit Perëndimor, nga shtete joanëtare të BE-së, pjesëtare të Grupit të të 8-ve si SHBA, Kanadaja, Japonia dhe Rusia dhe vende të tjera si Norvegjia dhe Zvicra. Në të marrin pjesë organizata të tilla ndërkombëtare si OKB, OSBE, Këshilli i Europës, NATO, OECD, UNHCR, OECD dhe institucione financiare si Banka Botërore, Iniciativa e Detit të Zi për Bashkëpunim Ekonomik etj.

Pakti i Stabilitetit është një deklaratë angazhimesh dhe një marrëveshje kornizë e bashkëpunimit ndërkombëtar, për të vënë në jetë një strategji shumëpalëshe të partnerëve të këtyre akteve, për të siguruar stabilitetin dhe rritjen ekonomike në Europën Juglindore.

Përmbajtja e Paktit është në përshatje me mësimet e nxjerra nga ngjarjet e kohëve të fundit, siç ishte lufta në Kosovë në vitin 1999, të cilat provuan qartë se parandalimi i konflikteve dhe ndërtimi me sukses i paqes mund të kishin sukses në qoftë se do të merreshin masa të forta, të bashkërenduara në tri drejtime kryesore:

1. Në krijimin e një mjedisi të sigurt;
2. në vendosjen e një sistemi demokratik të qëndrueshëm; dhe
3. në sigurimin e një mirëqënieje ekonomike dhe sociale të këtyre vendeve.

Në kuadër të marrjes së këtyre masave është edhe premtimi për integrimin euroatlantik që iu dha vendeve të këtij rajoni në Sarajevë një muaj më vonë, më 30 korrik të atij viti, nga mbledhja e nivelit të lartë të BE-së.

BE, në dokumentin themelues, u zotua të luajë rolin drejtues në Paktin e Stabilitetit dhe u angazhua që t'i mbajë vendet e Europës Juglindore më afër te perspektivat e një integrimi të plotë me strukturat e tij, duke përfshirë dhe një anëtarësi të plotë të tyre në të. Në fakt, BE-ja dhe shtetet anëtare të tij janë donatorët më të mëdhenj në këtë rajon. Për sa u takon vendeve të rajonit në fjalë, duhet që në parim të jenë për një anëtarësi të plotë në BE dhe, në radhë të parë, të pranojnë kushtet minimale, të përcaktuara nga

Këshilli i BE-së në mbledhjen e nivelit të lartë në Amsterdam, më 29 prill 1997, lidhur me reformat demokratike në fushën ekonomike dhe atë institucionale.

Kështu, si ndihmesë në Paktin e Stabilitetit dhe si një hap më tej drejt anëtarësimit në BE u konsiderua projektimi i një vargu marrëveshjesh stabilizim-asociimi. Ato u destinuan për pesë vendet e rajonit, ku hyjnë Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kroacia, Republika Federative e Jugosllavisë dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë. Marrëveshja e parë SAA është nënshkruar me Maqedoninë dhe më pas me Kroacinë në tetor 2001. Duket që marrëveshja me Maqedoninë do të shërbejë si shembull dhe për atë me vendin tonë, ashtu si dhe zhvillimi i marrëdhënieve me BE-në ka mundësi të ecë në rrugëanaloge. Pra, Ballkani Perëndimor do të ketë këtë lloj marrëveshjesh të bazuara ligjërisht në akte të tilla ndërkombëtare që mbështeten në të drejtën ndërkombëtare. Në raste të veçanta, për çështje të caktuara, ato mund t'u referohen dhe "marrëveshjeve të Europës", duke respektuar procedurat e BE-së për shtetet e treta që duan të asociohen.

Perspektiva e futjes së pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor: Shqipërisë, Serbisë e Malit të Zi, Maqedonisë, Kroacisë dhe Bosnjës ka qenë e paqartë, gati enigmë, por në mbledhjen e Luksemburgut të Ministrave të Jashtëm më 16 qershor 2003 u ra dakord që këtyre vendeve BE-ja t'u japë disa ndihma dhe asistence teknike speciale dhe keto do të lëvrohen gjatë viteve 2004-2006, me qëllim që të përgatiten për anëtarësim në BE, duke parë dhe mundësinë e ndonjë ndihme tjetër nga Banka Europiane e Investimeve. Por, veç sa më sipër, duhet theksuar një fakt tjetër i rëndësishëm, dhe pikërisht mbledhjen e nivelit të lartë (samitin) të BE-së, mbajtur në Selanik të Greqisë më 23 qershor të këtij viti, e cila mori vendime të posaçme për Ballkanin Perëndimor. Konkretisht, së pari, ajo vendosi për herë të parë dhe e bëri publike dëshirën dhe gadishmërinë e anëtarëve të tij për të pranuar në gjirin e Komunitetit European pesë shtetet e lartpëmendura të Ballkanit. Së dyti, atje u vendos që këtyre vendeve t'u akordohet një ndihmë financiare prej 200 milion euro për periudhën e viteve 2004 e deri më 2007. Në samit u

deklarua, gjithashtu, se çështje e anëtarësimit të këtyre vendeve në BE është në vetë duart tyre dhe varet drejtpërsëdrejti nga vendosmëria e tyre për të vazhduar dhe thelluar reformat e ndryshme që ato kanë filluar. Këtej dalin dhe detyrat e rëndësishme që qëndrojnë përpara strukturave shtetërore të vendit tonë, të ngarkuara me çështjet e integritit europian, për të forcuar gjithë punën në këto drejtime, në kuadrin e negociatave të stabilizim-asociimit, siç u theksua dhe nga drejtuesit më të lartë të Shtetit shqiptar, menjëherë pas samitit të Selanikut.

Anëtarësimi në BE i dhjetë vendeve të kësaj zone bashkë me Maltën dhe Qipron, në bazë të vendimeve të mbledhjes së nivelit të lartë të BE-së më 14 nëntor të vitit 2002, është një prove tjetër e përpjekjeve të vazhdueshme për zgjerimin e tij dhe e shpejtimit të këtij procesi në përgjithësi.

Lidhur ngushtë me zhvillimet e mësipërme, për Shqipërinë në këtë kohë filloi të konkretizohet procesi i paraprimit të saj në BE, për çka dëshmon fakti që në nëntor 1999. Komisioni i tij përfundoi një raport të posaçëm lidhur me fizibilitetin e negociimit të një marrëveshjeje stabilizimi-asociimi dhe me Shqipërinë. Në këtë raport, përveç arritjeve pozitive të vërejtura në zhvillimin e brendshëm të vendit tonë, viheshin në dukje tri vështirësitë e mëdha që po kalonte procesi i reformave ligjore dhe institucionale, të cilat konsistonin në drejtimet e mëposhtme:

- Stabiliteti institucional, qeverisja dhe funksionimi i administratës dhe i shtetit të së drejtës;

- krijimi jo i lehtë i një zone të lirë të tregtisë me BE-në, për shkak të peshës relativisht të madhe që zënë në buxhet të ardhurat nga organet doganore;

- dobësia e përgjithshme e ekonomisë së vendit dhe varësia e saj e dukshme nga ndihmat e huaja⁶.

⁶ Shih: Commission Report, Bruksel, 1999, COM(99) f.15-18 dhe: Reader “E Drejta Europiane në sistemin e së Drejtës shqiptare”, Tiranë 2001, botim i Fondacionit GTZ në Shqipëri.

Me gjithë vështirësitë e mësipërme, përpjekjet për plotësimin e kushteve të kërkuara nga Komisioni janë intensifikuar nga Republika e Shqipërisë, duke vënë në zbatim masat e përcaktuara në Platformën e Strategjisë së Integritimit Euroatlantik, të miratuar nga Qeveria. Midis tyre, krahas kërkesave që lidhen me stabilitetin dhe problemet e tjera politike, një vend të rëndësishëm zë reforma në fushën e drejtësisë për ndryshimin dhe plotësimin e zbrazëtimeve në legjislacionin në fuqi sipas standardeve të reja europiane dhe në veçanti krijimi i institucioneve përkatëse, të domosdoshme për implementimin e këtij legjislacioni, çka përbën dhe pikën më të dobët në këtë fushë. Këto institucione dhe funksionimi i tyre i plotë përbën një nga kushtet bazë të kërkuara nga Komisioni European për fillimin e bisedimeve dhe nënshkrimin e marrëveshjes SAA.

Në këtë kuadër, u vlerësua si një hap i rëndësishëm krijimi në administratën shtetërore i disa strukturave të reja të specializuara e, në radhë të pare, i Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit Shqiptar me atë të BE-së (DPL), që aktualisht është në Ministrinë e Drejtësisë; dhe të rrjetit të bashkërenduesve në këtë fushë në çdo ministri të linjës. Njëkohësisht, hapa të tjera të rëndësishme janë bërë dhe në përcaktimin e formës relevante ligjore të të drejtave dhe kompetencave të tyre, si dhe të raporteve me strukturat përkatëse të Komisionit European etj.

Kjo Drejtori, duke u mbështetur në vendimet dhe udhëzimet e Këshillit Ndërmintor të Integritimit, e kryesuar nga Kryeministri dhe me përbërje si anëtarë të të gjithë ministrave dhe që, në zbatim të Programit të Qeverisë, përgjigjet dhe orienton të gjithë procesin e integritimit european, duke bashkëpunuar dhe duke u këshilluar me Komisionin e Ligjeve të Kuvendit dhe me ndihmën e specialistëve të tjerë të shoqërisë civile, si dhe me nismën e saj, drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e të gjitha të strukturave që merren me përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, për ta harmonizuar atë sa më mirë sipas fushave përkatëse.

Legjislacioni shqiptar, pas miratimit të Kushtetutës në tetor të vitit 1998, është zhvilluar më tej me synimin që t'iu përgjigjet sa më shumë standardeve

të BE-së, duke pasur parasysh dhe rekomandimet e Komisionit Europian, sidomos lidhur me reformën institucionale. Miratimi i tyre është në përputhje dhe me dispozitat dhe rregullat e përmendura më lart, të cilat përbëjnë bazueshmërinë ligjore të marrëveshjeve të asociimit të BE-së për shtetet e treta që synojnë anëtarësimin në të.

Në këtë kuadër, mund të përmenden një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore të miratuara vitet e fundit, siç janë ligjet “Për statusin e nëpunësit civil”, “Për Policinë e Shtetit”, “Për Ministrinë e Drejtësisë”, “Për Gjykatën e Lartë”, “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë”, “Për organizatat jofitimprurëse”, paketa ligjore lidhur me decentralizimin e pushtetit vendor, ligjet për shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal, në Kodin Civil, në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Punës, ratifikimi nga Republika e Shqipërisë i Kartës Europiane Sociale të Rishikuar, si dhe ratifikimi i një numri konventash ndërkombëtare etj.

Një punë e mirëfilltë, në kuadrin e masave për përgatitjen e kushteve për fillimin e bisedimeve për Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit, është ajo që bëhet nga strukturat përkatëse për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian në ato fusha të veçanta që janë konsideruar nga Komisioni Europian si përparësore për kushtet e shtetit tonë. Ato janë të lidhura ngushtë me reformat institucionale që janë ndërmarrë në vendin tonë, me kërkesat imperative të tregut të brendshëm dhe të përmirësimeve të domosdoshme në fushën sociale.

Konkretisht, në mbledhjen e nivelit të lartë të BE-së, mbajtur në Goteborg në qershor të vitit 2001, u bë vlerësimi i këtyre fushave. Në mbledhjen e grupit të përbashkët të punës të nivelit të lartë të BE-së, të mbajtur në muajin shtator të vitit 2001, u përcaktuan si fusha (nga ku duhet të fillohej puna për përafrimin me direktivat dhe rregulloret e BE-së): legjislacioni shqiptar lidhur me reformën e përgjithshme në administratën publike, për prokurimet publike, për konkurrencën, për pronësinë intelektuale, tregtare dhe industriale, për standardet dhe vlerësimet, për lëvizjen e lirë të kapitaleve, për mundësitë e

barabarta (të burrave me gratë) dhe sigurinë në punë, për taksat, si dhe për çështjet e tregtisë. Grupi i Punës Shqipëri-BE *vis a vi* për përafrimin e legjislacionit që në mbledhjen e tij të parë në nëntor të vitit 2001 ka marrë në shqyrtim rezultatet e arritura në shumicën e këtyre fushave dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për vazhdimin e punës në të ardhmen.

Grupe të veçanta të punës, që janë krijuar pranë Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit Shqiptar me atë të BE-së në Ministrinë e Drejtësisë, janë angazhuar në një proces të rëndësishëm për thellimin e punës për hartimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të nevojshme në legjislacionin shqiptar në këto fusha, duke i harmonizuar dhe përafruar ato me standardet europiane. I gjithë ky proces i rëndësishëm dhe me përgjegjësi është duke u kryer për thellimin e reformave përkatëse dhe ndryshimet e legjislacionit, duke iu përshtatur kushteve aktuale dhe mundësive të vendit tonë. Ky proces ka rëndësinë e vet në të gjitha përpjekjet që bën shteti ynë për forcimin dhe funksionimin e shtetit juridik dhe modernizimin e tij, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik, për plotësimin e standardeve të një tregu të brendshëm që t'i përgjigjet si duhet ekonomisë së tregut dhe normave e rregullave që zbatohen në kuadrin e një tregtie të lirë shtetet anëtare të BE-së.

Një vend të rëndësishëm në rrugën drejt plotësimit të kushteve ligjore për nënshkrimin e Marrëveshjes SAA me BE-në zënë marrëveshjet e tregtisë së lirë që tashmë Republika e Shqipërisë ka përfunduar me Maqedoninë, Kroacinë, Rumaninë dhe Serbinë e Malin e Zi, si dhe bisedimet që janë në zhvillim e sipër me Bullgarinë për këtë qëllim. Po kështu, strukturat shtetërore të përafrimit të legjislacionit, me pjesëmarrjen dhe të specialistëve të shoqërisë civile për problemet e asociimit në BE, janë duke ripunuar gjithë legjislacionin tonë tregtar në fuqi, duke pasur dhe angazhimin konkret dhe asistencën teknike të Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Ekonomik në Shqipëri (GTZ). Qëllimi është harmonizimi dhe përputhshëria i tij me direktivat dhe legjislacionin tjetër komunitar.

Bazueshmëria ligjore dhe përmbajtja e marrëveshjes SAA me vendin tonë shtron si detyrë të parë njohjen sa më me kompetencë të tyre nga institucionet përkatëse dhe shoqëria civile. Është me interes të njihet, gjithashtu, dhe struktura e institucioneve të shtetit shqiptar për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit me atë të BE-së, të cilat përbëjnë një nga parakushtet dhe çështjet kryesore të përfundimit të Marrëveshjes SAA.

Në këtë kuadër, duhet të theksohet funksioni drejtues i Këshillit Ndërmintor të Integritit. Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit (DPL) në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Integritit Euroatlantik në Ministrinë e Punëve të Jashtme përbëjnë organizmin teknik shtetëror, i ngarkuar me përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së është sa i gjatë, po aq i komplikuar, që kërkon pjesëmarrjen e shumë aktorëve. Ai implementohet nga DPL-ja, rrjeti i bashkërenduesve të përafrimit që është ngritur në të gjitha drejtoritë juridike të ministrive të linjës, Komisioni për Çështjet e Jashtme në Kuvend, si dhe nga ekspertë dhe përfaqësues të shkencës që merren me problemet e asociimit të Shqipërisë në BE.

Kuptohet lehtë që problemet juridike zënë një vend të veçantë në përgatitjen dhe zhvillimin e bisedimeve për nënshkrimin e Marrëveshjes SAA. DPL-ja, nëpërmjet strukturave të mësipërme, drejton dhe bashkërendon punën e tyre në fushat me karakter ligjor të Bashkimit Europian, të Traktateve të këtij organizmi dhe të institucioneve të tij, si dhe trajnimin e punonjësve të strukturave të përafrimit. Kjo Drejtori ndjek ndryshimet përkatëse të legjislacionit të BE-së në ato drejtime që lidhen me asociimin dhe kushtet ligjore të tij.

Një organizim i tillë i strukturave të përafrimit të legjislacionit në planin akademik dhe praktik përfshin asistencën teknike që DPL-ja jep në nismat e ndryshme që merren nga ministrinë për përafrimin e legjislacionit me atë europian, duke pasur njëkohësisht si një nga detyrat e saj parësore përpunimin e Strategjisë Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit të Shqipërisë me

Legjislacionin e BE-së. Në të gjitha etapat e këtij procesi bëhet gjithnjë e më e dukshme domosdoshmëria e njohjes dhe e futjes së legjislacionit evropian sa më shumë në legjislacionin tonë kombëtar, duke e harmonizuar atë dhe me përgatitjen e një administrate shtetërore dhe sistemi gjyqësor-prokuror modern të standardit evropian, si një nga kërkesat kryesore të asociimit të Republikës së Shqipërisë me BE.

Në rrugën drejt stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal – afrimi i Europës Juglindore me strukturat europiane

*Iva Zajmi
Juriste*

1. PAKTI I STABILITETIT PËR EUROPËN JUGLINDORE

Axhenda politike e Bashkimit Europian për Ballkanin gjatë më së shumtit të viteve '90 ishte shumë e varfër. Udhëheqësit europianë shihnin duarkryq rikthimin e politikave nacionaliste që nuk ngurronin të përdornin mjete ushtarake për të arritur qëllimet e tyre. Ajo që ndodhi aq pranë BE-së, duke filluar me Bosnjë-Hercegovinën dhe Kroacinë në gjysmën e parë, dhe pastaj veçanërisht në Kosovë në gjysmën e dytë të dekadës së fundit, e bënë BE-në rishtaz të ndërgjegjshëm për profilin e ulët të politikës së saj të jashtme. Ishte ndoshta ndërhyrja e forcave të NATO-s (e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara) që ndaloi kasaphanat kryesisht etnike të qindra dhe mijëra qytetarëve.

BE-ja ka nxjerrë dy mësimë prej këtej: së pari, se ekziston një nevojë e fuqishme për të ngritur një forcë (autonome) ushtarake dhe civile me detyrën për të reaguar shpejt ndaj krizave, kur vlerat europiane të jenë në rrezik dhe nuk mund të mbrohen më vetëm me anë të presionit diplomatik ose sanksioneve ekonomike. Së dyti, BE-ja e kuptoi se duhet të rriste shumë përpjekjet e veta politike për të stabilizuar të gjithë rajonin e Europës Juglindore, duke intensifikuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e vendeve të rajonit. Kjo metodë strategjike u hartua edhe për të mbështetur zbatimin e marrëveshjes së paqes të Dejtonit-Paris, për të sjellë një stabilitet themelor, demokraci dhe begati

ekonomike në rajon. Një strategji parandaluese, më shumë se kundërvepruese (p.sh. menaxhimi i krizave) nevojitet për t'i dhënë paqes një shans afatgjatë në Ballkan. BE-ja më në fund e kuptoi se (1) nëse nuk eksporton stabilitet, do të importojë instabilitet dhe (2) se parandalimi i krizave është edhe parandalim i kostove.

Objektivat e politikës së BE-së për Ballkanin mund të kuptohen lehtë: ta bëjë paqen në Europën Juglindore të pakthyeshme dhe të qëndrueshme, të ndërtojë shtete të fuqishme me administratë eficiente, të forcojë shtetin e së drejtës, të përmiresojë kushtet e rritjes ekonomike dhe të rrisë bashkëpunimin rajonal, i cili është bërë një nga shembujt më të shquar të një procesi të suksesshëm të integritimit europian. Nisma e parë e rëndësishme e BE-së për Europën Juglindore për të zbatuar këtë përvojë ishte Pakti i Stabilitetit. Ky Pakt, i miratuar në qershor 1999 në periudhën e presidencës Gjermane të BE-së dhe i inauguruar në Sarajevë në korrik 1999, është një deklaratë politike për angazhim dhe një marrëveshje kuadër për bashkëpunim ndërkombëtar. Ai bashkoi më shumë se 40 vende partnere, organizata ndërkombëtare dhe grupime rajonale, p.sh. shtete anëtare të BE-së dhe Komisionin Europian, vendet e rajonit dhe fqinjët e tyre, anëtarët e grupit G8 (p.sh. SHBA, Japonia, Rusia), organizata ndërkombëtare si OKB, OSBE, Këshilli i Europës, institucione ndërkombëtare financiare si Banka Botërore, FMN, BERZH, si edhe nisma rajonale. Të gjithë këta partnerë dëshironin të ndihmonin vendet e Europës Juglindore në përpjekjet e tyre për të forcuar paqen, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe begatinë ekonomike, për të arritur stabilitetin në të gjithë rajonin.

Pakti i Stabilitetit është, pra, përpjekja e parë e vërtetë e komunitetit ndërkombëtar për të zëvendësuar politikën e mëparshme të ndërhyrjes dhe të kundërveprimit ndaj krizave në Europën Juglindore, me një strategji të plotë e afatgjatë të parandalimit të konflikteve. Objektivi strategjik është integrimi më i plotë i mundshëm i vendeve të rajonit në rrjedhën politike dhe ekonomike të Europës. Kjo i përgjigjet shpresave të vendeve të rajonit "për

rrugën drejt Europës”: ata kanë nevojë për një partner të fortë strategjik (në kuadrin e përafritimit me strukturat e BE-së), politik (si një ndërmjetësues aktiv), financiar (në kuadrin e programeve të ndihmave të BE-së), ekonomik (si partner për tregtinë) dhe teknik (për të ndërtuar kapacitetet e duhura administrative).

Pakti i Stabilitetit ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin ndërmjet vendeve të Europës Juglindore, si dhe të bashkërendojë dhe të lehtësojë zbatimin e projekteve në rajon. Për të qenë të suksesshme, këto përpjekje duhet të kenë si objektiv krijimin e një mjedisi të sigurt, promovimin e sistemeve demokratike të qëndrueshme dhe promovimin e mirëqenies ekonomike dhe shoqërore. Struktura dhe metodat e punës së Paktit të Stabilitetit janë modeluar mbi bazën e Konferencës së suksesshme për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë të viteve 1970. Me përkrahjen e OSBE-së dhe me BE-në në rol udhëheqës, Pakti vepron nëpërmjet tre Tryezave Pune (dhe dy nëntryeza) të organizuara në kuadrin e një Tryeze Rajonale, e cila është udhëhequr nga Bashkërenduesi i Veçantë i Paktit të Stabilitetit (që nga janari 2002 është austriaku Erhard Busek, më parë ishte gjermani Bodo Hombach). Detyra e Bashkërenduesit të Veçantë është të vendosë strategjitë e pjesëmarrësve në Pakt në linjë me njëri-tjetrin, si dhe të bashkërendojë nismat ekzistuese dhe të reja në rajon pa krijuar përsëritje. Dy konferenca rajonale kanë grumbulluar fondin për projekte strategjike rajonale deri në 5,4 miliardë euro. Të gjitha projektet e Paktit të Stabilitetit administrohen nga partnerët zbatues, meqenëse nuk ka burime financiare të pavarura ose struktura zbatuese nga vetë Pakti. Ka vetëm një numër relativisht të vogël stafi të vendosur në Bruksel, afër mjediseve të Parlamentit European.

Tri Tryezat e Punës përqendrohen në çështjet e mëposhtme: demokratizimi dhe të drejtat e njeriut, rindërtimi ekonomik, bashkëpunimi dhe zhvillimi dhe çështjet e sigurisë (siguria dhe mbrojtja, punët e brendshme dhe të drejtësisë). Për të dhënë disa shembuj konkretë: në Tryezën e Punës nr.1, çështje si dialogu ndëretnik, kthimi i refugjatëve, liria e shtypit, barazia ndërmjet sekseve,

dhe arsimi e rinia janë në qendër. Tryeza e punës nr.2 përqendrohet në çështje si projekte të infrastrukturës rajonale, liberalizimi i tregtisë dhe mbështetja (zhvillimi i sektorit privat), reduktimi i varfërisë dhe zhvillimi shoqëror, institucional dhe qeverisja, si dhe mbrojtja e mjedisit. Së fundi, nëntryeza e parë e Tryezës së Punës nr.3 merret me reduktimin e armëve dhe kontrollin, me shkëmbimin e informacionit ushtarak, me njoftimin dhe vëzhgimin (masa për ndërtimin e besimit), me veprimin për heqjen e minave, me zvogëlimin e sektorit ushtarak dhe mbajtjen e personelit të çmobilizuar. Nëntryeza 2 merret me çështje si lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, azili dhe çështje të migrimit. Dhe trajnimi i policisë së kufirit janë në qendër të vëmendjes.

Në tri faza (përgatitje, konceptim, zbatim) u iniciovan nga Pakti i Stabilitetit 244 projekte pilote në pranverë 2000 në të ashtuquajturën “Paketë e Fillimit të Shpejtë”, veçanërisht në fushën e infrastrukturës. Ka pasur, gjithashtu, edhe projekte të rëndësishme rajonale: p.sh. përpjekje të përbashkëta të Kroacisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe ish-Republikës Federale të Jugosllavisë, për të zgjidhur problemin e madh të refugjatëve së bashku me komunitetin ndërkombëtar, ose ambicje për të ngritur, sa më shpejt të jetë e mundur, një rrjet marrëveshesh të tregtisë së lirë ndërmjet shteteve të rajonit.

Përparësitë e Paktit të Stabilitetit për vitin 2002 mund të përmbidhen në titullin: “më pak mbledhje, më shumë veprim“ (E. Busek). Në fokusin e veprimtarive të Paktit të Stabilitetit duhet të jetë krijimi i rrjeteve të 21 marrëveshjeve të dyanshme të tregtisë së lirë, ngritja e një tregu rajonal të energjisë elektrike, niveli më i lartë i kthimit dhe ndihma për integrimin e refugjatëve, si edhe hartimi i nismave për të luftuar krimin e organizuar. Për më tepër, plotësimi i ndërsjellë ndërmjet Paktit të Stabilitetit nga njëra anë dhe procesit të stabilizim-asociimit dhe procesit të anëtarësimit nga ana tjetër, duhet të rritet dhe “pronësia“ e Paktit parashikohet t’i transferohet gradualisht vendeve të rajonit të cilëve u drejtohet.

Është e vështirë të vlerësosh që tani rezultatin e Paktit të Stabilitetit. Pas vitit të parë të ekzistencës ka pasur kritika se Pakti nuk ka funksionuar me frytshmërinë e duhur, se ka një mungesë bashkërendimi ndërmjet donatorëve dhe se vetëm pak projekte kanë nisur në rajon. Megjithatë, programet më të “shpejta” (rreth 80%) u nisën në fakt në vitin 2001, edhe pse disa herë me vonesë për shkak të procedurave të prokurimit publik dhe pengesave të tjera teknike. Një problem i përgjithshëm karakteristik për Paktin shkaktohet nga pozicioni i vështirë i Bashkërenduesit të Veçantë dhe mungesa e autoritetit të tij në kuptimin e kompetencës politike dhe buxhetore, si dhe nga burokracia shpesh e ngadaltë e Brukselit e cila është një pengesë më shumë për një zbatim të shpejtë dhe të frytshëm të projekteve.

Ata që kanë pritur që Pakti të tregojë rezultate shumë të mëdha si politike dhe ekonomike, vetëm brenda pak viteve që nga inaugurimi i tij, do të zhgënjehen. Është e qartë se një objektiv i tillë ambicioz, ose më mirë vizion, ka nevojë për kohë, përpjekje të vazhdueshme dhe një ndryshim mendësie të shumë vendimmarrësve të rajonit.

Përvoja europiane na mëson se bashkëpunimi rajonal forcon stabilitetin politik, rritjen ekonomike dhe sigurinë. Bashkëpunimi rajonal që do të shtrojë rrugën për integrimin europian dhe integrimin euro-atlantik, është një përparësi politike për të gjitha shtetet e rajonit. Besimi i ndërsjellë dhe mirëkuptimi janë parakushtet e bashkëpunimit. Mosbesimi fatal i krijuar nga politikat nacionaliste dhe etnike ka nevojë për kohë për t’u kapërcyer. Parimi kryesor i Paktit, me së shumti parandalimi i konflikteve me anë të ndryshimit të strukturave dhe mendësive, që janë burime të konflikteve të mundshme, është ruajtur i paprekur. Një sukses në këtë drejtim do t’i kontribuonte shumë një zhvillimi pozitiv dhe thelbësor të rajonit dhe Europës si të tërë.

II. PROCESI I STABILIZIM-ASOCIIMIT ME BE

Komisioni i BE-së propozoi, në 26 maj 1999, krijimin e procesit të stabilizim-asociimit. Ky proces ndërtohet mbi afrimin rajonal të Europës Juglindore

nga viti 1997 dhe krijon një vizion më ambicioz për zhvillimin e rajonit. Që atëherë, “perspektiva europiane” është bërë elementi kyç në strategjinë politike të BE-së ndaj Europës Juglindore. Duke besuar se – ashtu si në Europën Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore – kapërcimi i luftës dhe i politikave nacionaliste është i mundshëm vetëm nëpërmjet bashkëpunimit dhe integritit gradual të ekonomive, BE-ja hartoi procesin e stabilizim-asociimit jo vetëm si një mjet për të mbështetur dyanshmërisht përpjekjet e vendeve për të rindërtuar ekonomitë e tyre dhe për të reformuar sistemet e tyre politike, por edhe për të treguar vullnetin e vet për t’i pranuar në parim këto vende në perspektivë si anëtare të Bashkimit. Perspektiva e “anëtarësisë së mundshme në BE” mendohet se do të veprojë si katalizator për të shpejtuar reformat në vendet dhe shoqëritë përkatëse dhe shkon përtej rrugës së mëparshme të marrëdhënieve kontraktore (marrëveshjeve të tregtisë dhe bashkëpunimit) që BE-ja u ka ofruar vendeve përkatëse.

Me Paktin e Stabilizim-Asociimit, BE-ja ka përcaktuar kuadrin për bashkëpunim të intensifikuar të dyanshëm politik, ekonomik, financiar dhe teknik, i cili duhet të ndihmojë vendet e Europës Juglindore të kapërcejnë prapambetjen përballë standardeve të BE-së. Ai u jep shtysa të mëdha vendeve të cilave iu drejtohet, por, gjithashtu, përcakton kushte politike dhe ekonomike që duhen përmbushur. Për të zhvilluar një marrëdhënie më të ngushtë me BE-në, kandidatëve në procesin e stabilizim-asociimit do t’u duhet të përshtasin zhvillimin e tyre politik, ekonomik dhe institucional ndaj vlerave dhe modeleve themelore të BE-së dhe të forcojnë bashkëpunimin rajonal. BE-ja, nga ana tjetër, do të mbështesë këto vende në përpjekjet e tyre për reformë.

Si një instrument të ri kontraktor, BE-ja krijoi të ashtuquajturën Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit me pesë shtetet e procesit të stabilizim-asociimit (Shqipëria, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Ish-Republika Federale e Jugosllavisë, Maqedonia). Marrëveshjet e stabilizim-asociimit janë në disa drejtime të ngjashme me marrëveshjet e asociimit (marrëveshjet

europiane) me vendet tranzitore të Europës Qendrore dhe Lindore dhe kanë për qëllim të përgatisin të pesë vendet e Ballkanit Perëndimor për plotësimin e kërkesave për candidate të anëtarësisë europiane në të ardhmen. Marrëveshjet për stabilizim-asociimin parashikojnë për çdo vend (në mënyrë të posaçme) metodën progresive që duhet të mbajë parasysh situatën individuale të çdo vendi. Detyrimet kontraktore që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit duhen respektuar dhe zbatuar siç duhet.

Procesi i stabilizim-asociimit u nis në qershor 1999. Samiti i Zagrebit në nëntor 2000 shënoi një hap të parë duke arritur marrëveshjet rajonale për objektivat dhe kushtet e procesit të stabilizim-asociimit. U pranua se demokracia dhe pajtimi, si dhe bashkëpunimi rajonal nga njëra anë dhe afrimi i secilit prej këtyre vendeve me BE-në nga ana tjetër, formojnë një të vetme. Me rastin e samitit, BE-ja inicioi Marrëveshjen e parë të Stabilizim-Asociimit me Maqedoninë si vend pioner. Kjo Marrëveshje, e nënshkruar më pas në Luksemburg në prill 2001, u ndoq nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Kroacinë (nga 29 tetori 2001). BE-ja ishte e vendosur t'i japte Komisionit European një mandat për të filluar negociatat me Shqipërinë shumë shpejt (mundësisht nga fundi i 2002), duke ndjekur kështu rekomandimet e Grupit të Nivelit të Lartë Drejtues të verës 2001.

Marrëveshjet e stabilizim-asociimit që janë nënshkruar deri tani shërbejnë si një shembull për tipin e dispozitave që çdo kandidat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit duhet të plotësojë. Elementet kryesore të një marrëveshjeje të Stabilizim-asociimit janë këto: Dialogu politik intensiv, liberalizimi asimetrik i tregtisë – në favor të vendit përkatës – me perspektivën e krijimit gradual të një zone të tregtisë së lirë me BE-në pas një periudhe tranzitore, bashkëpunimi rajonal (me marrëveshje të detyrueshme rajonale ndërmjet vendeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit), harmonizimi me legjisllacionin e BE-së, veçanërisht në fusha thelbësore të tregut të brendshëm, bashkëpunimi në fushën e Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme. Këto fusha do të mbikëqyren rregullisht nga një mekanizëm vëzhgues (Raportet e

procesit të stabilizim-asociimit të Komisionit). Më tej, ndihma e BE-së i drejtohet zhvillimit të shoqërisë civile, ndihmës ekonomike dhe financiare (buxhetore), si dhe ndihmës humanitare për refugjatët dhe të kthyerit.

Në rastet e Maqedonisë dhe Kroacisë, të ashtuquajturat *marrëveshje interim* për tregtinë dhe çështje të lidhura me tregtinë, hynë në fuqi përpara ratifikimit të marrëveshjeve të Stabilizim-asociimit me vendet anëtare të BE-së. Përfundimi i marrëveshjeve rajonale të tregtisë së lirë është një kusht i detyrueshëm për të gjithë vendet e procesit të asociim-stabilizimit. Marrëveshjet e asociim-stabilizimit nuk kërkojnë nga kandidati të miratojë menjëherë të gjithë *acquis communautaire* (legjislacionit) të BE-së. Fokusi vendoset më tepër mbi parime kyçe demokratike dhe elemente kyçe të *së drejtës* së tregut të brendshëm. Për fusha ku marrëveshjet e stabilizim-asociimit nuk vendosin detyrime të veçanta lidhur me të *drejtën/legjislacionin*, ka dispozita të hollësishme për bashkëpunimin me BE-në. Komisioni i BE-së ka një levë për të ndikuar vendosjen e përparësive në procesin e reformave të çdo vendi drejt standardeve të BE-së, dhe për të mbikëqyrur hapat progresivë në procesin e zbatimit; kjo bëhet zakonisht nga Këshilli i Asociimit me vendet që tashmë e kanë nënshkruar një marrëveshje stabilizim-asociimit. Zbatimi efektiv i një marrëveshjeje së asociim-stabilizimit është një parakusht për vlerësimin e mëtejshëm nga ana e BE-së të perspektivës së çdo vendi për hyrje. Në kuadrin e një “mekanizmi shqyrtimi” të rregullt, një lloj procedure standarde në procesin e, asociim-stabilizimit BE-ja vlerëson realizimin nga çdo vend dhe plotësimin e kriterëve dhe të dispozitave të përcaktuara në marrëveshjen/procesin e stabilizim-asociimit.

Një instrument anësor për të mbështetur financiarisht procesin e stabilizim-asociimit është „Ndhimja e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim” e krijuar rishtaz (CARDS). CARDS zëvendësoi gradualisht programet e vjetra PHARE/OBNOVA të BE-së në rajon dhe krijoi një kuadër të vetëm ligjor me një kuadër të vetëm procedurash uniforme për të gjithë rajonin. CARDS do të japë një shumë prej rreth 4,65 miliardë Euro ndërmjet vitit

2000 dhe 2006 për të pesë vendet e caktuara. Qëllimi kryesor i ndihmës së Komunitetit është të mbështesë pjesëmarrjen e vendeve përfituese në procesin e asociim-stabilizimit.

Proces i stabilizim-asociimit ka treguar arritje, por ka nxjerrë edhe probleme në Europën Juglindore. Në anën pozitive mund të përmendet se vendet e rajonit janë përfshirë në programe reformash ambicioze politike dhe ekonomike bazuar në të drejtën dhe praktikën e BE-së. Shtete, të zgjedhura në rrugë demokratike, ekzistojnë në të gjithë rajonin – sidoqoftë një funksionim i mirë i institucioneve të shtetit nuk është arritur ende në të gjithë vendet. Përveç rritjes ekonomike dhe tregtisë së shtuar ndërmjet vendeve të rajonit dhe BE-së, nuk ka ende ekonomi tregu funksionuese në Europën Juglindore. Procesi gradual i harmonizimit me legjislacionin e Komunitetit European është shoqëruar me zbatim të dobët të ligjit. Reforma të vazhdueshme administrative nga njëra anë dobësohen nga aftësi të vogla administrative dhe korrupsioni nga ana tjetër.

Shpërthimi i krizës në Maqedoni në vitin 2001 ka treguar sesa e brishtë është ende baza aktuale e paqes dhe e stabilitetit në rajon. Situata e ngjashme me atë të luftës civile në Maqedoni ishte jo vetëm një çast tragjik për vetë vendin, por edhe një smbrapsje e fortë e angazhimit politik të BE-së në rajon, meqenëse ndodhi tamam në kohën kur u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Maqedonisë. Vetëm pas anagazhimit shumë aktiv dhe ndërmjetësimit midis dy palëve kryesore në konflikt u bë e mundur të çohet drejt fundit konflikti i hapur. Megjithatë vetëvlerësimi i BE-së për rezultatet e saj në Maqedoni shihet shpesh krejt ndryshe nga njerëzit e atij vendi, nuk mund të mohohet se vendosmëria politike dhe ndërmjetësimi i suksesshëm i BE-së ka pasur një ndikim thelbësor në ndërtimin e një bazë të re (Marrëveshja Kuadër e Ohrit dhe ndryshimet vijuese kushtetuese) për një të ardhme paqësore në vend. Një konferencë donatorësh për Maqedoninë në mars 2002 formoi një tjetër paketë thelbësore ndihmesh për të mbështetur këtë qëllim.

Kështu që rezultatet e Paktit të Stabilitetit dhe të procesit të stabilizim-asociimit janë të ndërthurura. Projektet në Paktin e Stabilitetit dhe perspektivat europiane të parashikuara në procesin e stabilizim-asociimit kanë bërë të mundur që të gjitha shtetet e Europës Juglindore të kuptojnë se bashkëpunimi rajonal duhet të jetë një element kyç i “strategjisë së tyre të europeanizimit“. Procesi i stabilizim-asociimit si ndihmesë kryesore e BE-së për Paktin e Stabilitetit është një projekt afatgjatë i cili përqendrohet në ndryshimin e strukturave dhe të politikave. Disa vende në procesin e stabilizim-asociimit do të kenë vështirësi për të arritur rezultatet e të tjerëve për shkak të kushtëzimit tipik të procesit të asociim-stabilizimit. Për të lehtësuar një proces të mundshëm me dy faza, Pakti i Stabilitetit mund të kryejë funksionin e ngritjes së një ure.

Globalizimi dhe jeta politike

Guy CARRON DE LA CARRIÈRE¹

Përktheu: Diana Estrefi

Globalizimi është sot temë e ditës, ai është bërë mënyra pothuajse universale e shpjegimit, siç ishte dikur lufta e ftohtë. Të gjithë flasin për të. Në përgjithësi, për të parashikuar se ç' do të duhej të bënin përgjegjësit politikë me të dhe rrallëherë për të ditur se çfarë bën globalizimi me ata.

Megjithatë, politikanët brenda botës së tyre, i njohin të gjitha aspektet e globalizimit: mjeti i tyre i punës, shteti, gjendet i kërcënuar; shfaqja e prodhimeve të reja politike po i vë ata në diskutim; sot atyre u duhet t' i bëjnë ballë ndryshimeve të kërkesës, pasi institucionet e ngritura e përballojnë konkurrencën me aktorë të rinj (OJQ, mediat, tregjet...), e pikërisht sepse ata po vërejnë gërryerje në pjesën e tyre të tregut të qeverisjes botërore, u duhet të mendojnë për përhapjen e qendrave të veprimtarisë, si dhe për ristrukturime praktikisht të vështira.

Qëllimi i këtij artikulli është, pra, të zbulojë dhe analizojë *ndryshimet* që globalizimi, ashtu si edhe revolucioni teknik globalist që e shoqëron, sjellin në jetën politike, në veprimtarinë e përgjegjësve politikë dhe institucioneve të tyre (shtet, qeveri dhe parti), me shpresën se do të japin ndihmesë, duke parashikuar rreziqet ose oportunitetet e përgatitjes së mekanizmave tanë të vjetër politikë për përballimin e atyre ndryshimeve të mrekullueshme, të cilat po mbërrinjnë me një shpejtësi marramendëse.

Kryesisht ato shfaqen në dy aspekte: nga njëra anë, riklasifikimi i aktorëve dhe i problemeve që vënë në lëvizje jetën politike dhe, nga ana tjetër,

¹ Anëtar i Komitetit të Redaksisë së “Revue politique et parlementaire”.

zhvendosja e ushtrimit të autoritetit publik. Pikërisht rreth këtyre dy zhvillimeve të mëdha organizohen ndarjet e pushteteve, formulohen sfida të reja, diskutohen mënyrat e funksionimit të shteteve, me një fjalë, qeveritë mund t'i rijapin kuptim autoritetit dhe të gjejnë levat e reja të pushtetit të tyre.

* * *

Me këto ndryshime disa fitojnë, të tjerë humbin, shfaqen përparësi të reja, ndërsa emergjencat e dikurshme zhduken; të gjitha këto lëvizje nënkuptojnë rishpërndarje të letrave në lojën politike. Ia dalin mbanë protagonistët, si në nivel ndërkombëtar, që janë shtetet të cilat pranojnë ndërvarësi të reja, ashtu edhe në nivel kombëtar, që janë formacionet politike të ndara sipas globalizimit.

NDRYSHON HARTA BOTËRORE E PUSHTETIT POLITIK

Çdo gjë e re sjell me vete si mundësitë që duhen përkrahur, ashtu edhe rreziqet të cilave duhet t'u shmangesh. Sot në botë po vepron një ndarje e re mes atyre që dinë të përfitojnë prej saj, ku radhiten të parët Shtetet e Bashkuara, dhe atyre që nuk përfitojnë, ku përfshihet pjesa më e madhe e vendeve pak të zhvilluara. Për të tjerët situata është me kontraste: ajo nuk i përgjigjet saktësisht ndarjeve tradicionale mes vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, Veriut dhe Jugut, Lindjes dhe Perëndimit. Kjo situatë e re operon, *nga njëra anë*, mes ekonomive, të cilat me ndryshueshmërinë, shpikjet dhe vendosmërinë e tyre janë të afta t'i shërbejnë tregut botëror, me qëllim që të tërheqin kapitale të lira, t'i përvetësojnë pak nga pak shpikjet e reja dhe, *nga ana tjetër*, mes të tjerëve.

Efekti më spektakolar i saj është thellimi gjithnjë e më shumë i hapësirës mes atyre që ia dalin mbanë dhe atyre që nuk arrijnë dot të vazhdojnë, ose mes pushtetit të të dy palëve në politikën ndërkombëtare.

Njëkohësisht, por në sens të kundërt, globalizimi ka bërë që në koncertin ndërkombëtar të hyjnë edhe ato vende të cilat prej pesëdhjetë vjetësh jo vetëm që nuk merrnin pjesë, por as që nuk mund të dëgjoheshin. Të gjitha shtetet, ose pothuajse të gjitha, janë sot anëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore ose shpresojnë të bëhen anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë (deri tani janë 142). Sigurisht që fuqitë e mëdha, si kudo edhe në këto qarqe, luajnë me të gjitha mjetet e tyre të ndikimit, të nënshtrimit ose presionit, megjithatë edhe më të vegjëlit, nëpërmjet rregullit të përgjithshëm të unanimitetit, kanë një fuqi bllokuese, e cila i lejon ata t'u dëgjohet zëri. Roli gjithnjë në rritje i vendeve në zhvillim brenda OBT-së është një shembull mjaft i qartë: pakënaqësia e tyre u bë shkak kryesor për dështimin e Konferencës Ministrore në Seattle në vitin 1999; në Doha, në vitin 2001, dispozitat e marrëveshjes mbi pronësinë intelektuale u ripanë vetëm për shkak të presionit që bënë këto vende dhe u vendos të rifillohej një cikël i ri negociatash vetëm pasi u futën në tekstin e marrëveshjes shumë elemente të rëndësishme për pozitat e tyre (parashikimi i bujqësisë, përmirësimi i futjes së tyre në tregjet e zhvilluara, shtyrja e afateve për çështje të vështira për t'u plotësuar prej tyre, si mjedisi, normat sociale, investimet ndërkombëtare dhe konkurrenca).

Po kështu, të njëjtën nevojë kanë më të mëdhenjtë për të siguruar mbështetjen e më pak të mëdhenjve, dhe kjo duket në shumë fusha, siç janë p.sh. dosjet e gazit me efekt serre, shtypja e terrorizmit ndërkombëtar ose lufta kundër parave të pista, pasi, sipas evidencave, braktisja prej disa mikroshteteve mund të hedhë poshtë një dispozitë të tërë. Ata vënë në dukje, gjithashtu, se politikat e njëanshme (që konsistojnë në marrjen e vendimeve vetëm) ose izoluese, po bëhen të vështira për t'u ndjekur për një kohë të gjatë, madje edhe kur bëhet fjalë për fuqi të mëdha, siç janë Shtetet e Bashkuara. George W. Bush erdhi në pushtet duke treguar dëshirën e madhe për mosdërhyrje të vendit të tij në çështje periferike, në të cilat interesi kombëtar nuk është në lojë. Por kjo vendosmëri zgjati deri në ngjarjet e

atentateve terroriste të 11 shtatorit 2001. Ai e kuptoi shpejt, se për të pasur një siguri të brendshme në vendin e vet, do t'i duhej jo vetëm të lante hesapet me talebanët, por të futej thellë në botën arabe e myslimane, për të ulur konfliktin palestinez, t'i bënte thirrje OKB-së për të stabilizuar Afganistanin, të kujdesej mos të alarmonte Indinë e, më në fund, të rishikonte marrëdhëniet me Moskën. Era e “neglizhencës relative” nuk do të zgjaste as edhe një vit.

Ky zhvillim është mjaft domethënës për të gjithë ata që kishin menduar se organizimi i botës shfaq një mungesë simetrie të atillë, ku Shtetet e Bashkuara, të vendosura në majë të sistemit, mund të përfitojnë, duke i lejuar vetes të drejtën e vendimeve njëpalëshe, të heqjes dorë nga disa përgjegjësi ose të mosbërjes lëshime me pushtetin e tyre. Mirëpo, në të kundërt, realiteti i kohëve të fundit po tregon se me gjithë epërsinë e madhe të mjeteve të tyre materiale, ato nuk mund të mos marrin parasysh pjesën tjetër të botës. Në universin e globalizuar, në fakt, nuk ka një mbivendosje të saktë të fuqisë mbi hartën e ekonomive, ajo shprehet vetëm në nivelin e PNB-së² ose të sasisë së raketave luftarake, ndërsa globalizimi nuk është vetëm i tregjeve, ai vë në lëvizje idetë, kulturat e opinionet publike. Shtetet e Bashkuara nuk kanë nevojë për asnjë shtet tjetër për të shkatërruar regjimin e talebanëve. Sigurisht që atyre u është dashur të kenë disa pika mbështetjeje në vendet fqinje dhe Aleanca e Veriut i ndihmoi, por kapaciteti i tyre veprues ishte absolutisht imponues. Megjithatë, më vonë, ato nuk do të mund të konsolidojnë suksesin e tyre ushtarak pa një fitore politike, domethënë të arrijnë të bindin jo vetem qeveritë, por edhe popujt për drejtësinë e kauzës së tyre dhe t'ia dalin mbanë të kapërcejnë antiamerikanizmin e përhapur gjerësisht në vendet ku dyshohet se strehohen aktivistë terroristë. Hegjemonia është një zotërim legjitim dhe i pranuar, jo një autoritet i imponuar nga forca. Duke

² Prodhimi kombëtar bruto.

negociuar ajo mund të pranohet nga të tjerët. Dihet tashmë se edhe vetë “hiperfuqia” mund të çenohet dhe se në një botë të globalizuar asnjëri nuk është i mbrojtur nga goditjet e jashtme.

Kështu, me shtimin e aktorëve, riklasifikimin e vendeve sipas fuqisë dhe përgjithësimin e ndërvarësive, globalizimi ka shënuar skenën politike ndërkombëtare. Në nivel kombëtar ai ka çuar, gjithashtu, në një rishpërndarje të forcave politike, por për të tjera arsye, pasi pyetjet dhe reagimet e nxitura prej globalizimit nuk korrespondojnë me vijat ndarëse klasike, gjë që shkaktoi ndarje të reja.

LËVIZJA E GURËVE NË FUSHËN E FORCAVE POLITIKE KOMBËTARE

Globalizimi, gjithashtu, pasuron disa individë, ndërsa varfëron të tjerë, dhe shoqëria regjistron ndryshime, të cilat pasqyrohen në rindarjen e forcave politike. Ai është krejtësisht i favorshëm për punëtorët e kualifikuar, për ata që kanë nivel profesional të vërtetuar, për zotëruesit e kapitaleve, për gjithë ata që me formimin, zanatin e të ardhurat e tyre janë të përgatitur për ndryshim e lëvizje. Mirëpo ai është i egër dhe shpeshherë mizor për punëtorët e pakualifikuar, për ata që punojnë në çfarëdolloj niveli, me teknologji të stabilizuara ose me sipërmarrës të vegjël, të cilët nuk dinë e nuk mund të risistemohen. Këto çrregullime që pëson pak a shumë sistemi hierarkik i të ardhurave dhe mënyra e jetesës, nuk gjejnë vend lehtë në vizionin që kanë zakonisht partitë dhe sindikatat për botën. Duke qenë trashëgimtarë të sistemeve të ngritura prej kohësh, ata ecin me shumë kujdes në rrugën e gjetjes së përgjigjeve të mira e, mbi të gjitha, të formulimit të propozimeve për të ardhmen. Nuk ka më përshtatje mes fjalimeve të partive, praktikës dhe kulturës së tyre politike. Kjo, sepse fjalimet e formacioneve të mëdha, që tradicionalisht përbëjnë gamën politike, nuk duken të mjaftueshme, përderisa shfaqen lëvizje të organizuara pak a shumë mirë, ndonëse jetëshkurtra, por që ia dalin të imponohen jashtë këtyre formacioneve

tradicionale: përfaqësitë përballë sindikatave, Jose Bove me Konfederatën e tij Fshatare përballë së fuqishmes FNSEA³, pakicat kundërshtuese përballë shumicave dhe opozitave parlamentare, grupet joformale aktive, të përziera, që mbajnë lidhje me gjithë planetin nëpërmjet internetit dhe vrapojnë pas çdo ngjarjeje simbolike që lidhet me globalizimin, si mbledhje të FMN-së, OBT-së, G-7-ës e KE-së për t'u gjendur përballë pushtetit zyrtar të qeverive.

Në Francë, globalizimi është burimi i ndarjeve brenda familjeve politike, dikur të radhitura mirë nga e majta në të djathtë në fushën e lojës së ideologjive.

Në gjirin e së njëjtës parti ose koalicioni qeveritar mund të gjesh në Francë, por edhe në Britaninë e Madhe, Gjermani e Itali, ashtu si edhe mes socializmave e të djathtave europiane, një shumëllojshmëri opinionesh lidhur me globalizimin, duke filluar me armiqësitë e hapura ndaj optimistëve dhe duke vazhduar me pranimet e nënshtruara me nuanca mosbesimi dhe tepër të kujdesshme. Është tepër kureshtar fakti që e majta ekstreme bashkohet me ultra të djathtë, kur është fjala për mospranim, ndërsa qendrat nuk janë shumë larg pragmatizmit të tyre të kujdesshëm. Këto rishpërndarje të pozicionimeve ideologjike kapërcejnë strukturat e ndërtuara, ashtu si edhe ndarjet tradicionale për të krijuar të reja, për të cilat nuk dihet nëse janë ose jo esenciale dhe prishin komunikimin mes partive. Këto të fundit bëhen të paqarta lidhur me pozicionet që duhet të marrin për t'i kënaqur të gjithë dhe kjo i bën të japin mesazhe të turbullta e interpretime sipërfaqësore të fakteve (për shembull, mbi hapjen efektive të tregjeve, ristrukturimin e ndërmarrjeve ose përjashtimet kulturore), në një kohë që atyre u duhet të shpjegojnë, edukojnë dhe propozojnë ide të qarta.

Me një fjalë, globalizimi është një shenjë kontradiktash, faktor ndarjeje, prandaj, edhe nëse flitet shumë për të në mjediset politike, analiza mbetet shpesh në sipërfaqe të gjërave. Dhe është për të ardhur keq që një dukuri e re jep ndihmesë në çoroditjen e opinioneve: mbarë bota është e ftuar të marrë pjesë në politikat kombëtare.

³ Federata kombëtare e sindikatave të punonjësve të bujqësisë së Francës.

BOTA E JASHTME BËHET PJESËMARRËSE NË JETËN POLITIKE KOMBËTARE

Gjithmonë politikave të jashtme u është dashur të mbajnë parasysh atë çfarë bëjnë vendet e huaja: kjo sot është më thelbësore se kurrë, pasi mjedisi i jashtëm është bërë më i shpeshtë dhe më i domosdoshëm. Të negociosh gjithmonë dhe me të gjithë, diplomacia t'u kthehet marrëdhënieve shumëpalëshe, ky është ndryshimi i madh që sjell globalizimi. Kjo s' do të thotë që marrëdhëniet dypalëshe të zhduken, por ato do të shërbejnë edhe më tepër për të përgatitur atë që do të ndodhë në rrethet shumëpalëshe ose do të ndjekin gjithçka që del prej tyre. Pra, autoriteteve të çdo vendi u bëhet thirrje që ta shohin mirë politikën e tyre të jashtme. Në qoftë se, për shembull, Franca u jep organizatave ndërkombëtare një vend të rëndësishëm në veprimtaritë e saj të jashtme, kjo ndodh jo vetëm se ato zënë një vend praktik për t'u dëgjuar, por edhe sepse ato janë burime legjitime dhe të garantuara për të organizuar negociata me shumë palë pjesëmarrëse.

E reja kryesore është vendi që tashmë zë bota e jashtme në politikat e brendshme. Ajo luan rolin e saj si në proceset e marrjes së vendimeve, ashtu edhe në problemet e sfidat që duhet të përballojnë përgjegjësit politikë.

Procesi i marrjes së vendimeve nuk mund të bëjë më pa referencat e jashtme, pasi globalizimi po e lejon gjithnjë e më pak një gjë të tillë. Është e vërtetë se sa herë që një rregull i jashtëm imponohet, ai del nga negociata dypalëshe, marrëveshje shumëpalëshe ose nga një organizatë ndërkombëtare. Këto rregulla nuk janë të panjohura, sepse vetë qeveritë kanë dhënë pëlqimin e tyre, mirëpo ato vijnë nga jashtë dhe mbi të gjitha po zënë një përqindje në rritje të vendimeve të brendshme, pasi në botën tonë të globalizuar, ku çdo gjë qarkullon, ku punohet me të gjithë, ku informacionet, mesazhet dhe udhëzimet vijnë pa kufi, solidaritetet dhe lidhjet janë të shumta. Përveç kësaj, për të qenë më të frytshme, edhe masat që merr vetë politika e brendshme, dhe që janë kompetencë tërësore e saj, duhet të kenë parasysh çfarë ndodh në botën e jashtme. Tashmë e dinë të gjithë se siguria e brendshme trajtohet

teper nga ndërkombëtarët, pasi kërcënimi është transnacional. Terrorizmi i Al Quaida-s është modeli i një organizimi të globalizuar: pa dallime territoriale, transnacional, shumëpolësh, bazuar në idealizëm, me një personel të kualifikuar, me një fjalë, tmerrësisht global. Pikërisht zbutja e kufijve, qarkullimi rrjedhshëm i parave, mënyrat e shumta për të mbuluar transaksionet financiare, gërshetimi i pazgjdhshëm i rrjeteve të tyre, e bëjnë të domosdoshëm bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në shkallë ndërkombëtare. Në një tjetër plan, lufta kundër ndotjes nuk mund të jetë e frytshme nëse ajo nuk ndërmerret nga të gjithë. Edhe në ato raste kur një qeveri mund të vendosë e vetme, pa qenë e nevojshme t'i përmbahet detyrimeve ndërkombëtare, ajo do të ketë parasysh përvojat e huaja. Në botën e globalizuar parimi i një qeverisjeje të mirë është më i qartë, edhe atëherë kur kemi të bëjmë me të njëjtat probleme. Kujdes i madh duhet treguar me përqëndrimet e ardhshme ndërkombëtare: nuk duhet të vendosen sisteme të papajtueshme. Kjo, në fund të fundit, është e nevojshme sa herë që një politikë kombëtare nuk mund të shkëputet nga konteksti ndërkombëtar. Franca ka një përvojë të hidhur në këtë drejtim, kur në vitet 1981-82 ajo donte të futej e vetme në politikën e bum-it ekonomik, duke shkuar në drejtim të kundërt me atë që po bënin vendet fqinje europiane.

Nuk është e habitshme që në një regjim me kufij të hapur, politika e brendshme të jetë e përshtatshme me mjedisin ndërkombëtar, por është tepër goditës fakti që marzhi efektiv i pavarësisë të gjejë shpejt caqet e veta edhe atëherë kur bëhet fjalë për çështje krejtësisht të brendshme. Vështirësia, si juridike edhe teknike, për të respektuar në tokën franceze një vendim të drejtësisë që urdhëron përdoruesit e internetit Yahoo të pushojnë paraqitjen e siteve naziste, dëshmon për atë fuqi të parezistueshme depërtuese që kanë sistemet moderne të komunikimit, por njëkohësisht edhe për kufizimet që hasin politikatat kur nuk janë në harmoni me një konsensus ndërkombëtar. Statuti i arsenaleve të marinës franceze është një tjetër shembull i mirë: me gjithë kundërshtimet e sindikatave dhe politikave të afirmuara, transformimi

i këtyre institucioneve të shtetit në shoqëri anonime është bërë i pashmangshëm që kur atyre u është dashur të mbledhin kapitalet dhe të lidhin aleanca, ndërkohë që homologeve të tyre jashtë, pikërisht atyre gjermane e angleze, u është dashur të operojnë vetëm me ristrukturimet e domosdoshme. Politika e shkëmbimeve me jashtë është një tjetër shembull i kufizimeve, ku mund të futet edhe vetë koncepti për politikën. Një vend nuk mund ta refuzojë hapjen e kufijve të tij për shkëmbimet tregtare, investimet e huaja ose lëvizjen e fondeve, nëse kjo hapje është bërë rregull i përgjithshëm, pasi të mbyllësh kufijtë do të thotë të mënjanoresh nga ekonomia botërore, të privohesh nga një numër burimesh dhe mjetesh, të pranosh se ndërmarrjet nuk mund të ndërkombëtarizohen, pra, të pranosh që ato do të mbesin mjaft të kufizuara në zhvillimin e vet.

Një formë më e gjetur e ndikimeve që vijnë nga jashtë falë globalizimit, është ajo e opinionit publik që globalizohet. Për çastin kjo është për një numër të vogël temash, si: të drejtat e njeriut, lufta kundër korrupsionit, respekti për natyrën, mbrojtja e disa minoriteteve, por ka të ngjarë që ajo të zgjerohet dhe përgjegjësve politikë do t'u duhet ta kenë mirë parasysh këtë në të ardhmen.

PROBLEME DHE SFIDA TË REJA

Ashtu si në çdo periudhë ndryshimi, kur letrat janë përzier dhe kanë ndodhur përmbysjet, fillimisht do të shfaqen tensione: ngjarje që lindin ose vdesin, nevoja të reja për formim e kompetenca që digjen, qendra veprimtarish që zhvendosen, të pasur të rinj, por edhe të varfër të rinj etj., etj. Ky destabilizim i gjerë rrezikon të vërë në diskutim paktin social ose të paktën të çojë në ripërcaktime të termave.

Do të bëhet gjithmonë e më tepër e nevojshme që të drejtohem i drejt shoqërive multikulturore, me efekt të dyfishtë: nga njëra anë, një qarkullim më i lehtë i njerëzve në të gjithë globin, që bën të mundur flukse migrantësh, që vihen në lëvizje prej çekuilibre demografike dhe të ardhurave dhe, nga ana tjetër, nxjerrja në pah e larmisë pasurore që sjell qarkullimi i artistëve,

ideve dhe veprave, ashtu si edhe komunikimi i mirë në fushën e kulturave. Globalizimi prodhon, gjithashtu, një shpërndarje të fuqishme universale të disa prodhimeve të suksesshme, si dhe mundësinë e secilit për t'u shprehur e për t'u bërë i njohur, nxit si uniformitetin e konformizmin, ashtu edhe identitetin, madje edhe individualitetet. Me sa duket, ne po shkojmë drejt një shoqërie ku kulturat do të kenë më shumë mundësi të takohen, të bashkëjetojnë dhe të ndikojnë te njëra-tjetra. Ndërndikimi i kulturave është diçka e vjetër, ai është praktikuar në Europë prej shumë kohësh mes katër poleve të mëdha, që janë Franca, Italia, Gjermania dhe Anglia, por e reja është që ai po futet më thellë në shoqëritë, po shtrihet në të gjithë kontinentet, mes kontinenteve, duke prekur të gjitha bashkësitë. Brenda të njëjtit vend njohja e veçorive kulturore, bashkësive dhe e origjinave është objekt i një kërkese të fortë dhe politikanëve u duhet ta administrojnë mirë këtë larmi që ndonjëherë është çorientuese. Ajo nxit vëmendjen ndaj politikave të integritit kombëtar, si dhe ndaj kërkesave për harmoni qytetare, dhe shtron pyetje praktike lidhur me solidaritetin, ritmet e punës ose pranimin e feve. Mirëpo mund të çojë edhe në acarime, si në rastin e mbajtjes së shamisë islame në shkollat franceze, ose mund të shkaktojë vështirësi të pakapërcyeshme nëse dikush do të donte, për shembull, që secilit t'i njihej e drejta e respektimit të festave të veta fetare. Bashkekzistenca mes identiteteve të ndryshme përbën rrezik në vetvete, pasi mund shkaktojë fare mirë si dialog, ashtu edhe përplasje. Prandaj, që përzierja të mund të jetojë, duhet kohë, durim dhe një shkathtësi e madhe politike. Britania e Madhe, që njihet për indiferencën e saj tradicionale dhe kultin e vullnetit të lirë, ose Hollanda për tolerancën e vet shekullore, janë më të përgatitura për t'i bërë ballë këtij kompleksiteti sesa Franca e edukuar prej vitesh me centralizmin unifikues dhe me historinë madhështore të shtetit-komb. Edhe Gjermania ka vështirësi: sigurisht që ajo nuk është identifikuar kurrë në një territor të vetëm, por kultura e saj ka përbërë gjithmonë një identitet të thellë, aq sa ajo i ka konsideruar të jashtme bashkësitë e huaja që jetojnë në tokën e saj; heqja dorë kohët e fundit nga lidhja e vetme mes

nacionalitetit dhe të drejtës së gjakut, me të drejtë mund të konsiderohet si fillimi i një ndryshimi.

Një situatë e dytë e re, që është përmendur gjithmonë, është shfaqja e konkurrencës mes vendeve. Meqenëse futja ose zhvendosja e veprimtarive, të cilat mund të pasurojnë një vend, sot është bërë e thjeshtë, pasi lokalizimet varen më pak se në të shkuarën prej prodhimeve bazë, burimeve të energjisë ose edhe prej vetë tregjeve, çdo vend përpiqet që të tërheqë numrin më të madh të ndërmarrjeve me vlerë, në kupimin jo vetëm të vlerës së shtuar ose të vendeve të punës, por edhe të njohurive teknologjike, të miradministrimit dhe përvojave të tregut. Kjo kërkon krijimin e mjediseve të favorshme për tregtinë, metoda të reja për ndërmarrjet, duke kaluar nëpërmjet politikave të infrastrukturës, të edukimit e pritjes së të huajve, regjimeve fiskale dhe juridike të përshtatshme me nevojat e reja të globalizimit dhe, më në fund, krijimit të kushteve të punës e të jetës tërheqëse për mjediset profesionale (laboratorë e biblioteka, qendra kërkimi, lidhje cilësore me botën e kërkimit, universitete e ndërmarrje etj.). E gjithë kjo kërkon prej përgjegjësve politikë hapje pa ndërprerje me botën e jashtme dhe syçeltësi ndaj çdo gjëje që ndodh përreth. Bërja e krahasimeve ndërkombëtare dhe *benmarching*-u, domethënë pozicionimi në raport me konkurrencën, duhet të jenë një shqetësim i përhershëm për ta.

Situata e tretë e re është rritja e frikës nga rreziku edhe në vendet e zhvilluara. Bota jonë sot është më e mbrojtur dhe më e sigurt sa asnjëherë tjetër e, megjithatë, globalizimi bën të ndihen më shumë elementet e brishtësisë së saj, nga njëra anë, sepse rrjeti i shtrënguar i ndërlihdjeve në të cilin ne jetojmë na bën të varur nga një numër i madh faktorësh të jashtëm dhe, nga ana tjetër, sepse lehtësirat e reja të komunikimit, transportit dhe informimit bëjnë të mundur transmetimin e krizave, të aksidenteve, epidemive dhe krimeve me një shpejtësi marramendëse. Rreziku është më pak i pranueshëm, sepse vetë zhvillimet e teknikave të kontrollit, vëzhgimit ose të sigurimit ndihmojnë për ta kufizuar atë. Edhe nëse ai ndodh, kjo është pasojë e një

gabimi për të cilin ka një përgjegjës. Si rezultat, politikanët kanë përgjegjësi të vazhdueshme jo vetëm para zgjedhësve të tyre, por ata kanë edhe përgjegjësi civile e, tanimë, edhe penale. Për pasojë, të qenit i kujdesshëm, domethënë parapëlqimi për siguri maksimale, si dhe prirja për t'ua transferuar ekspertëve të drejtën e marrjes së vendimeve të politikës, mund t'i bëjë qeveritarët mosbesues ndaj çdo të gjëje të re dhe madje hezitues para eksperimentimeve, duke parapëlqyer kështu të shkuarën sesa të ardhmen, për t'u kthyer në anën më fisnike të misionit të tyre që është përcaktimi i rrugëve të reja dhe përgatitja e së ardhmes.

Përgjegjësitë që dalin nga këto tri situata, të përzgjedhura mes shumë të tjerash, i takojnë shteteve dhe janë të rrepta për politikanët. Kështu, nuk mund të shmanget pyetja për vendin që duhet të zënë shtetet dhe për modalitetet e qeverisjes.

* * *

Pyetja ka të bëjë njëkohësisht me shtetet që kanë mbetur prapa ose që janë dubluar me aktorë të tjerë të rinj të ardhur në jetën politike, si dhe qeveritë që kanë pikëpyetje rreth formave të reja të sovranitetit dhe autonomisë.

SHTETET DUHET TË MBËSHTETEN TEK AKTORËT E RINJ TË JETËS POLITIKE

Ashtu si në tragjeditë e lashtësisë, në jetën politike janë aktorët, pra ata që luajnë, dhe pranë tyre kori, që i mbështet, i qorton ose komenton lëvizjet e tyre. Mes aktorëve, natyrisht, janë shtetet, çdo krijim parashtetëror, si dhe organizatat joqeveritare, ndërsa bëjnë pjesë te kori opinionet publike me instrumentet e veta, si mediat dhe interneti, dhe mjediset ekonomike të grupuara rreth tregut.

Ka pesëdhjetë vjet që shtetet ishin aktorët kryesorë të jetës politike, si në vendin e tyre, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Ekzistonin vetëm disa

organizata ndërkombëtare dhe disa shprehje të kufizuara të shoqërisë civile, pra ata ishin qendra e pushteteve, referenca kryesore e çdo organizate politike, kombëtare e ndërkombëtare, madje njësia bazë e çdo veprimtarie ekonomike. Shteti-komb ishte maja e një evolucioni. Por ky vizion tani është vjetëruar dhe sot është bashkësia e aktorëve publikë ajo që imponohet. Sigurisht, shteti-komb mbetet një realitet, por e ardhmja e tij është e diskutueshme në atë masë që kombet moderne bëhen plurietnike dhe shtetet e shohin se kanë mbetur prapa, si nga lart, ku vendosen organizata *multi-*, *pluri-*, ose *supra-*kombëtare, ashtu dhe poshtë, ku duket se po pranohet ngritja në fuqi e bashkësive vendore. Mund të shohim te grupimet rajonale të shteteve, si ALENA, ASEAN, Mercosur dhe sigurisht te Bashkimi Europian frutin e globalizimit, një kompromis mes nevojës praktike për të kapërcyer kufijtë dhe hezitimit për t'u bashkuar me qarqe botërore tepër të largëta, tepër të ngarkuara, tepër anonime. Të gjitha këto grupime nuk synojnë ato forma integrimi aq nxitëse sa Bashkimi Europian, dhe nuk përfshijnë atë gamë të gjerë fushash. Shumica kanë si qëllim të bëhen zonë e këmbimit të lirë ose një hapësirë e pëlqyeshme investimi, por shumë kanë prirje të bëhen instanca ndërmjetëse të rregullimit të globalizimit. Prandaj ato përpiqen të inkuadrojnë veprimin e shteteve si nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëveshjeve ndërqeveritare, ashtu edhe vendimeve të autoriteteve që kanë në krye.

Sa për *bashkësitë vendore*, si landet gjermane, rajonet italiane e franceze, bashkësitë autonome spanjolle, rajonet e bashkësitë belge, asnjëra prej tyre nuk ka kompetenca diplomatike, pasi ato janë pjesë e qeverive qendrore, por të gjitha shpresojnë të njihen në planin ndërkombëtar, shqetësohen të sigurojnë futjen e tyre në ekonominë e globalizuar, negociojnë drejtpërdrejt për ndihma dhe financime për zhvillim, bëjnë që të vlerësohet qëllimi i tyre kryesor dhe përpiqen të fitojnë diçka, atëherë kur qeveritë qendrore heqin dorë nga disa angazhime.

Organizatat ndërkombëtare, të cilat janë bërë të shumta, në këto pesëdhjetë vjet janë kthyer në aktorë të rëndësishëm të jetës politike ndërkombëtare.

Që nga OKB-ja dhe FMN-ja e grupi i Bankës Botërore, OBT-ja, FAO e OBSH, të gjitha fushat janë përfshirë në to dhe të gjitha vendeve të botës u bëhet thirrje për t'u anëtarësuar aty një ditë. Janë të rralla ato organizata që kanë kapacitet të imponojnë vendimet, pasi rregulli i unanimitetit është pothuajse i përgjithshëm dhe ato janë vende negociatash, forumesh ku mblidhen informacione e statistika, ku dalin çështjet e mëdha të politikës, ku merret opinioni botëror, të paktën ai i qeverive. Ato janë qendra ndikimi, zyra studimi dhe promotore të negocimeve. Nëse e bëjnë mirë punën e tyre, ato kthehen në roje të ndërgjegjes ndërkombëtare.

Juridiksionet ndërkombëtare janë ende aktorë të nivelit të dytë të jetës politike, por që nuk duhen nënvlerësuar. Instancave, të cilat u janë rezervuar shteteve (Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Organizmi i Rregullimit të Mosmarrëveshjeve i OBT-së, Gjykata Europiane), u shtohen, kohët e fundit, edhe gjykata penale për të gjykuar të drejtat e njeriut dhe krimet kundër njerëzimit (si Gjykata Ndërkombëtare Penale krijuar për ish-Jugosllavinë dhe ajo për Ruandën).

Grupimet e shteteve, të bashkësive vendore, organizatave ndërkombëtare dhe juridiksioneve janë pjesë e institucioneve publike krijuar prej shteteve dhe ekzistojnë vetëm prej tyre. Në krah të tyre ka aktorë jopublikë, që janë në thelb OJQ-të, të cilat prej disa vitesh janë shtuar, duke u bërë nga disa qindra në tridhjetë mijë aktualisht. Kryesisht aktive në fushën e të drejtave të njeriut, ekologjisë, veprimeve humanitare etj., pothuajse kanë hequr dorë nga ndihma për zhvillim; mosbesuese ose kundër globalizimit, në mënyrë të pavarur nga shtetet, dhe natyrisht me mjete më të pakta, ato luajnë rol jo të vogël. Duke qenë në terren dhe në pozita jozyrtare ato disponojnë informacione që janë pranë realitetit vendor dhe më shpejt të transmetueshme sesa ato që shtetet sigurojnë prej rrjeteve të tyre. Madje, dhe kjo është tepër e jashtëzakonshme, ato mund të organizojnë rregulloren e konflikteve, siç është shembulli i bashkësisë së San Egidio-s në Afrikë. Të kthyer në bashkëbisedues të rëndësishëm të organizatave ndërkombëtare dhe të

shteteve, edhe pse përfaqësimi i tyre mund të jetë i diskutueshëm, OJQ-të e justifikojnë rolin e vet me shpikjet e tyre, me aftësitë për të vënë gishtin në çështje të panjohura, si dhe me gatishmërinë për të qenë në shërbim të tyre. Pra, ato nuk mund të ekzistojnë dhe mbi të gjitha nuk mund të financohen, veçse duke pasur mbështetjen e opinionit ndërkombëtar.

Opinionit ndërkombëtar ushqehet nga mediat e fuqishme, ku vend kryesor zënë rrjete vërtet ndërkombëtare siç janë CNN-i ose për botën e Lindjes së Afërme kanali El Jazira. Pamjet nga Somalia e Iraku, ato nga Afganistani, si dhe ato të atentateve të 11 shtatorit 2001 janë dhënë nga të gjitha televizionet e botës. Sigurisht që këto media janë promotoret e globalizimit, edhe pse të njëjtat dokumente janë pranuar nga publiku në mënyra të ndryshme, nga disa me indinjata, ndërsa të tjerë i kanë duartrokatur, pasi globalizimi nuk është radhitje opinionesh, por vënie e informacionit të njëjtë në dispozicion të të gjithëve.

Edhe interneti po ndihmon në shkrirjen e opinionëve dhe forumeve në site. Me të po lind perspektiva e zhvillimit të debatit politik që organizohet jashtë qeverive, partive, sindikatave dhe institucioneve.

Në debatin politik rëndon gjithë bota ekonomike, domethënë konsumatorët dhe prodhuesit, ndërmarrjet dhe investuesit, financierët dhe ndërmjetësit, shkurt të gjithë ata, veprimtaria, vendimet dhe qëllimet e të cilëve gjejnë shprehje te tregjet. Për të qenë më të saktë, duhet të themi se tregjet s'janë gjë tjetër veçse instrumente, ato shprehin pikën ku takohet oferta dhe kërkesa e moduluar më parë për të ardhmen. Ato nuk kanë as dëshira, as strategji, por thjesht janë matëse që lejojnë të kuptohet ajo çka, me lojën e lirë të mjeteve të tyre, aktorët e botës ekonomike dëshirojnë të bëjnë ose mund të bëjnë në fushën e investimeve, të punës e të stimulimit të kërkesës. Ato janë furnitore të dhënash, por jo vendimarrëse, kështu që shumica e interesave të ndërmarrjeve nuk përbën diplomaci.

Si përfundim, shtetet nuk janë më të vetmit aktorë, por ato nuk janë aktorë si gjithë të tjerët. Ato janë vendi i shfaqjes së “dëshirës për të jetuar

së bashku”, vendi i shprehjes së vullnetit demokratik dhe i formimit të pushteteve. Historia e kohëve të fundit tregon qartë se vendimet e mëdha u takojnë atyre, si atëherë kur bëhet fjalë për luftë kundër terrorizmit, edhe kur kërkohet stimulim i veprimtarive ekonomike, por qeveritë duhet të integrojnë në analizat politike edhe forcat e tjera që veprojnë rreth tyre. Sepse sot po bëhet e qartë që shteti nuk është i gjithëfuqishëm dhe miradministrimi i autoritetit në politikë është një problem i shtruar për zgjidhje.

DREJTIME TË REJA TË AUTORITETIT NË POLITIKË

A po zhduket autoriteti politik?

Fillimisht duhet thënë se shteti nuk ka qenë kurrë i plotfuqishëm, madje edhe në kohët kur fqinjët ishin të largët dhe ai e administronte vetë ekonominë. Është e vërtetë që detyrimet, të cilat vijnë nga jashtë, po bëhen gjithmonë e më të ngutshme, për faktin e zhvillimit që kanë marrë komunikacioni dhe transportet, por edhe sepse, falë disiplinave ndërkombëtare, ato po inkuadrohen më mirë se në të kaluarën, kur njëhej vetëm ligji i më të fortit. Pra, gjithmonë ka autoritete, por ndryshe nga dikur, ato ushtrohen në vende të tjera: sovraniteti është ndarë dhe zhvendosur.

Organizatat e shumëllojshme, krijuar nga shtetet për të plotësuar ato funksione për të cilat kuadri i tyre territorial është ngushtuar shumë, janë bërë sot vendet e reja të pushtetit. Kjo ka të bëjë, gjithashtu, si me parandalimin e krizave financiare, ashtu edhe me organizimin e tregtisë ndërkombëtare, me luftën kundër korrupsionit dhe krimit financiar. Pra, ushtrimi i sovranitetit nuk është më diçka e lidhur vetëm me territorin, por ai ndahet edhe sipas fushave e niveleve. Ky koncept mbi sovranitetin e shumëfishtë është shqetësues për ata përgjegjës politikë trashëgimtarë të së shkuarës, ende të afërt, ku sovraniteti ishte global, shihej si një bllok unik dhe ushtrohej pa asnjë kundërshtim nga jashtë. Mirëpo këta përgjegjës politikë duhet të nxjerrin pasojat e formave të reja të sovranitetit, domethënë të dinë t’u drejtohen të gjitha niveleve të pushtetit, të luajnë lojën e pushtetit vendor, kombëtar e global.

Nuk është e lehtë për qytetarin të dallojë vendet e reja të pushtetit. Pësjhtëjllimi, shumë i përhapur momentalisht, që i ndodh atij përpara këtij kompleks, është origjina e asaj ndjenje të largimit dhe e çpersonalizimit të pushtetit politik. Sa për “deficitin demokratik”, për të cilin flitet rregullisht, ai ka vërtet vështirësi për të asimiluar funksionimin e organizatave ndërshtetërore. Edhe pse transparenca është e plotë, atyre u duhet të administrojnë diferencat politike dhe kulturore, të cilat i detyrojnë të shumëfishojnë përkujdesjet lidhur me gjuhën ose saktësimet teknike. Sa më të shumtë të jenë partnerët, aq më shumë ndryshojnë përparësitë dhe kompromiset janë të vështira për t’u kuptuar e pranuar, aq më shumë përhapet ideja e një pushteti të largët, burokratik dhe teknokratik, i cili ka humbur lidhjet me bazën dhe krijohet shqetësimi sikur globalizimi është njëri prej shkaqeve, edhe pse në këtë rast ai nuk është i akuzuar.

Në fillim duhet theksuar se kjo sasi marrëveshjesh dhe rregullash ndërkombëtare e shkaktuar nga nevoja e globalizimit, mund të ndryshojë ekuilibret institucionale, në atë masë që një pjesë e madhe e punës legjislative të paracaktohet nga qeveritë, meqenëse janë ato që negociojnë dhe nënshkruajnë këto marrëveshje (po kështu edhe për vendimet e Bashkimit Europian). Në të gjitha vendet, sigurisht, është parlamenti ai që trajton çështjet e negociimit dhe informohet për zhvillimin e tyre prej parlamentarëve që e përfaqësojnë atë nëpërmjet delegacioneve zyrtare, mirëpo marrëveshja përfundimtare vendoset prej qeverive. Pasi është gjetur një terren marrëveshjeje që i kënaq të gjithë, do të jetë e vështirë të ndryshohet dokumenti që e përmban atë, ndaj parlamenteve nuk u mbetet veçse ta miratojnë. Për arsye të Kushtetutës së tyre, Shtetet e Bashkuara kanë një vështirësi pak a shumë të brishtë, pasi duhet të zgjedhin midis, *nga njëra anë*, ushtrimit të plotë të të drejtave të Kongresit për çdo negociim të rëndësishëm, duke rrezikuar hedhjen poshtë të një dokumenti tashmë të nënshkruar, negociuar dhe vendosur dhe, *nga ana tjetër*, të drejtës së Presidentit për të negociuar dhe Kongresi të pranojë duke e votuar tekstin përfundimtar, duke ruajtur të drejtën e ratifikimit ose të refuzimit në bllok.

Megjithatë, funksionimi i qeverive dhe shërbimeve të tyre po kërkon transformime. Prej disa vitesh teknikat e reja të informimit kanë lehtësuar mjaft komunikimin me bazën, duke minuar ato shtylla të strukturave tradicionale që janë qarkullimi i atij informimi të rezervuar vetëm për rrethet e brendshme të piramidës hierarkike, si dhe filtrimi i tij. Tashmë informacioni shpërndahet më lirisht dhe puna në rrjet po përparon, duke lehtësuar veprimet me shumë partnerë, e duke i detyruar autoritetet të imponohen gjithmonë e më tepër me kapacitetin e tyre analizues, gjykues dhe komandues, sesa me monopolin e tyre të informacionit. Për shumë struktura shtetërore ndryshimi është i pranueshëm, por veçanërisht ai i përshtatet botës shumëpolare, që është ajo e globalizuar. Në këtë kontekst levat e qeverisë kanë ndryshuar: pranë ndërhyrjeve të drejtpërdrejta klasike janë duke u zhvilluar veprimet e shoqëruara me shumë partnerë, si dhe misionet e rregullimit, të vlerësimit dhe kontrollit, të cilat korrespondojnë me një shtet më pak veprues, por më shumë bashkues nismash, mbledhës i palëve të interesuara për të punuar së bashku dhe negociator i interesit të përgjithshëm.

* * *

Globalizimi kërkon shumë. Tani mjeshtëria e tyre duhet t'i përshtatet një konteksti të ri. Atyre u duhet t'i mbajnë sytë hapur për çdo gjë që ndodh përtej kufijve, të flasin gjuhë të huaja, kjo kuptohet, por gjithashtu të njohin edhe kulturat politike, administrative dhe ekonomike të vendeve të tjera. Një nga shkaqet e ngecjes së globalizimit është, në fakt, mospajtimi mes mbërritjes papritmas të fakteve dhe ndërgjegjësimit politik, i cili ndodh pasi kalon njëfarë kohe nga kuadrimi i tyre institucional. Këto periudha boshe të rregullimit mund t'i hapin dyert çdo lloj shmangieje. Përgjegjësit politikë duhet të dinë ta shpjegojnë këtë proces hutimi me pasoja të reja dhe destabilizuese. Për këtë duhet pyetur shumë, pasi politikanët nuk ndjehen rehat me globalizimin, të paktën në Francë. Prej shumë kohësh ata kanë harruar të flasin për të. Ato

që ndodhnin në OCDE, GATT, në Bruksel ishin çështje që u takonin specialistëve që e ndjenin gjithnjë e më pak nevojën e komunikimit me jashtë, pasi lënda u dukej shumë teknike për një opinion publik, i cili, sipas tyre, ishte indiferent dhe për një media që ngjante si pak e interesuar. Që nga mosnënshkrimi i Marrëveshjes Shumëpalëshe për Investimet në vitin 1998, globalizimi po zë vendin e parë në skenë, mirëpo politikanët duket se e kanë ende të vështirë të flasin mirë për të. Janë të rrallë ata që thonë diçka të mirë për globalizimin, përkundrazi bashkohen kur bëhet fjalë për t'i veshur atij ndonjë të keqe të re: nëse një ndërmarrje zhvillohet në sajë të tregut botëror, kjo është normale, por kur ajo falimenton sepse prodhimet e saj nuk e përballojnë dot konkurrencën, kjo ndodh për faj të globalizimit. Edhe ata që e gjykojnë përgjithësisht pozitiv globalizimin, i afrohen me dyshim atij, duke folur për të si për një dukuri që i ndodh dikuajt dhe jo si një sasi e konsiderueshme mundësish të reja, duke u bërë kështu më tepër të ndjeshëm ndaj rreziqeve, sesa ndaj të mirave të tij, prandaj dhe diskutojnë pothuajse vetëm për mënyrat se si të rregullohet, kontrollohet dhe korrigjohet ai. Edhe pse i kuptojnë avantazhet e një globalizimi të drejtuar dhe të administruar mirë, politikanët ngulmojnë për marrjen e masave, të cilat do të lejonin asimilimin e tij në kushte të përshtatshme për të pasur sukses të garantuar. Megjithatë, disa vende kanë ecur mirë: Britania e Madhe nuk i njuh pengesat franceze, as Gjermania, ku kancelari Schröder ka ndërmarrë një reformë fiskale, duke i ndihmuar ndërmarrjet në reformimin e strukturave të tyre për të qenë kështu në harmoni me gjithçka të nevojshme që u sjell globalizimi.

Vizioni mbi globalizimin që zotëron në debatin politik francez është pasiv, prandaj një trajtim më aktiv do të ishte me interes, të paktën, për të përmirësuar termat rreth tij.⁴

⁴ Marrë nga "Revue politique et parlementaire", Nr. 1015.

Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në raport me institucionet politike

Niazi Jaho
Jurist

E kam të vështirë që në kuadër të një kumtese të trajtoj gamën e gjerë të çështjes së efekteve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në raport me institucionet politike.

Ja disa elemente dalluese dhe krahasuese që mbështeten dhe parashikohen në dispozitat përkatëse të Kushtetutës. Së pari, Presidenti i Republikës, megjithëse nuk merr pjesë në asnjë nga tre pushtetet, ka kompetenca të rëndësishme. Mjafton të përmendim se me pëlqimin e Kuvendit është ai që emëron të 9 anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, se është ai që emëron gjithashtu me pëlqimin e Kuvendit edhe Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese. Presidenti përfaqëson unitetin e popullit dhe është shtylla e strukturës kushtetuese, por, sipas Kushtetutës, është Gjykata Kushtetuese që garanton respektimin e saj. Së dyti, ndërsa Kuvendi është organi më i lartë legjislativ që ka të drejtë të kontrollojë ekzekutivin, të miratojë dhe të ndryshojë ligjet, të shkarkojë në rastet e parashikuara me ligje anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, kompetencën për të shqyrtuar pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, para ratifikimit të tyre, e ka vetëm Gjykata Kushtetuese. Së treti, Kuvendi dhe institucionet e tjera, në zbatim të Kushtetutës, mund t'i interpretojnë ligjet, ndërsa Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Së katërti, gjykatat e sistemit gjyqësor, kur vërejnë se ligjet bien ndesh me Kushtetutën, pezullojnë shqyrtimin e çështjes dhe ia dërgojnë

atë për t'u shprehur Gjykatës Kushtetuese. Së pesti, ndërsa gjykatat e sistemit gjyqësor, Prokuroria, Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe, së fundi, ndërsa vendimet e organeve të tjera, duke përfshirë këtu edhe ato të gjykatave në kushtet e parashikuara nga ligji janë të atakueshme, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare, të formës së prerë dhe të detyrueshme për zbatim.

I përmenda jo rastësisht këto çaste, sepse ka pasur edhe ndonjë rast kur interpretimi subjektiv i çështjeve të mësipërme ka çuar në debate të acaruara dhe shpesh të politizuara.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, siç dihet, është krijuar në vitin 1992. Para nesh, në mjaft vende të tjera demokratike funksiononin gjykata kushtetuese. Krijimi në vendin tonë i këtij institucioni nuk është ndonjë novacion shqiptar. Po të krahasosh kompetencat e Gjykatës sonë Kushtetuese që parashikohen në Kushtetutë dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e kësaj Gjykate me ato të këtij ose atij vendi demokratik, mund të vihet re edhe ndonjë ndryshim, por që nuk ka të bëjë me parimet bazë mbi të cilat mbështetet dhe funksionon ky institucion i rëndësishëm kushtetues. Megjithkëtë, siç dihet, as Kushtetuta dhe as ligjet nuk janë tabù. Kur është e nevojshme dhe kur e dikton praktika, edhe ato mund të ndryshohen ose saktësohen. Por nuk më duket normale që të flasësh për ndryshim në ligjin për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese që ka marrë 106 vota në Kuvend dhe pa argumente të vendosësh (siç vendosi Kuvendi në muajin qershor të vitit 2002), të ngarkosh ekzekutivin që të përgatisë dhe t'i dërgojë atij projektin e ndryshimit të këtij ligji. Duke ndjekur veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese në këto 12 vjet, mund të arrihet në përfundimin se ajo e ka justifikuar ekzistencën e saj. Kur flasim për institucionin, do të ishte gabim ta personalizojmë ose ta ndanim atë në periudha se si ka punuar kjo Gjykatë, kur në pushtet ka qenë opozita e sotshme dhe si ka punuar ose si punon ajo që aktualisht është pozita. Mund të bësh kritika si për njërën

periudhë, edhe për tjetrën, por e përgjithshmja mendoj se është pozitive. Në fund të fundit vitet që ajo funksionon janë relativisht të pakta. Askush, pra edhe Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj nuk është e imunizuar nga gabimet. Nuk mund të përjashtohet edhe ndonjë rast i ndikimit politik mbi të, por kam mendimin se raste të tilla që janë pjesë e zhvillimit demokratik, të përsosjes së legjislacionit, të emancipimit të vetë forcave politike dhe të shoqërisë në tërësi, nuk duhet të çojnë deri atje sa emocionalisht, d.m.th. pa studime, pa përgjithësime, pa argumente, të kërkohet shkrirja e kësaj Gjykate ose rikompozimi nëpërmjet balancimit të forcave politike në përbërjen e saj, dhe aq më keq të bëhen deklaratat se ky ose ai vendim ose interpretim i Gjykatës Kushtetuese ka goditur parlamentarizmin.

Dukuria korrupsion, siç dihet, ekziston edhe në gjykatat. Shqetësimi pra, është i pranishëm. Por të flasësh me muaj dhe vite të tëra për ekzistencën e kësaj dukurie dhe të mos e identifikosh, të mos e individualizosh, dhe të mos e goditësh atë, do të thotë të nxitësh, qoftë edhe tërthorazi, zhvillimin e tij.

Kur janë kushtet e parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, nuk ka pse të ngurrohet për shkarkimin e gjyqtarëve deri anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Por hamendësimet dhe akuzat e pabazuara nuk i shërbejnë forcimit të institucioneve demokratike.

Duke studjuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese të periudhës 1992 deri në fund të vitit 2002 (përjashtuar këtu vendimet lidhur me zgjedhjet parlamentare), rezulton se në 32 raste Gjykata ka shfuqizuar si antikushtetuese pjesërisht ligje të miratuara nga Kuvendi. Në morinë e vendimeve të dhëna nga Gjykata dhe sidomos të ligjeve të miratuara nga Kuvendi, kjo shifër mund të mos jetë shqetësuese. E megjithkëtë, qoftë edhe vetëm në këtë vështrim, duhet pranuar roli pozitiv i Gjykatës Kushtetuese, si dhe fakti se edhe organi legjislativ mund të miratojë ligje dhe vendime që bien ndesh me Kushtetutën dhe që mund të shoqërohen me pasoja të dëmshme. Këndvështrimet mund të jenë të ndryshme, kështu p.sh., mund të mos jesh

dakord me ndonjë interpretim të kësaj ose asaj dispozite kushtetuese, por vetëm kaq, sepse interpretimin përfundimtar të Kushtetutës e bën Gjykata Kushtetuese. Mund të mos jesh dakord me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për çështjen “Rakipi” (ish-Prokurori i Përgjithshëm), por vetëm kaq, sepse vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

E shikoj të nevojshme të theksoj se për çështje të tilla jam prononcuar publikisht edhe më parë, madje në kohën e duhur. Gjithashtu publikisht jam shprehur edhe kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese që shfuqizoi si antikushtetuese dy dispozita të ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, por njëkohësisht jam shprehur me shkrim se ky vendim është përfundimtar dhe duhet zbatuar.

Institucionet përkatëse kushtetuese të vendit tonë, forcat politike dhe në radhë të parë vetë Kuvendi, kam bindjen se e vlerësojnë seriozisht shqetësimin e Komisionit të Venecias të Korrikut 2002 që, edhe pse nuk komenton vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ka tërhequr vëmendjen lidhur me moszbatimin e vendimit që ka të bëjë me çështjen “Rakipi”, me arsyetimin se Gjykata Kushtetuese është instanca e ngarkuar të vigjëlojë respektimin e Kushtetutës dhe që vendimet e saj janë përfundimtare dhe nuk mund të kundërshtohen.

Në të njëjtën linjë është pozicionuar edhe Komisioni Europian në raportin e tij të datës 26.3.2003 në kuadrin e hapjes së negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ku midis të tjerave thuhet se “Kushtetuta e vitit 1998 është një mekanizëm adekuat për mbështetjen e zhvillimit demokratik të Shqipërisë”. Dhe më poshtë thuhet se “është i gabuar vendimi i Kuvendit që ka injoruar vendimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm ose mosrespektimi i afatit përfundimtar të përcaktuar në nenin 181 të Kushtetutës, ku bëhet fjalë për rregullimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me pronën.”

E pashë të nevojshme t’i përmend këto çështje, megjithëse kohët e fundit ato kanë hyrë në rrugën e zgjidhjes, siç janë p.sh. plotësimet dhe rregullimet

që kishin krijuar zbrazëti ligjore, përpjekjet që po bëhen për përsosjen e mëtejshëm të legjislacionit tonë bashkëkohor dhe demokratik, duke i përqasur ato me standardet ndërkombëtare etj.

Në hartimin dhe miratimin e ligjeve ose ndryshimin e tyre është e nevojshme të tregohet kujdes i veçantë. Në radhë të parë duhet të mbahet parasysh që ato të mos bien ndesh as me frymën dhe as me dispozitat përkatëse të Kushtetutës. Por në të njëjtën kohë, duhet të kihet parasysh edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e saj për çështje të caktuara. E theksoj këtë për faktin se, me gjithë pozicionimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese lidhur me të drejtën e mbrojtjes të të dënuarit në mungesë, Kuvendi bëri ndryshime në nenin 410 të Kodit të Procedurës Penale, çka shkaktoi shfuqizimin e tij si antikushtetues. U ndala në këtë çështje edhe për faktin se ka propozime që, për ta bërë më të efektshme luftën kundër kriminalitetit, të miratohet një paketë dispozitash penale, ku të parashikohen dënime fikse. Edhe pse kam bindjen se qëllimi është i mirë, nuk e di nëse autorët e këtyre propozimeve kanë pasur parasysh vendimin nr.13, datë 29.5.1997 të Gjykatës Kushtetuese që shfuqizonte si antikushtetuese të gjitha dispozitat e Kodit Penal që parashikonin dënime fikse me arsyetimin se “sanksionet fikse eliminojnë mbrojtjen përsa i përket shkallës së rrezikshmërisë së veprës së kryer e të autorit të saj dhe gjykatës i heqin mundësinë e individualizimit të dënimit. Si rrjedhojë, me sanksionet fikse, çënohen të drejtat e njeriut të garantuara në parimet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, për një gjykim të drejtë.”

Një problem tjetër, që mendoj se është e nevojshme të evidentohet dhe të mbahet parasysh, është ai i masave që duhen marrë kur Gjykata Kushtetuese shfuqizon si antikushtetuese dispozita të caktuara të këtij ose atij ligji. Ka raste kur shfuqizimi nuk kërkon rregullime në ligje, por ka edhe raste të tjera që janë më të shumta, që Kuvendi duhet të bëjë ndryshime, plotësime ose saktësime. Bëhet pyetja: A duhet të ketë ndonjë afat për këto rregullime? Kam mendimin se kjo çështje vlen të diskutohet.

Pavarësisht nga disa të meta ose mungesa që trajtuam më lart, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligje të shumta dhe të rëndësishme, demokratike dhe bashkëkohore, se praktika parlamentare është bërë më e gjallë dhe më transparente, se zëri i opozitës ndihet më shumë. Edhe në fushën parlamentare është grumbulluar një përvojë jo e paktë. Megjithëkëtë ne kemi nevojën e përvojës dhe të asistencës së institucioneve dhe vendeve të tjera demokratike që nuk na ka munguar dhe nuk do të na mungojë as në të ardhmen.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën janar-mars 2003

*Përgatiti
Alma Kondakçi*

1. Vizitë e Kryetarit të Komisionit European, zotit Romano Prodi

Në seancën plenare të datës 31 janar 2003 ishte i pranishëm Presidenti i Komisionit të Bashkimit European, Romano Prodi.

Në fjalën e tij zoti Prodi theksoi se dita e sotme konsiderohet si hapje zyrtare e bisedimeve për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit mes Bashkimit European dhe Republikës së Shqipërisë pas bisedimeve që kanë zgjatur për më se një vit. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është hapi i parë në rrugën drejt pranimit të Shqipërisë në Bashkimin European si anëtare me të drejta të plota. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, palët marrin përsipër të zbatojnë një numër parimesh, që nga respektimi i të drejtave të njeriut, te vendosja e një sistemi demokratik, të mbështetur në sundimin e ligjit dhe në respektimin e tij; nga realizimi i ekonomisë së tregut, te lufta kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të kundraligjshme.

Kryetari i Kuvendit Servet Pëllumbi, në fjalën e tij me rastin e kësaj vizite, duke vlerësuar mbështetjen dhe inkurajimin e Bashkimit European në proceset integruese të rajonit tonë, tha se Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në konsolidimin e institucioneve demokratike dhe në funksionimin e shtetit të së drejtës. Ajo po luan një rol të rëndësishëm konstruktiv në rajonin e Ballkanit dhe ka vullnetin politik për luftë të vendosur e rezultative kundër varfërisë, trafiqeve ilegale, korrupsionit e kontrabandës.

2. Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për ngjarjet në Irak dhe qëndrimin e Qeverisë Shqiptare lidhur me to.

Më 3 mars 2003 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shqyrtoi e miratoi Rezolutën, në të cilën shpreh qëndrimin e tij ndaj ngjarjeve të kohëve të fundit në Irak dhe regjimit diktatorial të Sadam Hyseinit, si dhe mbështetjen që i jep Qeverisë Shqiptare për veprimet e saj ndaj këtij regjimi.

Sipas Rezolutës, regjimi i Sadam Hyseinit vazhdon të jetë një rrezik potencial për paqen dhe sigurinë në botë dhe nuk bashkëpunon me organizmat ndërkombëtarë për çarmatimin dhe shkatërrimin e armëve të dëmtimit në masë. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e dënon ashpër këtë mungesë bashkëpunimi në përputhje me rezolutën e OKB-së, mbështet përpjekjet e koalicionit ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve në rrugë diplomatike, por edhe me anë të forcës nëse gjykohet e nevojshme, mbështet Qeverinë Shqiptare në qëndrimet e saj ndaj çështjes së Irakut, angazhimin e saj dhe të pushtetit vendor për pritjen dhe krijimin e lehtësive trupave të Aleancës në rast vendosjeje në territorin e vendit tonë.

Në rast të një sulmi të koalicionit kundër këtij regjimi, Kuvendi autorizon Këshillin e Ministrave të verë hapësirën detare, ajrore dhe tokësore të Republikës së Shqipërisë në dispozicion të forcave dhe mjeteve të Aleancës sipas kërkesave të saj, si dhe të kontribuojë me kapacitete ushtarake për koalicionin, në rast se kjo do të kërkohet.

3. Raport për veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2002 (mbajtur në seancën plenare të datës 10.2.2003)

Kryetari i këtij Komisioni, zoti Roland Përmeti, në raportin që i paraqiti Kuvendit, për veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2002, theksoi se objekt i punës së tij ka qenë zbatimi me korrektesë dhe përpikmëri i ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Shërbimit Civil”. Gjatë vitit 2002 ky Komision ka mbikëqyrur procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën qendrore e vendore.

Drejtimi kryesor i punës së Komisionit ka qenë zgjidhja e ankesave për moszbatim të ligjit.

Komisioni vëren se ligji “Për statusin e nëpunësit civil” nuk njihet mirë, veçanërisht kërkesat e tij në lidhje me eprorin e drejtpërdrejtë dhe procedurën administrative disiplinore të largimit nga shërbimi civil. Në raport pasqyrohen disa shkelje ligjore të vërejtura në procedurat e pranimit në shërbimin civil dhe në rastet e largimit nga puna.

Sipas raportit, në administratën qendrore ndeshet shpesh dukuria e emërimit në punë pa kryer teste konkurrimi dhe pasqyrohen shkaqet e kësaj dukurie.

Raporti pasqyron drejtimit kryesor të punës së Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2003 dhe jep disa rekomandime për përmirësimin e ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”.

Gjatë debatit të zhvilluar në seancë plenare për Raportin e Komisionit të Shërbimit Civil, maxhoranca e mbështeti plotësisht atë dhe vlerësoi punën e këtij Komisioni. Opozita u shpreh kundër këtij Raporti për disa arsye, ku ndër më kryesoret janë:

- Në administratën shtetërore vihet re dukuria e klanizimit dhe nepotizmit;
- rekomandimet e Komisionit të Shërbimit Civil nuk zbatohen nga strukturat vendimmarrëse ekzekutive.

4. Raport vjetor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë e vitit 2002 (Raport i mbajtur në seancën plenare të Kuvendit, më 6 mars 2003)

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, raporton para Kuvendit për veprimtarinë e këtij Komisioni gjatë vitit 2002, drejtimi kryesor i punës së të cilit ka qenë përgatitja dhe organizimi i shtatë proceseve zgjedhore të pjesshme. Gjithashtu, gjatë këtij viti Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka punuar për ngritjen e komisioneve zgjedhore të zonave dhe komisioneve zgjedhore të qendrave të votimit, përmirësimin e Regjistrisë të

Votuesve, ngritjen e nivelit profesional të stafit të tij dhe njohjen e praktikave zgjedhore ndërkombëtare, me synim zbatimin e përvojave të përparuar.

Në punën e tij Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pasur në konsideratë vlerësimet, qëndrimet dhe sugjerimet e partive politike dhe rekomandimet e OSBE-ODHIR-it.

Gjatë debatit në seancë plenare për shqyrtimin e Raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, opozita u shpreh kundër tij, duke paraqitur disa vërejtje lidhur me organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme të vitit 2002 në Bulqizë dhe Elbasan. Sipas tyre, është vërtetuar se ka patur votim kolektiv në Bulqizë. Gjithashtu, në Elbasan zgjedhjet janë kryer në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, pasi është thyer heshtja para zgjedhore. Veç kësaj, opozita ripërsëriti kërkesën për ndryshimin dhe rikompozimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Raport për veprimtarinë kryesore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2002 (Raport i mbajtur në seancë plenare më 25 mars 2003)

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Mustafa Kërçuku, në këtë raport pasqyron veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbulimin dhe parandalimin e shkeljeve ligjore në fushën e përdorimit të fondeve publike. Ndër kontrollet e ushtruara, me rëndësi të veçantë janë kontrolli për zbatimin e Buxhetit të Shtetit dhe prokurimin e fondeve publike. Vlera e dëmeve të zbuluara për vitin 2002 është 2.43 miliardë lekë, të cilat janë vërejtur kryesisht në tatim-taksa, në shitjen e pasurisë publike, në fushën e prokurimeve publike, në Albtelekom, në dhënie subvencionesh jashtë kritereve ligjore etj. Për këto shkelje Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar të zhdëmtohen ose të rikthehen në buxhet 1.6 miliardë lekë ose 67 për qind e vlerës totale. Ai ka rekomanduar të merren masa disiplinore kundrejt shkaktarëve, si dhe ka bërë kallëzim për ndjekje penale në 22 raste.

Në raport pasqyrohen rezultatet e kontrollit në sistemin fiskal, në ministri dhe institucione qendrore, jepet lista e subjekteve kryesore ku janë bërë

shkelje financiare. Raporti vë në dukje disa pika të dobëta në punën e organeve të administratës shtetërore për administrimin e fondeve publike, si dhe rrugët për shmangien e tyre.

Në përfundim, në raport jepet një pasqyrë me të dhëna për kallëzimet kryesore penale të ngritura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2002.

Gjatë debatit në seancë plenare përfaqësuesit e Qeverisë, deputetët e mazhorancës dhe opozitës vlerësuan rolin aktiv të Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbulimin e shkeljeve dhe abuzimeve në përdorimin e fondeve publike.

Në diskutimin e tyre, disa deputetë, krahas vlerësimeve, paraqitën vërejtje lidhur me raportin e paraqitur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe punën e këtij institucioni, si dhe të drejtuesve të organeve ekzekutive, duke shprehur mendime për përmirësimin e punës, ndër të cilat më kryesoret janë:

- u kërkua thellim i punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit për përmirësimin e cilësisë së raportit dhe rritjen e profesionalizmit në kontroll;

- u kërkua bashkërendim më i mirë i punës midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe organeve të akuzës e gjyqësorit;

- nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk është kërkuar zhdëmtim për të gjitha shkeljet ligjore të konstatuara;

- pati vërejtje për shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe masave të kërkuara nga Kontrolli i lartë i Shtetit;

- disa deputetë të forcave të ndryshme politike, kërkuan zgjerimin e kompetencave të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që ai të mos qendrojë në pozita thjesht rekomanduese.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dha sqarimet e nevojshme për pyetjet e bëra. Lidhur me vërejtjen e fundit, ai sqaroi se zgjerimi i kompetencave të Kontrollit të Lartë të Shtetit bie ndesh me Kushtetutën dhe me ligjin organik të këtij institucioni.

6. Informim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2002 (Raport i mbajtur në seancën plenare të Kuvendit më 17 mars 2003)

Prokurori i Përgjithshëm, Dhori Sollaku, informoi Kuvendin se gjatë vitit 2002 Prokuroria ka punuar për të dokumentuar veprimtarinë kriminale dhe për të mbrojtur akuzën në gjyq. Në krahasim me vitin 2001 është rritur numri i çështjeve penale të regjistruara në prokurori, numri i çështjeve të dërguara në gjyq dhe numri i çështjeve të përfunduara.

Sipas raportit, përparësi e punës së Prokurorisë ka qenë dhe mbetet reduktimi i afateve të procedimit. Ndër çështjet e shqyrtuara, me përparësi janë trajtuar ato që lidhen me krimin e organizuar, trafiqet dhe çështjet e korrupsionit.

Në përfundim, Prokurori i Përgjithshëm paraqiti drejtimet kryesore ku duhet të përqendrohet puna e Prokurorisë në të ardhmen, si përmirësimi i marrëdhënieve me kontabilistët e miratuar dhe ekspertët kontabël të autorizuar, me Kontrollin e Lartë të Shtetit, gjykatat, si dhe plotësimi i kuadrit ligjor, veçanërisht në fushën e korrupsionit.

7. Projektligj “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

Ky projektligj u shqyrtua në seancë plenare më 13 shkurt 2003 pas diskutimit dhe miratimit të tij në komisionet e përhershme të Kuvendit. Qëllimi i hartimit të një ligji të plotë për veprimtarinë e auditimit të brendshëm diktohet nga nevoja për të përmirësuar këtë veprimtari, e cila deri tani ka qenë në nivel të prapambetur. Veprimtaria e auditimit nuk mund të kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili, në bazë të ligjit, nuk ka detyrime për ushtrimin e kontrollit në të gjitha subjektet publike, por ka vetëm të drejta. Ky lloj auditimi deri tani është rregulluar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe është e nevojshme të rregullohet me ligj të veçantë.

Projektligji nuk është mbështetur në ndonjë model europian, por është hartuar me ndihmën e ekspertëve të Bankës Botërore dhe të SIGMA-s. Ai

synon ngritjen e strukturave që do të kryejnë kontrollin e brendshëm, që janë Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm Financiar në Ministrinë e Financave dhe njësitë e auditimit në ministri, institucione qëndrore dhe organet e pushtetit vendor, si dhe përcakton detyrat e kompetencat e tyre. Auditimi i brendshëm është veprimtari në fushën e kontrollit të brendshëm, financiar dhe të drejtimit, sipas rregullave për auditimin, të propozuara nga Ministri i Financave dhe të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Ai synon të zbulojë shmangiet ligjore, me qëllim përmirësimin e veprimeve të një entit të sektorit publik. Veprimtaria e auditimit i shërben titullarit të ministrisë, institucionit ose organit të pushtetit vendor për të kontrolluar efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, specialistët, që kanë përgatitur projektligjin informuan deputetët se, krahas këtij projektligji, në Këshillin e Ministrave po përgatitet edhe një projektligj tjetër, që ka të bëjë me administrimin e vlerave materiale e monetare, i cili përcakton rregullat për ushtrimin e kontrollit të brendshëm financiar, mbi të cilat do të mbështetet veprimtaria e auditimit të brendshëm.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen u bënë disa ndryshime, ndër të cilat më kryesoret janë:

- ndryshohen nenet që japin përkufizimet e “auditimit të brendshëm” dhe “auditimit të performancës”;
- shtohet një nen që përmban standardet e auditimit;
- saktësohen kriteret për punësimin e auditëve;
- saktësohet përmbajtja e nenit që bën fjalë për veprimtarinë e auditimit në kushtet e konfliktit të interesave;
- riformulohen disa nene për të saktësuar dhe qartësuar përmbajtjen e tyre.

8. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Ky projektligj, i cili është nismë e një grupi deputetësh, u shqyrtua në seancë plenare më datë 6 mars 2003. Nismëtarët e projektligjit parashtruan nevojën e ndryshimeve në Kodin Doganor për të kufizuar veprimtarinë e magazinave doganore, si në aspektin e vendndodhjes, ashtu edhe të administrimit të tyre. Për këtë qëllim propozohet që të mbyllet magazinat doganore që nuk ndodhen në territorin e zonave doganore, si dhe ato që mbeten, të vendosen nën administrimin e organeve doganore. Gjithashtu, për të disiplinuar vlerësimin doganor, propozohet që çmimet e referencës të caktohen nga Këshilli i Ministrave. Të gjitha këto ndryshime, sipas nismëtarëve të projektligjit, do të çojnë në minimizimin e korrupsionit, do të mbrojnë konkurrencën e lirë dhe do të sigurojnë një transparencë më të dukshme në vlerësimin doganor.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët e shumicës u shprehën pro në parim me forcimin e regjimit të mallrave në magazinat doganore, por ata theksuan se rruga e zgjedhur për të kufizuar veprimtarinë e magazinave doganore bie ndesh me parimet e Kodit Doganor, i cili pranon liçensimin e magazinave doganore jashtë territorit të doganave dhe veprimtaria e tyre ligjërisht i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve doganore. Mbyllja e magazinave doganore jashtë territorit të doganave, sipas tyre, nga njëra anë do të dëmtonte interesat e biznesit të ndershëm, që nuk abuzon me regjimin e mallrave në magazinat doganore dhe, nga ana tjetër, do të çenonte standardet e vendosura për mallrat, që i nënshtrohen regjimit të magazinave doganore. Prandaj, rruga më e drejtë për uljen e korrupsionit është forcimi i kontrollit nga autoritetet doganore për regjimin e mallrave në magazinat doganore. Ndërsa, vendosja e çmimeve të referencës nga Qeveria, është praktikisht e pamundur për shkak të ndryshimit të shpeshtë të tyre.

Ky projektligj ishte, gjithashtu, objekt i shqyrtimit në një këshillim të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit me përfaqësues të Misionit të CAM Albanias dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Në përfundim të këtij takimi, Kryetari i Misionit të CAM Albanias, duke mirëkuptuar shqetësimet e deputetëve për shmangien e detyrimeve doganore, theksoi se këto shmangie kanë të bëjnë me moszbatimin e Kodit Doganor dhe të dispozitave për zbatimin e tij dhe jo me vetë nenet e Kodit. Në takim u vendosën një sërë detyrash, për zbatimin e të cilave nuk ka nevojë të ndryshohen nenet e Kodit Doganor, por dispozitat e miratuara nga Qeveria për zbatimin e tij.

Në përfundim të debatit, projektligji nuk u miratua nga shumica e deputetëve, duke i rekomanduar Këshillit të Ministrave të rishikojë dispozitat zbatuese të Kodit Doganor me synim forcimin e regjimit të liçensimit dhe të kontrollit të mallrave në magazinat doganore dhe të mos abuzohet me çmimet e referencës.

9. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”

Ky projektligj, i cili është propozuar nga Komisioni i Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik, u diskutua dhe u miratua në seancën plenare të Kuvendit më datë 20 mars 2003. Ndryshimet e propozuara prekin Kreun VIII të ligjit, i cili rregullon veprimtarinë e RTSH-së.

Një ndër ndryshimet më të rëndësishme në ligj është ai i nenit 88, i cili propozon rikompozimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së, sipas një formule të re. Komisioni doli me dy variante. Sipas variantit të parë, të mbështetur nga përfaqësuesit e opozitës në Komision, Këshilli Drejtues kompozohet në këtë mënyrë: 7 përfaqësues të propozuar nga pozita, 7 përfaqësues nga opozita dhe një përfaqësues i propozuar nga Presidenti i Republikës. Sipas variantit të dytë, i cili u mbështet nga përfaqësuesit e pozitës në Komision dhe u miratua në votimin në seancën plenare, 10 anëtarë të këtij Këshilli

përfaqësojnë në mënyrë të barabartë pozitën dhe opozitën, ndërsa 5 prej tyre do të jenë përfaqësues të Akademisë së Shkencave, Universitetit të Tiranës, Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe 2 nga shoqatat e gazetarëve.

Një risi e projektligjit është rregullimi nga pikëpamja ligjore e konfliktit të interesave.

Po kështu, projektligji, duke dashur të rrisë rolin kontrollues të Kuvendit ndaj KD-së, organ i zgjedhur prej tij, përcakton shkrirjen e tij, nëse raporti për veprimtarinë njëvjeçare të RTSH-së, i përgatitur nga ky Këshill dhe i paraqitur në Kuvend në çdo fillim viti, nuk miratohet në seancë plenare me shumicë votash.

10. Projektligj “Për trashëgiminë kulturore”

Ky projektligj, i cili është nismë ligjvënëse e Këshillit të Ministrave, u miratua në seancë plenare në muajin mars 2003. Miratimi i një ligji të ri në fushën e trashëgimisë kulturore është detyrim kushtetues dhe ka për qëllim të sanksionojë rregulla më të plota për ruajtjen, administrimin, vlerësimin e kësaj pasurie, duke u mbështetur në përvojën shqiptare, europiane e botërore.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore, në Komisionin e Arsimit, Kulturës, Shkencës dhe Sportit dhe më pas në seancë plenare, debati u përqendrua në këto çështje kryesore:

- Neni 6 i projektligjit bën fjalë për pesë lloje të pronësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore. Gjatë debatit deputetët u shprehën se ky nen bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Kodin Civil, ku janë të sanksionuara vetëm dy lloje pronash: prona publike dhe prona private. Në përfundim, Kuvendi vendosi heqjen e këtij neni për të mos bërë përsëritje me dokumentet ligjore të sipërpërmendura.

- Nenet 8 dhe 9, të cilat përmbajnë detyrimet institucionale për përcaktimin, regjistrimin e vlerave të objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme e të paluajtshme, si dhe ndryshimin e pronësisë së tyre, u riformuluan, duke

saktësuar përmbajtjen e tyre dhe duke shmangur përsëritjet e panevojshme në ligj.

- Është saktësuar përmbajtja e nenit 11 pika 3, i cili bën fjalë për të drejtën e pronarit të objektit të trashëgimisë kulturore për të shitur objektin që ka në pronësi dhe procedurat paraprake për shitjen e tij, si dhe të drejtën e parablerjes së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

- Është shtuar një nen në dispozitat kalimtare dhe të fundit, në të cilin vendosen detyrime për Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Institutin e Arkeologjisë që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, t'i paraqesin për miratim Këshillit të Ministrave zonat arkeologjike brenda qendrave të banuara, si dhe brenda një viti të paraqesin për miratim kufijtë dhe rregulloren e administrimit të parqeve arkeologjike.

Përveç ndryshimeve të mësipërme, deputetët bënë edhe disa ndryshime e riformulime të disa neneve për të saktësuar përmbajtjen e tyre.

11. Vendim “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së Qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale në bazë të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë”.

Në seancën plenare të datës 17 mars 2003, me propozim të një grupi deputetësh, Kuvendi vendosi krijimin e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së Qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale, me objekt që të shqyrtojë:

- procesin e transparencës së firmave piramidale, evidentimin e aseteve të tyre, si dhe mënyrën e shitjes së këtyre aseteve, evidentimin e masës dhe të mënyrës së shlyerjes së kreditorëve, për të verifikuar zbatimin nga Qeveria dhe Grupi Mbikëqyrës të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, si dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore lidhur me këtë proces;

- implikimin e politikanëve dhe zyrtarëve të lartë me firmat piramidale.

12. Vendim “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për Komisionin parlamentar hetimor për hetimin e veprimtarisë së Kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe ish-Ministër i Kulturës, Edi Rama”.

Ky projektvendim iu paraqit Kuvendit në seancë plenare më datë 24.2.2003 nga një grup prej 35 deputetësh opozitarë. Sipas nismëtarëve të projektligjit, kërkesa mbështetej në nenin 78 të Kushtetutës dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe synonte krijimin e një komisioni parlamentar hetimor për të hetuar përdorimin e fondeve publike dhe donacionet e dhëna Bashkisë së Tiranës që nga viti 2000 e deri sot. Në kërkesën e tij, grupi i deputetëve kishte formuluar edhe disa akuza ndaj Kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe ish-Ministrit të Kulturës, Edi Rama, të cilat kishin të bënin me abuzime me fondet shtetërore, shpërdorim të fondeve buxhetore, të të ardhurave të Bashkisë dhe të donacioneve etj.

Gjatë debatit në seancë plenare, deputetët e mazhorancës e kundërshtuan kërkesën e opozitës për të ngritur këtë komision hetimor, duke argumentuar se ajo është në kundërshtim me nenin 77 pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës dhe me ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore parlamentare”. Mbështetësit e këtij mendimi theksuan se dokumentet ligjore të sipërpërmendura lejojnë krijimin e komisioneve hetimore të Kuvendit në këto raste:

- për të hetuar çështje të veçanta;
- për të hetuar mbi zyrtarë me imunitet, që kanë lidhje me çështjen objekt hetimi.

Sipas tyre, akuzat e paraqitura nga opozita ndaj Edi Ramës janë akuza ndaj një personi dhe zyrtari pa imunitet, ato janë akuza me karakter penal dhe ndiqen nga organet e specializuara dhe të ngarkuara me ligj si Prokuroria, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe strukturat e kontrollit në Bashkinë e Tiranës dhe jo nga komisionet hetimore parlamentare, të cilat, sipas ligjit, nuk mund të ngrenë akuza penale dhe të ushtrojnë atributet e gjykatave. Gjithashtu,

ata u shprehën se çështja që kërkohet të shqyrtohet nuk përbën “çështje të veçantë”, “ një fenomen apo ngjarje të rëndësishme me interes të gjerë shoqëror, të cilat kanë impakt të gjerë dhe interes të gjerë publik, shoqëror, kombëtar”. Ajo është një çështje e zakonshme, që lidhet me një person. Sipas këtyre argumenteve, deputetët e mazhorancës nuk e miratuan projektvendimin e mësipërm.

13. Vendim “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të fondeve publike dhe të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për zhvillimin urbanistik në Tiranë për periudhën 1992-2002”.

Kuvendi vendosi krijimin e këtij Komisioni në seancën plenare të datës 13 mars 2003, në bazë të propozimit të një grupi deputetësh. Ngritja e këtij Komisioni ka objekt:

- të shqyrtojë zbatimin e ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike dhe të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002;

- të shqyrtojë zbatimin e ligjshmërisë në zhvillimin urbanistik për qytetin e Tiranës për periudhën 1992-2002.

Gjatë muajit mars ky Komision e ka përqendruar punën në mbledhjen e informacionit mbi bazën e kërkesave të dërguara në Bashkinë e Tiranës, Ministrinë e Kulturës, Entin Kombëtar të Banesave, Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve etj. Ai ka miratuar planin paraprak të hetimit dhe ka hartuar rregulloren e Komisionit.

14. Komisioni i posaçëm parlamentar “Për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODHIR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001”.

Edhe gjatë periudhës janar-mars 2003 ky komision vazhdoi veprimtarinë e tij, duke u mbështetur në asistencën e përfaqësisë së OSBE-së në Shqipëri, si dhe në atë të ekspertëve të ODHIR-it. Në bashkëpunim me përfaqësues të OSBE-së dhe ODHIR-it, ky Komision vazhdoi shqyrtimin e Kodit Zgjedhor dhe ka hartuar disa amendamente për ndryshimin e disa krerëve të tij, si ankimet dhe apelimet, listat e zgjedhësve, fletët e votimit, regjistri i subjekteve zgjedhore, Policia e Shtetit, media, dispozitat tranzitore etj.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako

Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligj nr. 8861, datë 7.3.2002 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Hollandës për bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Organizatës së Zhvillimit të Hollandës (SNV)”. Duke dëshiruar të nxisim bashkëpunimin dhe marrëdhëniet miqësore midis dy popujve për të ndihmuar në proceset e zhvillimit, pala hollandeze merr përsipër të sigurojë fonde dhe personel të përqendruar në disa fusha të përcaktuara. Ajo do t’ia besojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Organizatës së Zhvillimit të Hollandës (SNV), kurse pala shqiptare do t’ia besojë Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë së Shqipërisë. Me këtë Marrëveshje do të punohet për rritjen e fuqisë sociale dhe ekonomike të grupeve të varfëra dhe njerëzve të prapambetur të popullsisë shqiptare, do të asistohen sipërmarrjet e reja, veçanërisht në zonat bujqësore duke u përqendruar në kualifikimin, zgjerimin, marketingun, kreditin dhe planifikimin. Gjithashtu, do të asistohen edhe grupet sociale të cënuara të popullsisë. Pala hollandeze do të paguajë edhe personelin joshqiptar të SNV-së (me paga hollandeze), do të paguajë të gjitha shpenzimet e zyrave dhe ato për punën dhe kualifikimin e paracaktuar. Pala shqiptare do të përjashtojë personelin joshqiptar të SNV-së (dhe familjarët e tyre) nga taksa e importit, taksat doganore, taksat mbi pagat, si dhe çdo taksë mbi automjetet dhe furnizimet që i shërbejnë zbatimit të projekteve dhe

programeve që përfshihen në Marrëveshje. Personeli i SNV-së do të respektojë legjislacionin në fuqi në Shqipëri. Marrëveshja do të jetë e vlefshme për 3 vjet dhe mund të zgjatet edhe për një periudhë tjetër, përveç kur njëra palë njofton palën tjetër për vendimin e saj për ta përfunduar atë. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.4.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7 të vitit 2002, faqe 159. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr.8862, datë 7.3.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, ndryshuar me ligjin nr.8444, datë 21.1.1999”. Me ligjin e lartpërmendur bëhen ndryshime në nenet 4, 17 dhe 18. Neni 4 ndodhet në Kreun II që rregullon politikat shtetërore të punësimit dhe në këtë nen ndryshon pika 5, sipas të cilit politikat shtetërore të punësimit vendosen nga Këshilli i Ministrave. Ministria nxit dhe realizon zbatimin e politikave për punësimin, arsimimin profesional nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Në nenin 17 (që përfshihet në Kreun V) flitet për Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Ndryshimet e bëra përcaktojnë që Drejtori i Përgjithshëm i këtij Shërbimi nuk emërohet më nga Këshilli i Ministrave, por emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përkatës. Po në këtë nen shtohet një pikë ku përcaktohet se organi më i lartë vendimmarrës i Shërbimit Kombëtar të Punësimit është Këshilli Administrativ Tripalësh. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen në Statutin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ndryshimet në nenin 18 (shkronja “b” e pikës 2 dhe pika 3) kanë të bëjnë me disa përcaktime në Statut. Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.4.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7 të vitit 2002, në faqen 163.

Ligji nr. 8863, datë 7.3.2002 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ndryshuar me ligjet nr.7785, datë 27.1.1994, nr. 7886, datë 8.12.1994, nr.8008 datë 5.10.1995 dhe nr.8721, datë 26.12.2000”. Me ligjin e

lartpërmendur ndryshimi bëhet në kapitullin VI të ligjit në fuqi që flet për detyrat e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Ministrisë së Financave e të Ekonomisë. Në këtë kapitull, në nenin 23 parashikohet që për plotësimin e detyrave që burojnë nga ky ligj, në Ministrinë e Punës, Emigracionit dhe të Përkrahjes Sociale ngrihen dhe funksionojnë Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Drejtoria e Përkujdesjes Shoqërore. Sikurse del edhe nga titulli i ligjit të lartpërmendur, ligjit në fuqi i janë bërë katër herë shtesa e ndryshime. Gjithashtu, qysh nga viti 1993 kur është miratuar ligji në fuqi e deri sot edhe emërtimi e struktura e ministrisë, që është ngarkuar me detyra sipas nenit 23, ka ndryshuar. Me ligjin nr. 8863, datë 7.3.2002 (pra, me ligjin e fundit) ndryshohet neni 23. Sipas ndryshimit, në zbatim të këtij ligji krijohet Shërbimi Social Shtetëror, në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Shërbimi Social Shtetëror administrohet dhe drejtohet nga Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm i këtij Shërbimi. Këshilli i Ministrave miraton Statutin e Shërbimit Social Shtetëror, i cili rregullon veprimtarinë e këtij institucioni dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Administrativ dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të tij. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.4.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7 të vitit 2002, në faqen 164.

Ligji nr.8864, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e Marrëveshjes për zbatimin e ligjit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës”. Qëllimet specifike të miratimit të kësaj Marrëveshjeje janë të dyanshme dhe në bashkëpunim me përpjekje të tjera ndërkombëtare, për të rritur kapacitetin e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të forcuar zbatimin e ligjit. Drejtimet kryesore janë rritja e profesionalizmit të Policisë Shqiptare, vendosja e një sistemi menaxhimi të zbatimit të ligjit në nivelin qendror dhe në çdo prefekturë, mundësimi i policisë kufitare shqiptare për të kontrolluar më me efikasitet kufijtë e Shqipërisë për të ndaluar dhe zbatuar trafikun e personave dhe

kontrabandën dhe ngritja e një task force kundër krimit të organizuar të përbërë nga prokurorë dhe policë për të ndjekur çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Shqipëri. Aksionet që do të ndërmerren për të arritur qëllimet e përmendura më lart, përfshijnë asistencën teknike, trajnim dhe dhënien e kufizuar të pajisjeve. Asistenca totale e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është 4 758 062 USA dhe lidhet me faktin që përpjekjet e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të kontrolluar krimin të kushtëzohet nga mbrojtja aktive e të drejtave të njeriut në Shqipëri nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Secila palë ka të drejtë të prishë këtë Marrëveshje, duke njoftuar palën tjetër me shkrim 90 ditë përpara. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.4.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7 të vitit 2002, në faqen 165. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 8865, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Luftën kundër Financimit të Terrorizmit”. Shtetet anëtare të kësaj Konvente, në hartimin dhe miratimin e saj, janë nisur nga shqetësimi i madh për zhvillimin mbarëbotëror të akteve të terrorizmit në të gjitha format e manifestimet e tij. Gjithashtu, kanë pasur parasysh se financimi i terrorizmit përbën një shqetësim të rëndë për bashkësinë mbarëkombëtare në tërësi, prandaj ka lindur nevoja urgjente e intensifikimit të bashkësisë mbarëkombëtar midis shteteve në sajimin dhe përshtatjen e masave efektive për parandalimin e financimit të terrorizmit, si edhe të luftës kundër tij përmes ndjekjes dhe ndërshtimit të fajtorëve. Në nenin 2 Konventa përcakton aktet terroriste dhe në nenin 6 i vë detyrë çdo shteti anëtar që të adaptojë masa të nevojshme, përfshirë këtu edhe legjislationin vendas, për të siguruar që aktet kriminale nuk mund të justifikohen në asnjë rrethanë me arsye politike, filozofike, ideologjike, sociale, etnike, fetare ose të natyrave të ngjashme me to. Konventa nuk zbatohet kur krimi kryhet brenda një shteti të vetëm, kur shkelësi është nënshtetas i atij vendi dhe është i pranishëm në territorin e atij shteti. Në këtë rast, shtetit ku kryhet krimi i vihen disa detyra të përcaktuara

në nenin 3 të Konventës. Ndërmjet të tjerash, shteteve anëtare u vihet detyrë që të bashkëpunojnë për parandalimin e krimeve të parashikuara në nenin 2 të Konventës, duke marrë të gjitha masat e aplikueshme, ndër të tjera, duke përshtatur legjislacionin e vendeve të veta, nëse kjo është e nevojshme, të parandalojnë dhe të kundërveprojnë në territoret përkatëse ndaj krimeve të kryera brenda ose jashtë territoreve të tyre. Shtetet anëtarë nuk kanë të drejtë ta refuzojnë kërkesën për ndihmë ligjore të ndërsjellë, duke nxjerrë si pretekst ruajtjen e sekretit. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.4.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, të vitit 2002, në faqen 170. Ligjit i bashkëlidhet edhe Konventa.

Ligji nr. 8866, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e Traktatit të Miqësisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës”. Sipas Marrëveshjes, të dy vendet, të udhëhequra nga ndjenja e miqësisë dhe respektit të ndërsjellë, si dhe duke pasur parasysh angazhimet që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, janë marrë vesh për një sërë çështjesh të rëndësishme. Në themel të kësaj Marrëveshjeje qëndrojnë parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, të Akteve Përfundimtare të Helsinkit dhe të Kartës së Parisit për një Europë të Re. Palët kanë rënë dakord që të zhvillojnë dhe thellojnë marrëdhëniet e tyre në fushën e mbrojtjes, të zhvillojnë bashkëpunimin ekonomik dypalësh, duke krijuar kushte të favorshme për të nxitur e siguruar investimet e palës tjetër. Ata angazhohen të zhvillojnë bashkëpunimin në fushat e bujqësisë, të industrisë, infrastrukturave dhe ndërtimit, transportit dhe të telekomunikacioneve, shërbimeve dhe turizmit. Angazhime kanë marrë edhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Përveç sa u tha më lart, në Marrëveshje palët kontraktuese kanë shprehur dëshirën për të bashkëpunuar në shkëmbimin e vlerave artistike e për më shumë bashkëpunim shkencor e arsimor midis tyre. Do të lehtësohet bashkëpunimi në fushat e shëndetësisë, të asistencës sociale, edukimit fizik, sportit dhe turizmit dhe, në përputhje me

konventat ndërkombëtare, do të rritet bashkëpunimi në fushën juridike. Përparësi i është dhënë bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të narkotikëve dhe terrorizmit. Kushtet e këtij Traktati nuk përfshijnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe të përfunduara nga Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës me shtete të treta. Ligji ka 2 nene. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.8 të vitit 2002, në faqen 185. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 8867, datë 14.3.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Statutin e Konferencës së Hagës për të drejtën ndërkombëtare private”. Qëllimi i Konferencës së Hagës është të punojë për njehsimin progresiv të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private. I ngarkuar me kryerjen e veprimeve të Konferencës është Komisioni i Përhershëm i Qeverisë së Holandës i krijuar me Dekretin Mbretëror të 20 shkurtit 1987. Ky Komision vepron nëpërmjet Zyrës së Përhershme për të ushtruar veprimtarinë me të cilën është ngarkuar. Zyra e Përhershme e ka selinë e saj në Hagë dhe është e ngarkuar me përgatitjen dhe organizimin e sesionit të Konferencës së Hagës dhe takimet e komisionit special, me punën e sekretariatit të sesionit dhe me të gjitha detyrat që janë të përfshira në veprimtarinë e një sekretariati. Përveç rregullimit të veprimtarive të ndryshme me karakter organizativ të Komisionit dhe të Zyrës së Përhershme, të Komiteteve Speciale dhe të marrëdhënieve midis shteteve anëtare në këtë Konferencë, Statuti rregullon edhe probleme të shpenzimeve për veprimtaritë që organizohen, si ato të përkohshme edhe të përhershme dhe i ndan ato midis shteteve anëtare, duke përcaktuar rregulla të qarta. Sipas Statutit, Konferenca dhe Komiteti i Përhershëm Qeveritar, në intervalet ndërmjet sesioneve, mund të përgatisin projekte konventash ose të shqyrtojnë të gjitha çështjet ndërkombëtare private që shfaqen në përputhje me qëllimin e Konferencës. Statuti trajton, gjithashtu, edhe probleme të pranimit në këtë

Konferencë, si dhe të denoncimit të Statutit. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.4.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.8 të vitit 2002, në faqen 189. Ligjit i bashkëlidhet Statuti i Konferencës së Hagës për të drejtën ndërkombëtare private.

Ligji nr. 8868, datë 21.3.2002 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Panhellenic Exporters Association për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë”. Me miratimin e këtij ligji, shfuqizohet ligji nr.8748, datë 1.3.2001 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Panhellenic Exporters Association për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë”. Edhe sipas Marrëveshjes së miratuar me ligjin e mësipërm, subjekt i saj është konsolidimi i borxheve, për shumën e papaguar të faturave dhe interesat mbi këto shuma që rrjedhin nga transaksionet tregtare të përfunduara para 31.12.1991, të mbetura të papaguara deri më 20.10.2000. Marrëveshja përmban emrat e kompanive, shumën e faturave të papaguara dhe interesat. Sipas nenit 2 të saj, Panhellenic Exporters Association heq dorë nga kërkesa e shumës prej 319 565 USD, 169 742 DEM dhe 14 355 186 GRD, që rrjedh nga interesat. Në Marrëveshje përcaktohet edhe data e saktë e pagimit të borxhit të mbetur. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 7.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.9 të vitit 2002, në faqen 216. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 8870, datë 21.3.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën””. Me ligjin e lartpërmendur, në ligjin në fuqi bëhet vetëm një ndryshim në nenin 2 që flet për objektin e ligjit, dhe konkretisht ndryshohet shkronja “b” e këtij neni dhe shtohet shkronja “e” po në nenin 2. E gjithë përmbajtja tjetër e ligjit, ka të bëjë me shtesa. Kështu, në nenin 3 (përkufizime) janë 5 shtesa, në nenin 14 (rregullimi i pragut të peshkimit) ka 1 shtesë, në nenin 15 (licenca

e peshkimit profesional) ka 1 shtesë dhe po nga një shtesë ka në nenet 19, 23 dhe 31. Me rëndësi është të vëmë në dukje se janë shtuar edhe 3 Krerë. Kreu VII/I zgjidh probleme të organizatave të menaxhimit të peshkimit, të anëtarësisë në organizata, të asamblesë së përgjithshme të këshillit administrativ, statutit, regjistrimit të organizatave, monitorimit e shpërndarjes së organizatës. Kreu VII/II ka të bëjë me probleme të dhënies në përdorim të porteve e qendrave të peshkimit dhe të strukturave që ushtrojnë veprimtari peshkimi. Kreu VII/III rregullon bashkë me menaxhimin e peshkimit, siç janë përcaktimi i një zone bashkëmenaxhuese, planet e bashkëmenaxhimit, licencimi në një zonë bashkëmenaxhuese, monitorimi dhe rishikimi etj. Pra, në tërësi ligji ka vetëm një ndryshim dhe 26 shtesa dhe ka hyrë në fuqi më 8.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.9 të vitit 2002, në faqen 218.

Information on laws passed by Assembly

Filip Lako

Lawyer

Center for Parliamentary Studies

No. 8861, dated 7 March 2002 “On the ratification of the agreement between the Government of the Republic of Albania and the Government of the Dutch Kingdom on the cooperation between the Government of the Republic of Albania and the Dutch Organization for Development (SNV)”. Wishing to step up cooperation and the friendly relations between the two peoples to assist in the development process, the Dutch side undertakes to find funds and personnel specialized in certain areas. It will entrust the implementation of this agreement to the SNV, while the Albanian side will entrust it to the Ministry of Industry and Trade of Albania. This agreement will contribute to the increase of the social and economic power of poor groups and backward people in the Albanian population, will assist the new enterprises, particularly in the agricultural zones, concentrating on the training, the expansion, the marketing, the credit and the planning. It will also assist the vulnerable social groups of the population. The Dutch side will pay also the non-Albanian staff of the SNV (with Dutch salaries), it will reimburse all their official expenses and the expenses incurred for the agreed on work and training. The Albanian sides will exempt the non-Albanian staff of the SNV (and their family members) from the import tax, the customs tax, the income tax, and any other tax on the cars and the fuel that is used for the implementation of the projects and the programs included in this Agreement. The SNV staff will respect the leg-

islation in force in Albania. The Agreement will be valid for 3 years and may be extended for another period, with the exception of those cases when one side notifies the other of its decision to terminate it. The law has two articles and has entered into force on 20 April 2002. It is published in the Official Gazette no. 7, 2002, p. 159. The Agreement is attached to the law.

Law no. 8862, dated 7 March, 2002 “On some amendments to Law no. 7995, dated 20 September 1995, ‘On the promotion of employment,’ amended in Law no. 8444, dated 21 January 1999”. The above-mentioned law amends Articles 4, 17, and 18. Article 4 is found in Chapter II, which regulates the state policies of employment and point 5 of this article is changed to read that the state policies of employment shall be determined by the Council of Ministers. The Ministry shall promote and implement the employment policies for employment and vocational training through the National Employment Service. Article 17 (which is found in Chapter V) speaks about the National Employment Service. The changes made say that the General Director of this service shall not be any longer appointed by the Council of Ministers, but by the Prime Minister on the proposal of the relevant minister. This article also adds a point, which lays down that the highest decision-making body of the National Employment Service is the Tripartite Administrative Council. Its organization and functioning shall be laid down in the Statute of the National Employment Service. The law has four articles and has entered into force on 20 April 2002. It is published in the Official Gazette no. 7, 2002, on page 163.

Law no. 8863, dated 7 March 2002, “On an amendment to Law no. 7710, dated 18 May, 1993 ‘On the social assistance and care,’ amended in Laws no. 7785, dated 27 January 1994, no. 7886, dated 8 December 1994, no. 8008, dated 5 October, 1995, and no. 8721, dated 26 December 2000”. In the abovementioned Law, the amendment

is made to chapter VI of the law in force, which speaks about the duties of the Ministry of Labor, Immigration and Social Assistance and the former Politically Persecuted, and the Ministry of Finance and Economy. Article 23 of this chapter envisioned that for the implementation of the duties stemming from this law, a department of economic assistance and a department of social care shall be set up at the Ministry of Labor, Immigration, and Social Care and the Former Politically Persecuted. As can be seen from the title of the above law, the law in force has been amended four times. Since 1993, when the law in force was approved, the name and the structure of the ministry charged with the tasks stemming from Article 23 have also changed. In law no. 8863, dated 7 March 2002 (thus the last law) Article 23 is amended. According to this change, in implementation of this law, the State Social Service shall be set up under the jurisdiction of the Ministry of Labor and Social Affairs. The Social State Service shall be administered and led by the Administrative Council and the General Director of this Service. The Council of Ministers shall approve the Status of the State Social Service, which regulates the activity of this institution and lay down the tasks and the responsibilities of the Administrative Council and its general director. The Law has two articles and has entered into force on 20 April 2002. It is published in the Official Gazette no. 7, 2002, p. 164.

Law no. 8864, dated 14 March 2002, “On the ratification of the Agreement for the implementation of the law between the Government of the Republic of Albania and the Government of the United States of America.” The specific objectives of the approval of this Agreement are mutual and in cooperation with other international agencies, it will aim to enhance the capacity of the Government of the Republic of Albania to strengthen the implementation of the law. The main directions are the increase of professionalism of the Albanian Police, the establishment of a system of management in the implementation of the law at a central and

local level in every prefecture, the empowerment of the Albanian border police to control the borders of the Republic of Albania with greater effectiveness to stop the trafficking and smuggling and to set up a task force against organized crime, composed by prosecutors and police to follow up the issues linked with organized crime and corruption in Albania. The actions to be undertaken to achieve the abovementioned objectives include technical assistance, the training and the limited supply of equipment. The total assistance to be given by the US Government is \$4,758,062 and is conditional on the fact that the efforts of the Government of the Republic of Albania to control crime should take into consideration the active protection of human rights in Albania. Each side has the right to terminate this agreement, notifying the other side in writing 90 days in advance. The Law has two articles and has entered into force on 20 April 2002. It is published in the Official Gazette no. 7, 2002, p. 165. The Agreement is attached to the law.

Law no. 8865, dated 14 March 2002 “On the ratification of the ‘International convention on the fight on financing of terrorism’”. In their drafting and preparation of this convention, its member states took their cue from the major concern over the terrorist acts committed all over the globe in various forms and manifestation. They also bore in mind that the financing of terrorism constitutes a serious concern for the international community at large, therefore it is urgent for the international community to intensify its efforts to take and adopt effective measures to prevent the financing of terrorism and the fight on it through the prosecution and punishment of the perpetrators. Article 2 of this Convention lays down the terrorist acts and Article 6 says that it is the duty of every state to adopt the necessary measures, including also the local legislation, to ensure that criminal acts can under no circumstances be justified with political, philosophical, ideological, social, ethnic, religious, or other reasons similar to them. The

Convention shall not be applicable when the crime is committed in a single state, when the offender is a citizen of that country and is present in the territory of that state. In this case, the state in which the crime is perpetrated has some obligations that are prescribed in Article 3 of the Convention. Among other things, the member state have the duty of cooperating for the prevention of the crimes envisioned in Article 2 of the Convention, taking all the applicable measures, among others adapting the legislation of their own countries, when this is necessary, to prevent and counteract in their respective territories the crimes committed in or outside their own territories. The member states do not have the right to restrict their demand for reciprocal legal assistance, bringing as a pretext the protection of the secret. The Law has two articles and has entered into force on 20 April 2002. It is published in the Official Gazette no. 7 of year 2002, p. 170. The Convention is attached to the Law.

Law no. 8866, dated 14 March, 2002 “On the ratification of the “Treaty of friendship and cooperation among the Republic of Albania and the Kingdom of Spain””. Under this Agreement both countries, led by the feelings of friendship and reciprocal respect, and taking into consideration the commitments that stem from the international law have agreed on a number of major issues. At the core of this Agreement lie the principles of the Charter of the United Nations, the Final Acts of Helsinki and the Paris Charter for a New Europe. The parties have agreed to develop and deepen their relations in the field of defense, to develop mutual economic cooperation, creating favorable conditions to promote and insure the investments of the other party. They are committed to developing cooperation in the fields of agriculture, industry, infrastructure, and construction, transport and telecommunication, services and tourism. They have taken commitments also in the field of the protection of the environment. Regarding the aforesaid, in the Agreement the contracting parties have expressed their

willingness to cooperate in the exchange of artistic values and for greater scientific and educational cooperation. They will facilitate cooperation in the field of health, social assistance, physical education, sports, and tourism, and in conformity with the international conventions, they will enhance cooperation in the juridical field. They have given priority to cooperation in the fight on organized crime, unlawful trafficking in narcotics and terrorism. The terms and conditions of this Treaty do not include the rights and obligations that stem from bilateral or multilateral international treaties concluded by the Republic of Albania and the Kingdom of Spain with third parties. The Law has two articles. It is published in the Official Gazette no. 8, 2002, p. 185. The Agreement is attached to the Law.

Law no. 8867 dated 14 March 2002 “On the adherence of the Republic of Albania to the Statute of The Hague Conference on Private International Law”. The aim of The Hague is to work for the progressive unification of the rules of the private international law. The Standing Commission of the Dutch Government, set up in the royal decree of 20 February 1987, has been charged to carry out the actions of the Conference. This Commission shall act through its Permanent Office to carry out the duties it is charged with. The Permanent Office has its seat in The Hague and is responsible for the preparation and organization of the session of The Hague Conference and the meetings of the ad hoc committee, the work of the secretariat of the session, and all the other tasks included in the activity of a secretariat. Apart from the regulation of the various activities of an organizational character of the Commission and the Permanent Office, the Ad Hoc Committees, and the relations among the member states of this Conference, the Statute regulates also the problems of the expenditures for the activities that are organized, both permanent and provisional ones, and spreads them out among the member states, laying down clear rules. Under the Statute, the Conference and the Permanent Government Committee, in the intervals between the sessions, may prepare projects of conventions or

to examine all the private international issues that appear in conformity with the aims of the Convention. The Statute shall treat also problems of the admission to this Conference and the denouncement of the Statute. The Law has two articles and has entered into force on 20 April 2002. It is published in the Official Gazette no 8, 2002, p. 189. The Statute of The Hague Conference on international private law is attached to this law.

Law no. 8868, dated 21 March, 2002 “On the ratification of the ‘Agreement between the Republic of the Republic of Albania and Pan Hellenic Exporters Association for the consolidation of the external debt of Albania’”. With the approval of this law, law no. 8748, dated 1 March 2002 “On the ratification between the Government of the Republic of Albania and the Pan Hellenic Exporters Association for the consolidation of the external debt of Albania” shall be repealed. The Agreement approved in the above law, also aims to consolidate the external debts regarding the unpaid amount of bills and the interests over this amount that result from the trade transactions concluded prior to 31 December 1991, outstanding up to 20 October 2000. The Agreement has the names of the companies, the total of unpaid receipts and their interests. Under Article 2 of this Agreement, the Pan Hellenic Exporters Association shall renounce its demand for the amount of \$319, 565, 169,742 DM, and 14,355 GRD, accrued from the unpaid interests. The Agreement lays down also the accurate date of the payment of the outstanding debt. The Law has three articles and has entered into force on 7 May 2002. It is published in the Official Gazette no. 9, 2002, p. 216. The Agreement is attached to the law.

Law no. 8870, dated 21 March 2002 “On some supplements and amendments to law no. 7908, dated 5 April ‘On fishing and aquaculture’”. This law makes only one change to the law in force in Article 2, which speaks about the object of the law, letter “b” of this article and adds letter “e” to Article 2. The remaining content of the law has to do with

the supplements. Thus Article 3 (definitions) comprises supplements, Article 14 (improvement of the paragraph on fishing) has one supplement, Article 15 (licensing of professional fishing) has one supplement. Likewise Articles 19, 23, and 31 have one supplement each. It is important to note that three new chapters have been added. Chapter VII/I solves organizational problems of management of fishing, membership in the organization, the general assembly of the administrative council, the statute, the registration of the organizations, the monitoring of the disbanding of the organization, Chapter VII/II has to do with the problem of giving for use the ports and the fishing centers and the structures engaged in fishing activity. Chapter VII/III regulates along with the management of fishing also such issues like the definition of a co-managing zone, the co-management plans, the licensing of a co-managing zone, the monitoring, the revision and others. In general the law has only one change and 26 supplements and has entered into force on 8 May 2002. It is published in the Official Gazette no. 9, 2002, p. 218.

Personat që janë të interesuar të
abonohen në këtë Revistë, janë të lutur
të kontaktojnë në adresën:

Rruga “Sami Frashëri”, Nr.3/15

Pallatet e Aviacionit

☎: 04 240214

berberiscdp@albaniaonline.net

Home page: www.ascdp.org

Botuesit e kësaj Reviste mirëpresin dhe e
vlerësojnë si ndihmë çdo vërejtje apo sugjerim
për përmirësimin e cilësisë së Revistës. Vërejtjet
dhe sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni në adresën
e sipërpërmendur.

Ju faleminderit!

*Those who are interested to register are
pleased to contact at:*

Rruga “Sami Frashëri”, Nr.3/15

Pallatet e Aviacionit

☎: 04 240214

e-mail: berberiscdp@albaniaonline.net

The editors welcome any suggestion or comment
to improve the quality of the Review. You can send
your comments and suggestions to the above
mentioned address.

Thank You!

Kopertina: R&T Advertising

Art grafik: Elvira Çiraku

Shtypur në shtypshkronjën “ALB Paper”

Drejtor i Revistës: Sokol BERBERI

Kryeredaktore: Elira ZAKA

Bordi editorial: Filip LAKO
Perikli ZAHARIA
Leon SHESTANI
Sokol SADUSHI
Sokol BERBERI

Përkthyes: Engjëllushe SHQARRI

Redaktor: Pandeli KOÇI

©Copyright 2001: Qendra e Studimeve Parlamentare

**Kjo revistë botohet me mbështetjen financiare të
National Endowment for Democracy (NED)**